

VENDIM
Nr. 326, datë 29.5.2024

**PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE PËR MBROJTJEN E
KONSUMATORËVE DHE MBIKËQYRJEN E TREGUT 2024–2030**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2024–2030, sipas dokumentit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministritë dhe institucionet përgjegjëse, sipas përcaktimeve në dokumentin e strategjisë dhe të planit të veprimit, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE
PËR MBROJTJEN E KONSUMATORËVE DHE MBIKËQYRJEN E TREGUT
2024–2030

Përmbajtja

KONTEKSTI STRATEGJIK

HYRJE

KAPITULLI I: SITUATA AKTUALE

**I.1 SHTYLLA I: SIGURIA E PRODUKTEVE USHQIMORE DHE E PRODUKTEVE
JOSHQIMORE**

1.1 Siguria e produkteve ushqimore

1.2 Siguria e produkteve joushqimore

1.3 Infrastruktura e cilësisë

Standardizimi

Akreditimi

Metrologjia

1.4 Mbikëqyrja e tregut

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor

Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut

Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial

1.5. Kuadri ligjor i produkteve ushqimore dhe joushqimore

Kuadri ligjor i produkteve ushqimore

Kuadri ligjor i produkteve joushqimore

Kuadri ligjor mbi infrastrukturën e cilësisë

Kuadri ligjor i mbikëqyrjes së tregut

**I.2 SHTYLLA II: ÇËSHTJE TË MBROJTJES SË KONSUMATORËVE QË NUK
LIDHEN ME ASPEKTET E SIGURISË**

2.1 Kuadri institucional

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
Enti Rregullator në fushën e Energjisë
Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të
Ndotura

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
Banka e Shqipërisë
Autoriteti i Aviacionit Civil

2.2 Kuadri ligjor mbi çështjet e mbrojtjes së konsumatorëve që nuk lidhen me aspektet e sigurisë

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Enti Rregullator i Energjisë

Enti Rregullator i Ujit

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

Banka e Shqipërisë

Autoriteti i Aviacionit Civil

I.3 SHTYLLA III: INFORMIMI DHE NDËRGJEGJËSIMI

3.1 Aktivitet ndërgjegjësuë

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Akreditimi

Metrologjia

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit

Enti Rregullator i Energjisë

Enti Rregullator i Ujit

Autoriteti i Aviacionit Civil

KAPITULLI II: VIZIONI, POLITIKAT, QËLLIMET E POLITIKAVE DHE
OBJEKTIVAT

VIZIONI I STRATEGJISË

QËLLIMET E POLITIKAVE

OBJEKTIVAT, MASAT DHE INDIKATORËT SIPAS FUSHAVE

II.1 SHTYLLA I: SIGURIA E PRODUKTEVE USHQIMORE DHE E PRODUKTEVE
JOSHQIMORE

II.1.1 Objektivat, masat dhe indikatorët për sigurinë e produkteve ushqimore

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

II.1.2 Objektivat, masat dhe indikatorët për sigurinë e produkteve joushqimore

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Infrastruktura e cilësisë

Standardizimi

Akreditimi

Metrologjia

Mbikëqyrja e tregut

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor

Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut

Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial

II.2 SHTYLLA II: ÇËSHTJE TË MBROJTJES SË KONSUMATORËVE QË NUK
LIDHEN ME ASPEKTET E SIGURISË

II.2.1 Objektivat, masat dhe indikatorët
 Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
 Ministria e Mjedisit dhe Turizmit
 Enti Rregullator i Energjisë
 Enti Rregullator i Ujit
 Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
 Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
 Banka e Shqipërisë
 Autoriteti i Aviacionit Civil

II.3 SHTYLLA III: INFORMIMI DHE NDËRGJEGJËSIMI I KONSUMATORËVE DHE I SUBJEKTEVE, SI DHE BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL DHE ME TË GJITHË AKTORËT E TJERË

II.3.1 Objektivat, masat dhe indikatorët lidhur me informimin dhe ndërgjegjësimin për çështje që lidhen me aspekte të sigurisë:

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
 Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
 Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
 Akreditimi
 Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
 Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut

II.3.2 Objektivat, masat dhe indikatorët në lidhje me informimi dhe ndërgjegjësimin, si dhe bashkëpunimi ndërinstitucional dhe aktorët e tjerë për çështje që nuk lidhen me aspektet e sigurisë:

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
 Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
 Enti Rregullator i Energjisë
 Enti Rregullator i Ujit
 Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
 Banka e Shqipërisë
 Autoriteti i Aviacionit Civil

KAPITULLI III: BURIMET FINANCIARE

KAPITULLI IV: LLOGARIDHËNIA, MONITORIMI DHE ANALIZA VLERËSUESE

4.1 MONITORIMI I STRATEGJISË, STRUKTURAT PËRGJEGJËSE

ANEKS: PLANI I VEPRIMIT TË STRATEGJISË SË MBROJTJES SË KONSUMATORËVE DHE MBIKËQYRJES SË TREGUT

Akronime

AAC	Autoriteti i Aviacionit Civil
AKEP	Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
AKVMB	Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve
AMF	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
BE	Bashkimi Evropian
BP	Ballkani Perëndimor
BSH	Banka e Shqipërisë
BTSF	<i>Better Training for Safer Food (European Commission)</i>
CEN/CENELEC	Komiteti Evropian për Standardizimin <i>European Committee for Standardization</i>
CLP	Klasifikimi, Etiketimi dhe paketimi (i kimikateve) <i>(Classification, Labeling and Packaging)</i>
DG-SANTE	<i>Directorate General for Health and Food Safety</i>

DPA	Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit
DPM	Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë
DPS	Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit
DPSU	Drejtoria e Politikave të Sigurisë Ushqimore
DRAKU	Drejtoritë rajonale të AKU-së
EFSA	<i>European Food Safety Authority</i>
ERRE	Enti Rregullator i Energjisë
ERRU	Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë
ETSI	Instituti Evropian i Standardeve të Telekomunikacionit
FSHU	<i>European Committee for Electrotechnical Standardization</i>
GHS	Furnizuesi i Shërbimit Universal
ISHMT	Sistemi i Harmonizuar Global i Klasifikimit dhe Etiketimit të Kimikateve
ISHSH	Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut
ISHTI	Inspektorati Shtetëror Shëndetësor
ISO/IEC	Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial
	Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit
	<i>International Organization for Standardization/ International Electrotechnical Commission</i>
ISUV	Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë
KT	Komitetet teknike
LVD	Direktiva e tensionit të ulët
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sporteve
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MEKI	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MM	Ministria e Mbrojtjes
MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
OBT	Organizata Botërore të Tregtisë
OVK	Organet e vlerësimit të konformitetit
PIK	Pika e Inspektimit Kufitar
PKIE	Plani Kombëtar i Integritetit
RASFF	Rapid Alert System for Food and Feed
REACH	Regjistrimi, vlerësimi, autorizimi dhe kufizimi i kimikateve (<i>Registration, Evaluation, Authorisation and Restriction of Chemicals</i>)
RLAH	<i>Roam Like at Home</i>
SDP	Spektori i të Drejtave të Pasagjerëve
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integritet
SSH	Standarde shqiptare
	<i>Technical Assistance and Information Exchange instrument of the European Commission</i>
TAIEX	
TFBE	Traktati i Funksionimit të Bashkimit Evropian
TIA	<i>Tirana International Airport</i>
UK	Ujësjellës-kanalizime

KONTEKSTI STRATEGJIK

Hyrje

Strategjia ndërsektoriale “Për mbrojtjen e konsumatorëve dhe mbikëqyrjen e tregut 2024–2030” është dokumenti politik, i cili vendos në qendër të tij konsumatorët dhe synon fuqizimin e tyre për

një rol aktiv në treg, duke ushtruar të drejtat dhe fuqinë e tyre të zgjedhjes së mirinformuar në blerjen e mallrave dhe të shërbimeve.

Qeveria shqiptare është e përkushtuar ndaj synimeve të saj strategjike për integrimin e plotë të ekonomisë shqiptare në tregun e përbashkët të Bashkimit Evropian. Integrimi në BE rezulton në akses të hapur në tregun e më shumë se 500 milionë konsumatorëve, si dhe integrimin e ekonomisë shqiptare në tregtinë ndërkombëtare.

Strategjia synon rritje, zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës. Politika të mirëhartuara dhe të zbatuara për mbrojtjen e konsumatorëve u mundësojnë atyre të bëjnë zgjedhje të mirinformuara, duke ndikuar pozitivisht në krijimin e një konkurrence të ndershme dhe rritje të qëndrueshme, forcimin e besimit të konsumatorëve në blerjen e mallrave dhe të shërbimeve, me synimin final konsumatorë të fuqizuar që luajnë një rol aktiv në treg. Rritja e aftësisë së konsumatorëve për blerje të mirinformuara sjell padyshim rritjen e impaktit që ata kanë në forcimin e tregut funksional, nxitjen e inovacionit dhe rritjen ekonomike, duke rritur kërkesën për shumëllojshmëri dhe cilësi mallrash dhe shërbimesh me çmime konkurruese, hapjen e tregut dhe rritjen e punësimit.

Fuqizimi i konsumatorëve nuk është vetëm një e drejtë, por lidhet më së shumti me krijimin e një mjedisi të përgjithshëm që u mundëson atyre të shfrytëzojnë këto të drejta dhe të përfitojnë prej tyre, që do të thotë krijimin e një sistemi në të cilin ata mund të mbështeten dhe që u garanton sigurinë e mallrave dhe të shërbimeve, si dhe mbrojtjen efektive të interesave të tyre ekonomike, kur këto vihen në rrezik. Garantimi i qarkullimit të lirë të produkteve të sigurta në treg me të njëjtat kërkesa teknike me ato evropiane, qëndron në themel të politikave të konsumatorëve dhe një nga liritë themelore të përcaktuara në Traktatin e Funksionimit të BE-së. Rënia ekonomike, e kushtëzuar dukshëm nga situata globale e pandemisë COVID-19 dhe e konfliktit që çoi në luftën midis Rusisë dhe Ukrainës, solli ndikim në shumë fusha të jetës së konsumatorëve, duke nxjerrë në pah edhe boshllëqe në kuadrin e mbrojtjes së konsumatorëve e duke theksuar njëkohësisht rëndësinë për rritjen e nivelit të mbrojtjes së tyre. Hartimi dhe zbatimi i një kuadri efektiv ligjor merr një rëndësi parësore në rritjen e besimit të konsumatorëve në treg, duke ndikuar në raportin kërkesë-ofertë në treg, si motor i rigjenerimit të ekonomisë.

Kjo Strategji vjen në vijim të masave që përmbante strategjia e mëparshme e Mbrojtjes së Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjes së Tregut 2020, duke orientuar fushat që do të kenë më shumë vëmendje deri në vitin 2030.

Strategjia ndërsektoriale “Për mbrojtjen e konsumatorëve dhe mbikëqyrjen e tregut 2024–2030” është në përputhje me Programin e Qeverisë 2021–2025 dhe është pjesë përbërëse e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim. Ajo është në përputhje me parashikimet dhe parimet e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Ky dokument strategjik përbëhet nga tri shtylla kryesore që përfshijnë çështjet kryesore të mbrojtjes së konsumatorëve dhe mbikëqyrjes për periudhën 2024–2030:

I. Siguria e produkteve, ku përfshihen: siguria e produkteve ushqimore dhe e produkteve joushqimore; barnat për përdorim njerëzor; kozmetika; fusha e infrastrukturës së cilësisë; mbikëqyrja e tregut etj.

II. Çështje të mbrojtjes së konsumatorëve që nuk lidhen me aspektet e sigurisë (interesat ekonomike), ku përfshihen: praktikat tregtare; zbatimi i të drejtave të konsumatorëve; kushtet e padrejta në kontrata, zgjidhja alternative dhe *online* e mosmarrëveshjeve; mjedisi; turizmi; digjitalizimi etj.

III. Informimi dhe ndërgjegjësimi i konsumatorëve dhe i subjekteve, si dhe bashkëpunimi ndërinstytucional dhe me të gjithë aktorët e tjerë: organizatat e konsumatorëve, shoqëria civile, biznesi, akademikët etj.

KAPITULLI I SITUATA AKTUALE

I.1 Shtylla I: Siguria e produkteve ushqimore dhe e produkteve joushqimore

1.1 Siguria e produkteve ushqimore

Shqipëria synon të ndjekë një qasje të integruar me Bashkimin Evropian në fushën e sigurisë ushqimore që ka për qëllim të sigurojë një nivel të lartë të sigurisë ushqimore nëpërmjet masave koherente dhe monitorimit të përshtatshëm nga ferma në tavolinë, duke siguruar funksionimin efektiv të tregut të brendshëm dhe eksportin e produkteve ushqimore shqiptare në tregun evropian dhe më gjerë.

Objektivi strategjik i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është garantimi në shkallën më të lartë të shëndetit të konsumatorëve shqiptarë dhe përmirësimin e sistemit të mbikëqyrjes dhe garantimit të sigurisë ushqimore. Ky sistem do të shërbejë për mbrojtjen e shëndetit të konsumatorëve nga sëmundjet/dëmtimet, si pasojë e konsumit të produkteve ushqimore me origjinë bimë ose shtazore. Nga ana tjetër, do të garantojë dhe një konkurrencë të ndershme në treg të operatorëve të biznesit ushqimor.

Vizioni, prioritetet dhe qëllimet strategjike synojnë fuqizimin e një sistemi me funksionim të plotë të sigurisë ushqimore dhe të mbrojtjes së konsumatorit, nga ferma në tavolinë, që mbulon të gjithë vendin, si dhe monitorim dhe kontroll modern në përputhje me standardet e BE-së. Rëndësia e vendosjes së politikës ushqimore dhe të ushqyerit si një synim kyç i politikës së zhvillimit është një objektivi strategjik dhe reflekton trendet globale dhe vendore. Çdo hallkë e vetme e zinxhirit duhet të jetë shumë e fortë, në rast se synohet që shëndeti i konsumatorëve të jetë plotësisht i mbrojtur.

Ky parim është i vlefshëm pavarësisht nga fakti nëse ushqimet prodhohen në Shqipëri apo importohen nga vende të tjera. Për këtë arsye, Qeveria Shqiptare do të ketë në vëmendjen e saj forcimin e kontrollit dhe të monitorimit të ushqimeve që tregtohen në tregun shqiptar të destinuar për konsum human, si dhe të ushqimeve që përdoren për kafshë.

Qeveria shqiptare i konsideron politikat për sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorit si një prioritet i rëndësishëm. Këto politika janë nën përgjegjësinë e MBZHR-së, e cila është përgjegjëse për krijimin e kuadrit ligjor dhe koordinimin e harmonizimit të legjislacionit me kuadrin ligjor të BE-së, si dhe të strategjisë për zbatimin e këtyre politikave dhe legjislacionit në këtë fushë.

Si vend kandidat për anëtarësim të plotë në BE, Shqipëria është e angazhuar për të harmonizuar dhe për të zbatuar plotësisht *acquis* të BE-së. Legjislacioni i BE-së për sigurinë ushqimore, shëndetin e kafshëve dhe shëndetin e bimëve, siç përshkruhet në kapitullin 12 të *acquis* të BE-së, përbëhet nga më shumë se 440 pjesë legjislacioni. Për arritjen e një përafrimi të plotë, kërkohet rritje e kapaciteteve të institucioneve në politikëbërje dhe agjencive të përfshira në zbatimin e kontrolleve zyrtare.

MBZHR-ja ka përgjegjësinë për hartimin e politikave dhe të legjislacionit dhe ka bërë progres në procesin e transpozimit të legjislacionit shqiptar me atë të BE-së. Gjatë viteve 2017–2021 janë miratuar, në fushën e sigurisë ushqimore afërsisht 15 akte nënligjore dhe janë amenduar 3 ligje.

Institucionet e tjera të vartësisë, si: Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV), Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB) kanë përgjegjësinë për zbatimin e këtij legjislacioni.

Gjatë gjithë këtij procesi, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural angazhohet për të siguruar një komunikim efektiv me të gjitha palët e interesuara, duke përfshirë konsumatorët, operatorët e biznesit ushqimor dhe palët e tjera të interesuara në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal.

Për sa u përket strukturës, organizimit, kompetencave dhe shpërndarjes së burimeve përkatëse të administratës përgjegjëse për sigurinë ushqimore, politikat veterinarë dhe fitosanitare, ka një organizim të ri në nivel qendror bazuar në urdhrin e Kryeministrit nr. 88, datë 20.5.2022, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural” dhe urdhrin të ministrit nr. 318, datë 4.7.2022, “Për miratimin e strukturës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”.

Drejtoria e Politikave të Sigurisë Ushqimore (DPSU) është struktura përgjegjëse për çështjet e sigurisë ushqimore, e cila përbëhet nga tre sektorë: Sektori i produkteve dhe nënprodukteve me

origjinë shtazore, sektori i produkteve me origjinë joshkazore dhe bimore dhe sektori i produkteve të peshkimit. DPSU-ja është pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit.

DPSU-ja është përgjegjëse për hartimin e politikave, legjislacionit për sigurinë ushqimore duke përfshirë legjislacionin e BE-së dhe strategjitë në fushën e saj të përgjegjësisë. Në kuadër të PKIE-së, planifikohen hartimi i legjislacionit afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë në përputhje me kapitullin 12 të *acquis*. DPSU-ja është autoriteti përgjegjës për përgatitjen dhe pritjen e auditeve nga struktura e DG-SANTE, të cilët auditojnë sistemin e sigurisë ushqimore të vendit tonë, duke filluar nga legjislacioni, kontrolli zyrtar, rrjeti laboratorik dhe operatorët e biznesit ushqimor, të cilët kërkojnë për të eksportuar në vendet e BE-së. Qëllimi i auditeve është për të vlerësuar garancitë që japin autoritetet kompetente shqiptare, të cilat duhet të janë ekuivalente me ato të BE-së, me qëllim garantimin e jetës së konsumatorit evropian nga produktet ushqimore shqiptare që eksportohen në BE.

Është amenduar 2 herë ligji nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, në kuadër të reformës veterinare dhe të memorandumit Open Ballkan, me qëllim lehtësimin e tregtisë së kafshëve të gjalla midis vendeve të Ballkanit Perëndimor që janë pjesë e Open Ballkan.

Është amenduar 2 herë ligji nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, për harmonizim me të plotë me rregulloren 178/2002 të KE-së dhe në kuadër të Open Ballkan, për të lehtësuar tregtinë e produkteve ushqimore dhe ushqimit për kafshë midis Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë.

Gjithashtu, gjatë periudhës 2017–2021 janë miratuar 15 akte nënligjore si VKM, urdhra dhe udhëzime në përputhje me kapitullin 12 të *acquis*. Puna për hartimin e tyre përfshin përkthimin, përshtatjen dhe përgatitjen e tabelave të përputhshmërisë. Pas miratimit të tyre, struktura përgjegjëse për zbatimin e tyre është Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, si struktura përgjegjëse për kontrollet zyrtare në vendin tonë. DPSU-ja, si autoriteti përgjegjës për hartimin e politikave përgatit programet e monitorimit, për:

- Planin kombëtar të monitorimit të mbetjeve në kafshët e gjalla dhe produktet me origjinë shtazore;
- Planin për monitorimin e mbetjeve të pesticideve në produktet me origjinë bimore;
- Planin kombëtar të kontrolleve zyrtare me bazë risku dhe të marrjes së mostrave për ushqimin, ushqimin për kafshë, mbrojtjen e bimëve dhe inputeve bujqësore, si dhe planin e marrjes së mostrave në PIK;
- Planin e monitorimit të qumështit lëndë e parë në nivel ferme deri në vitin 2019.

Gjatë kësaj periudhe janë pritur 3 audite të DG-SANTES për peshkun, zorrët dhe mbetjet, për të cilat strukturat e sigurisë ushqimore shqiptare e kaluan me sukses.

1.2 Siguria e produkteve joushqimore

Vendosja në treg dhe garantimi i qarkullimit të lirë të produkteve të sigurta, me të njëjtat kërkesa teknike me ato evropiane, është bazë për çdo politikë të mbrojtjes së konsumatorëve dhe një nga liritë themelore të përcaktuara në Traktatin e Funksionimit të BE-së.

Zhvillimi i tregut të brendshëm dhe i infrastrukturës së cilësisë me institucionet përkatëse që mbulojnë fushat e standardizimit, metrologjisë, akreditimit dhe mbikëqyrjes së tregut, përbëjnë bazën e reformave në tregun e brendshëm, së bashku me përmirësimet e nevojshme të kuadrit ligjor dhe institucional, të cilat krijojnë premisat për vendime të rëndësishme lidhur me cilësinë e jetës së qytetarëve shqiptarë (mbrojtjen e jetës dhe shëndetit, mjedisit, sigurisë teknike në përgjithësi, mbrojtjen e konsumatorit) dhe sektorin privat (cilësinë e produkteve dhe shërbimeve të prodhuara dhe të tregtuara në Shqipëri).

Hapat e ndërmarrë në lidhje me fushën e sigurisë së produkteve kanë mundësuar adoptimin e një kuadri ligjor rregullator, që për konsumatorët përkthehet në legjislacion dhe institucione që mundësojnë nivel të njëjtë mbrojtjeje të sigurisë së tyre. Kuadri ligjor për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore dhe sigurisë së përgjithshme, së bashku me aktet

nënligjore në zbatim, që në masë të gjerë harmonizojnë *acquis* të BE-së në fushat përkatëse, në kuadër të angazhimit për përparimin në drejtim të procesit të integritetit të mëtejshëm të vendit, kanë forcuar bazën legislative dhe rregullatore, me synim garantimin e vendosjes në treg të produkteve në përputhje me të gjitha kërkesat teknike dhe të sigurta për konsumatorët, duke mundësuar kështu mbrojtjen dhe fuqizimin e tyre. Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e sigurisë së produkteve. Rreth 55% e akteve në këtë kapitull janë harmonizuar pjesërisht (30 akte), ndërkohë që 45% të akteve janë të paharmonizuara. Raporti i Komisionit Evropian për vitin 2021 përcakton, se: “*Shqipëria ka arritur një nivel përgatitje/është mesatarisht e përgatitur në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave. Vlerësohet se ka pasur progres të kufizuar në lidhje me përafrimin sektorial me acquis të produkteve për nënkapitullin “Përfaqja e re dhe globale”. Ndërsa ka pasur përparim në lidhje me parimet e përgjithshme dhe strukturat që lidhen me infrastrukturën e cilësisë, rekomandimet e vitit të kaluar mbeten të vlefshme, pasi nevojiten përpjekje për të siguruar më shumë përafrim legjislativ dhe për të forcuar zbatimin.*”. Ky raport rekomandon që Shqipëria duhet, veçanërisht:

- të përmirësojë kuadrin ligjor në përafrimin e legjislacionit të tij me *acquis* të BE-së duke fuqizuar rolin e konsumatorit në treg dhe
- të forcojë më tej kapacitetet e institucioneve zbatuese për të garantuar një mbrojtje sa më të lartë të konsumatorëve në treg.

Një aspekt i rëndësishëm mbetet edhe sigurimi i bashkëpunimit me operatorët ekonomikë në treg, për t’u garantuar konsumatorëve produkte dhe shërbime të sigurta.

Me qëllim fuqizimin e rolit të konsumatorëve në treg dhe garantimin për vendosjen në treg të produkteve të sigurta, në përputhje me përcaktimet dhe kërkesat e legjislacionit të BE-së, ministria përgjegjëse për ekonominë, si institucioni përgjegjës në këto fusha, gjatë periudhës 2017–2021, në fushën e sigurisë së produkteve ka miratuar 5 akte nënligjore, që kanë synuar përcaktimin e kërkesave themelore të sigurisë, për të garantuar një nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së jetës, shëndetit të njerëzve, sigurisë së përdoruesve, si edhe lëvizjen e lirë në treg të produkteve, në përputhje me kërkesat evropiane, për produkte të tilla si: pajisjet elektrike të tensionit të ulët, instrumentet e peshimit joautomatik, përputhshmëria elektromagnetike, pajisjet e aerosolit dhe pajisjet mbrojtëse personale.

Përveç kuadrit ligjor ekzistues dhe progresit të bërë deri më tani në kontekstin e harmonizimit të legjislacionit vendës me atë evropian, Shqipëria, gjithashtu, aktualisht disponon një draft të avancuar të një dokumenti me natyrë strategjike për fushën e lëvizjes së lirë të mallrave (*Roadmap*), i cili parashikon planifikimin e harmonizimit të mëtejshëm ligjor dhe institucional për të gjithë fushën e harmonizuar, për një periudhë 7-vjeçare. Ky dokument pritet të finalizohet, deri në fund të vitit 2022 dhe ka si qëllim planifikimin e harmonizimit të legjislacionit dhe ngritjen/forcimin e kuadrit institucional përgjegjës për zbatimin, për të gjithë fushën e harmonizuar.

Një tjetër arritje në aspektin e dokumenteve me natyrë strategjike është hartimi i Planit të Veprimit për Përputhshmërinë me nenet 34–36 të Traktatit të Funkcionimit të Bashkimit Evropian (TFBE). Ky plan veprimi synon shqyrtimin e gjithë kuadrit ligjor shqiptar që rregullon tregtimin e produkteve, identifikimin, vlerësimin dhe shfuqizimin (apo mbajtjen e argumentuar) të masave me efekt të njëjtë me kufizimet sasiore për import/eksportin e tyre, të cilat janë të ndaluara sipas neneve 34–36 të TFBE-së (shkurt barrierat jotarifore të pajustificuara në tregti me vendet e BE-së). Faza e parë e këtij plani veprimi, me 18 sektorë/grup produktesh të analizuara, është finalizuar në dhjetor 2022, ndërkohë që faza e dytë, ku do të përfshihen potencialisht të gjithë sektorët/produktet e tjera.

Për shkak të kompleksitetit të procesit të identifikimit të barrierave dhe analizës së tyre, si edhe shtrirjen horizontale të këtij procesi, siç u përmend më sipër, analiza ka nisur fillimisht me 18 sektorë/produkte të përzgjedhur. Pas përfundimit të procesit të identifikimit dhe të analizës së masave/barrierave, si dhe konsultimeve me institucionet përgjegjëse, rezulton si më poshtë:

- janë analizuar 60 akte ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë tregtimin e produkteve;
- janë konsultuar 40 akte ligjore të BE-së relevante, të cilat janë harmonizuar me këto akte apo rregullojnë produktet në fjalë;

- janë identifikuar 28 barriera.

Grafik nr. 1: Barrierat sipas akteve



Grafik nr. 2: Barrierat sipas sektorëve



Ky dokument pritet të përditësohet më tej në vitet në vijim, duke shtrirë analizën në një shkallë më të gjerë të produkteve/sectorëve.

Krijimi i Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, mbështetur në legjislacionin e sigurisë së produkteve, ka ndikuar, gjithashtu, në forcimin më tej të zbatimit të standardeve dhe të legjislacionit për sigurinë e produkteve në treg dhe mbrojtjen e konsumatorëve, duke siguruar monitorim dhe kontroll të tregut, si dhe zhvillimin e mjeteve parandaluese të rrezikut nëpërmjet informimit, këshillimit dhe bashkëpunimit.

Pavarësisht arritjeve të viteve të fundit, sfidat për të ardhmen lidhen me vijimin e përmirësimit të legjislacionit, sidomos për ata sektorë/produkte për të cilët ende nuk ka një bazë legjislative/rregullatore të harmonizuara, me qëllim sigurimin e ofrimit të produkteve të sigurt dhe në përputhje me gjithë kërkesat, veçanërisht në kuadër të procesit të integritetit dhe të përshtatjes me ndryshimet e legjislacionit evropian në këtë fushë, si dhe edukimin dhe ndërgjegjësimin e mëtijshëm të operatorëve ekonomikë në treg dhe konsumatorëve, për detyrimet/të drejtat përkatëse dhe parashikimet e legjislacionit që i mundësojnë mbrojtjen e këtyre të drejtave në transaksionet e blerjes së mallrave dhe të shërbimeve, përmes zhvillimit të fushatave/aktiviteteve të ndërgjegjësimi, informimit, edukimit. Impakti i përmirësimit të legjislacionit në fushën e sigurisë së produkteve joushqimore lidhet me ofrimin e një niveli më të lartë mbrojtjeje të interesave publikë, si: shëndeti dhe siguria në përgjithësi, mbrojtjen e konsumatorëve, mbrojtjen e mjedisit, sigurinë publike dhe çdo interes tjetër publik. Zbatimi i këtyre kërkesave është thelbësor për mbrojtjen e duhur të këtyre interesave dhe për të krijuar kushte në të cilat konkurrenca e ndershme mund të lulëzojë.

Transpozimi i legjislacionit evropian specifik për produktet nën kapitullin 1 të *acquis*, “Lëvizja e lirë e mallrave”, me qëllim heqjen e barrierave teknike të panevojshme në tregti, promovimin e një ambienti të lirë konkurrues dhe krijimin e të njëjtit nivel mbrojtjeje të konsumatorëve shqiptarë me ata evropianë, është dhe mbetet prioritet i gjithë ministrive, sipas fushave përkatëse të përgjegjësisë.

Me qëllim arritjen e një shkalle më të lartë të transpozimit, mbështetur në rekomandimet e dhëna në raportprogresin për Shqipërinë, nevojitet vijimi i punës për përafrimin e *acquis* në fusha të tilla, si: pajisjet e gazit, pajisjet dhe sistemet mbrojtëse që përdoren në ambiente (atmosfera) potencialisht shpërthyes, mjetet motorike, praktikant e mira laboratorike, prekursorët e drogave, instalimet teleferike të projektuara për transport personash, produktet e ndërtimit etj.

Sfida për funksionimin e institucioneve teknike efektive në garantimin e produkteve dhe të shërbimeve ndaj operatorëve ekonomikë, nëpërmjet infrastrukturës së cilësisë dhe të mbikëqyrjes së tregut, lidhet edhe me përmirësimin, rritjen e kapaciteteve institucionale të tyre, përfshirjen në organizma evropianë në nivel institucional dhe sektorial, përmirësimin e procedurave dhe mbarëvajtjen e punës për të garantuar funksionimin e një tregu të brendshëm në nivelet më të larta të sigurisë së produktit/shërbimit dhe mbrojtjen e interesave ekonomikë të konsumatorëve.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit funksionon bazuar në VKM-në nr. 112, datë 2.3.2022, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit”. Ky institucion e ushtron veprimtarinë e tij, ndër të tjera dhe në përputhje me legjislacionin sektorial

për fushën e mjedisit dhe kimikateve. MTM-ja është autoriteti kompetent në zbatim të ligjit nr. 27/2016, datë 17.3.2016, “Për menaxhimin e kimikateve”.

Prej vitit 2018, në vendin tonë ka nisur të zbatohet ligji nr. 27/2016, datë 17.3.2016, “Për menaxhimin e kimikateve”, i cili ka transpozuar pjesërisht dy rregulloret e BE-së, rregulloren (KE) nr. 1907/2006 (REACH) dhe rregulloren (KE) nr. 1272/2008 (CLP). Këto dy rregullore kanë një kontribut thelbësor mbi klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e produkteve që përmbajnë kimikateve.

Sistemi i Harmonizuar Global i Klasifikimit dhe Etiketimit të Kimikateve (GHS), ndihmon transmetimin e informacionit që është në dispozicion mbi rreziqet e kimikateve, nga prodhuesit te përdoruesit finalë. Në Shqipëri, ky sistem zbatohet nëpërmjet VKM-së nr. 488, datë 29.6.2016, “Për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve”, e cila transponon rregulloren e BE-së nr. 1272/2008. Falë CLP-së, rreziqet e kimikateve u komunikohen qartë punëtorëve dhe konsumatorëve përmes etiketave, piktogrameve, deklaratave standarde të rrezikut, paralajmërimit etj., që përdoren për çdo klasë dhe kategori rreziku, me qëllim paralajmërimin e tyre dhe marrjen e masave përkatëse.

REACH-i është rregullorja evropiane e cila bën rregullim të procedurave të vlerësimit dhe të monitorimit të dokumentacionit për kimikateve në treg, dhe në legjislacionin shqiptar është përafshuar (pjesërisht), nëpërmjet ligjit nr. 27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve” dhe 3 VKM-ve në zbatim të tij që kanë transpozuar deri tani 12 nga 17 anekse që përmban REACH.

Ky legjislacion kontribuon në vendosjen në treg të artikujve dhe produkteve më të sigurta për konsumatorin. REACH-i, ndër të tjera rregullon substancat të cilat në formën e tyre të pastër ose të përzier, kanë si synim edhe përdorimin profesional ose përdorimin nga konsumatorët.

Kuadri ligjor në fuqi për kimikateve, kontribuon në përdorimin më të sigurt të kimikateve edhe nëpërmjet kufizimit, ndalimit të përdorimit të substancave të rrezikshme dhe zëvendësimin e tyre me alternativa më të sigurta.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, gjatë periudhës 2016–2021 është angazhuar për të arritur në plotësimin e legjislacionit sekondar për kimikateve. Konkretisht, me qëllim mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut nga kimikateve të rrezikshme janë miratuar 9 akte nënligjore dhe 1 ligj, të cilët përmbushin gjithë zinxhirin e zbatimit të legjislacionit për kimikateve në Republikën e Shqipërisë.

Në kuadër të rritjes së nivelit të informimit dhe mbrojtjes së konsumatorit janë miratuar edhe aktet ligjore:

- Ligji nr. 7/2020, datë 3.2.2020, “Për ratifikimin e Konventës së Minamatës ‘Për merkurin’”, prej datës 26 maj 2020. Shqipëria listohet përkrah shteteve që kanë ratifikuar Konventën e Minamatës “Për merkurin”, duke kontribuar në mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit nga efektet negative të merkurit dhe pajisjet e produktet që kanë merkur përmbajtjen e tyre.

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 830, datë 24.12.2021, “Për masat lidhur me sigurimin e informacionit mbi konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂ gjatë marketingut të automjeteve të reja”, i cili synon vënien në dispozicion të konsumatorëve informacionin mbi konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂ në automjetet e reja të pasagjerëve që ofrohen për shitje ose për dhënie me qira në Shqipëri, me qëllimin që t’u mundësojë konsumatorëve të bëjnë një zgjedhje të bazuar në informacione plotë.

Struktura përgjegjëse që angazhohet në hartimin dhe harmonizimin e legjislacionit për kimikateve (REACH, CLP, POPs, mercuri, asbesti, dhe import-eksportin e kimikateve të rrezikshme) në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, është Drejtoria e Përgjithshme për Zhvillimin e Mjedisit.

Për të forcuar zbatimin e legjislacionit kombëtar “Për menaxhimin e kimikateve” dhe rritjen e kapaciteteve administrative, në korrik të vitit 2020 pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit u krijua Zyra e Kimikateve, me një staf prej 4 punonjësish.

Në kuadër të informimit të konsumatorëve dhe publikut, prej vitit 2021 realizohet publikimi i informacionit të nevojshëm në lidhje me kimikateve nëpërmjet *website*-t zyrtar (<https://akm.gov.al/kimikateve>). Rubrika e dedikuar për kimikateve, përmban informacion të përditësuar mbi legjislacionin në fuqi për kimikateve, pesticidet dhe biocidet, informacione të dhëna

për pesticidet, në tokë, ajër e ujë, si dhe udhëzime për përdorimin e sigurt të tyre, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit. Zyra e Kimikateve ndër të tjera, ka përgjegjësi ofrimin e shërbimit të informacionit (*helpdesk*) për të këshilluar prodhuesit, importuesit, përdoruesit e tjerë dhe çdo palë tjetër të interesuar, për përgjegjësitë dhe detyrimet e tyre përkatëse në bazë të këtij ligji. Palët e interesuara, mund t'i drejtohen Zyrës së Kimikateve, nëpërmjet adresës së *e-mail*-it: info.kimikatet@akm.gov.al.

Megjithatë, duke qenë se menaxhimi i kimikateve është një fushë gjithëpërfshirëse që prek shumë sektorë, si dhe nisur prej faktit që legjislacioni i kimikateve në nivel evropian përditësohet në mënyrë të vazhdueshme, ky sektor përballlet me sfida në drejtim të përmirësimit të mëtejshëm të kuadrit ligjor dhe rritjes së nivelit të zbatimit të legjislacionit kombëtar, për të garantuar një treg të sigurt dhe të qëndrueshëm për konsumatorët. Sfidat që paraqiten, të cilat do të jenë në fokus të angazhimit të MTM-së dhe institucioneve të linjës për t'u adresuar, janë:

- a) hartimi i një plani kombëtar për menaxhimin e sigurt të kimikateve;
- b) mungesa e një databaze kombëtare që të japë një pasqyrë të qartë të kimikateve, produkteve kimike që janë importuar dhe vendosur në treg vitet e fundit në vendin tonë dhe nevoja për ngritjen e regjistrit kombëtar të kimikateve;
- c) ndërgjegjësimi i grupeve të interesit mbi kimikatet e rrezikshme dhe përdorimin e produkteve të sigurta;
- d) përdoruesit, grupet e interesit, konsumatorët nuk janë të familjarizuar me udhëzimet dhe masat e sigurisë për mbrojtjen ndaj kimikateve;
- e) kapacitetet teknike që angazhohen në këtë fushë duhet të forcohen më tej.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka mision hartimin dhe zbatimin e politikave e strategjive të zhvillimit në sektorin e kujdesit shëndetësor. Ajo është përgjegjëse për rregullimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe për bashkërendimin e punës ndërmjet të gjithë aktorëve, brenda dhe jashtë sistemit të kujdesit shëndetësor, të cilët kontribuojnë dhe synojnë të garantojnë të drejtën kushtetuese, të përcaktuar në nenin 55 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale harton dhe zbaton politikat për pajisjet mjekësore referuar kuadrit rregullator evropian dhe praktikave më të mira botërore.

Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore është institucion në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë, përgjegjës për regjistrimin dhe inspektimin e pajisjeve mjekësore.

Gjatë viteve 2019, 2020, 2021 dhe deri më 10 tetor 2022 nga inspektorët janë inspektuar dhe kontrolluar subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e pajisjeve mjekësore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, në zbatim të ligjeve të sipërpërmendur, nga ku rezultojnë të dhënat si më poshtë:

- Masa administrative të marra në rast konstatimi të shkeljes së legjislacionit në fuqi. Në kontrollet e ushtruara në subjektet e pajisje mjekësore, janë konstatuar shkelje që përbëjnë kundërvajtje administrative në zbatim të ligjit nr. 21/2020, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 89/2014".

- Janë kryer inspektime në depo të pajisjeve mjekësore për vitet 2019, 2020, 2021 dhe deri 10 tetor 2022, respektivisht 82, 51, 91 dhe 93 inspektime për të cilat janë marrë gjithsej 50 masa administrative dënim me gjobë për subjektet e pajisjeve mjekësore.

- Forcim kapaciteteve administrative shtimi i kompetencave tek ISHSH-ja, duke forcuar në këtë mënyrë rolin e konsumatorit në treg për sa u takon produkteve të kozmetikës.

Zbatimi i ligjit për pajisjet mjekësore ka garantuar përdorimin e pajisjeve të certifikuara nga organe të njohura certifikues duke garantuar sigurinë e pacientëve, përdoruesve dhe produktet e kozmetikës.

Që prej vitit 2020, regjistrimi i pajisjeve mjekësore realizohet sipas klasave dhe kategorive që në momentin kur hyjnë në doganë, duke garantuar vetëm qarkullimin e pajisjeve që plotësojnë standardet dhe garantojnë mbrojtjen e përdoruesve.

Me qëllim garantimin e prodhimit të pajisjeve mjekësore në përputhje me standardet evropiane, si dhe garantimin e sigurisë së ruajtjes, transportit dhe shpërndarjes së pajisjeve mjekësore, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale fillon së shpejti licencimin e prodhuesve dhe tregtuesve të pajisjeve mjekësore.

Për herë të parë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka hartuar udhëzuesin për hetimet klinike që kryhen me pajisjet mjekësore, ku ka përcaktuar rregullat për aplikimin, miratimin, kryerjen dhe raportimin e hetimeve klinike të pajisjeve mjekësore në Republikën e Shqipërisë.

Hetimet klinike të pajisjeve mjekësore do të vlerësojnë sigurinë ose/dhe performancën e një pajisjeje mjekësore në drejtim të përdorimit të saj në parandalimin, diagnostikimin ose trajtimin e sëmundjeve.

Hetimet klinike do të kryhen vetëm pasi Komiteti i Etikës Mjekësore për Pajisjet Mjekësore ka dhënë më parë miratimin e tij për zhvillimin e këtij hetimi. Miratimi jepet pas një vlerësimi të thellë ku më kryesore është kryerja e hetimit pa cenuar sigurinë e subjekteve. Shqyrtim i veçantë kryhet për kategori të veçanta, si: fëmijët, gratë shtatzëna etj. Kryerja e çdo hetimi klinik parashikon certifikimin e njohjes dhe marrjen e pëlqimit të informuar nga të gjitha subjektet.

Me qëllim rritjen e sigurisë së konsumatorit që konsumon pajisje mjekësore që tregtohen me anë të internetit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale përcaktoi me anë të një urdhri kriteret për tregtimin e pajisjeve mjekësore nëpërmjet internetit. Për shkak të rrezikshmërisë së përdorimit të kategorive të caktuara të pajisjeve mjekësore, vetëm pajisjet mjekësore të klasifikuara me rrezikshmëri të ulët mund të tregtohen nëpërmjet internetit.

Me qëllim mbrojtjen e konsumatorit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale hartoi rregulloren mbi publicitetin e pajisjeve mjekësore. Ky akt rregullator ndalon publicitetin e çdo pajisjeje mjekësore që nuk plotëson kushtet e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi për pajisjet mjekësore. Me qëllim mbrojtjen e konsumatorëve, publiciteti i pajisjeve mjekësore nuk duhet të bëhet në mënyrë inkurajuese për konsum si mallrat e përgjithshme të konsumit, por duhet të bazohet në informacione profesionale dhe duhet të sigurojë informacion të mjaftueshëm duke përfshirë gjithë elementet e nevojshme, si: përfitimet, rreziqet e trajtimit, çmimet, rimbursimi. Në publicitetin e pajisjeve mjekësore ndalohet çdo informacion që përshkruan funksione dhe veçanti të pajisjes, të cilat pajisja realisht nuk i ka; krijon një përshtypje false lidhur me trajtimin, diagnozën, funksionet ose veçoritë, të cilat pajisja nuk i ka; sugjeron përdorime të pajisjes, të ndryshme nga ato që ajo ka, për të cilat është marrë vlerësimi i konformitetit dhe që i shërbejnë qëllimit të pajisjes; ofron dhurata apo konkurse apo çmime që lidhen me promovimin e pajisjeve mjekësore drejtuar pacientëve dhe konsumatorëve; krijon përshtypjen se përdorimi i pajisjes mjekësore është pa rrezik; u drejtohet ekskluzivisht ose kryesisht fëmijëve apo të jetë i tillë që mund të çojë në vetëdiagnozë të gabuar, ose përdorim, në terma të ekzagjeruar, alarmues ose mashtrues, imazhe, ilustrime etj., të ndryshimeve në trupin e njeriut.

Sfidat lidhen me garantimin e plotë të sigurisë së pacientëve dhe përdoruesve nëpërmjet plotësimit të mëtejshëm të kuadrit rregullator për pajisjet mjekësore dhe zbatimit të legjislacionit në fuqi.

Sfidë mbetet përdorimi i sigurt i pajisjeve mjekësore dhe kontrolli në vazhdimësi i konformitetit të pajisjeve mjekësore dhe produkteve kozmetike, si dhe garantimi që vetëm pajisjet e certifikuara vendosen në treg dhe përdoren nga pacientët dhe përdoruesit.

1.3 Infrastruktura e cilësisë

Ekzistenca e infrastrukturës së cilësisë funksionale është një parakusht për integrimin e ngushtë të ekonomive në zhvillim në zinxhirët globalë të vlerave. Mirëfunksionimi i infrastrukturës së cilësisë nuk do të hapë vetëm derën për prodhuesit në vendet në zhvillim ndaj tregjeve fitimprurëse në vendet e zhvilluara, por gjithashtu do të ndihmojë prodhuesit e vendeve në zhvillim të ngrenë standardin e proceseve të tyre të prodhimit. Ky përmirësim në aftësinë e tyre prodhuese është jetësor për përmirësimin e vazhdueshëm të mjeteve të jetesës në vendet në zhvillim. Garantimi i konkurrencës në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare siguron që ndërmarrjet mund të mbajnë

tregjet e tyre kombëtare, nga ana tjetër, qasja në tregje të reja lejon ndërmarrjet të zgjerohen. Zgjerimi ndihmon në krijimin e vendeve të reja të punës dhe të ardhura më të larta ekonomike. Kjo kontribuon dhe shtyn drejt zhvillimit më të lartë teknologjik, ekonomik dhe social, në mënyrë që vendet të fillojnë ose të vazhdojnë rrugën për të arritur konkurrencë më të madhe dhe një cilësi më të mirë të jetës bazuar në një infrastrukturë kombëtare të cilësisë.

Përmirësimi i aksesit në treg lehtëson diversifikimin e produktit dhe rrit mundësitë për investime, rrit produktivitetin nga reduktimi i kostove të tregtisë duke shmangur dyfishimin në testimin dhe inspektimin, thjeshtimin e operacioneve dhe eliminimin e rregullave kufizuese. Përfitimi nga ekonomitë e shkallës sigurohet përmes metodave të përmirësuara dhe të standardizuara të punës dhe ndërveprimit midis prodhuesve përgjatë zinxhirit të vlerës. Rritja e përhapjes së inovacionit, teknologjisë, si dhe përpjekjet për të nxitur infrastrukturën e cilësisë në vendet partnere kanë bërë tashmë një rrugë të gjatë drejt zgjerimit të konkurrencës, duke i bërë në këtë mënyrë proceset e prodhimit më miqësore ndaj mjedisit, duke përmirësuar mbrojtjen e konsumatorit dhe duke nxitur bashkëpunimin rajonal. Një infrastrukturë cilësie funksionale dhe e aksesueshme nga operatorët ekonomikë do të ndikojë që prodhuesit shqiptarë të kenë akses në një treg më të madh për produktet dhe shërbimet e tyre, me kosto më të ulëta dhe me më pak pengesa administrative, ndërsa në të njëjtën kohë do të reduktojnë ndjeshëm kohën për të tregtuar.

Importuesit dhe shpërndarësit shqiptarë do të pësojnë një ulje të ndjeshme të kostove të importit dhe do të mund të rrisin përfitimin dhe qëndrueshmërinë ekonomike të biznesit të tyre. Integrimi në BE do të sigurojë një fushë loje të barabartë dhe do të promovojë konkurrencë të ndershme për të gjithë operatorët ekonomikë të përfshirë në tregtinë e mallrave (prodhim, import, eksport), pasi ata do të duhet të zbatojnë një sërë rregullash të përbashkëta për produktet dhe standardet e sigurisë.

Prodhuesi shqiptar do të përfitojë nga rritja e kapaciteteve prodhuese si rezultat i aksesit në mjete më të mira prodhimi. Konsumatorët shqiptarë do të përfitojnë nga çmimet më të ulëta dhe nga rritja e disponueshmërisë së produkteve cilësore dhe të sigurta.

Standardizimi

Objektivi i Qeverisë Shqiptare në fushën e standardizimit është ngritja dhe funksionimi i një sistemi kombëtar standardizimi në përputhje me parimet e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT) – Marrëveshja mbi Barrierat Teknike në Tregti, legjislacionin/rregulloret evropiane për këtë fushë dhe mënyrën e operimit të organizmave evropianë e ndërkombëtarë të standardizimit, si: ETSI, CEN&CENELEC dhe ISO&IEC.

Organizimi dhe funksionimi i këtij sistemi duhet të pasqyrojë interesat e konsumatorëve dhe të gjithë palëve të tjera të interesuara në procesin e standardizimit në të gjitha nivelet, duke ofruar standardet bashkëkohore dhe zgjidhjet teknologjike, për të pasur produkte e shërbime të sigurta dhe me cilësi të lartë.

Aktualisht Shqipëria është anëtare me të drejta të plota në Institutin Evropian të Standardeve të Telekomunikacionit (ETSI), anëtare pa të drejtë vote në organizmat evropianë të standardizimit CEN/CENELEC dhe në proces vlerësimi nga CEN&CENELEC për plotësimin e kriterëve të anëtarësimit të plotë në këta organizma. Gjithashtu, anëtar pa të drejtë vote në organizmat ndërkombëtarë të standardizimit ISO dhe IEC. Bazuar në legjislacionin në fuqi, sistemi i standardizimit përfaqëson interesat e vendit dhe kontribuon në hartimin e standardeve evropiane dhe ndërkombëtare.

Nga përdorimi i Standardeve Shqiptare të publikuara kanë përfituar konsumatorët, të cilët janë furnizuar me produkte e shërbime të sigurta për shëndetin dhe me cilësi të lartë. Kështu, mund të përmendim standardet e metodave të provave për cilësinë e ujit, mikrobiologjia e ushqimeve për njerëzit dhe të kafshëve, cilësinë dhe vlerat proteinike të qumështit dhe miellit për përdorim për njerëzit etj.

Nga parashikimet e strategjisë për periudhën 2017–2021 u realizuan:

- adoptimi i 8.465 standardeve evropiane e ndërkombëtare si Standarde Shqiptare (SSH);
- u adoptuan si SSH me përkthim të plotë 38 standarde (të fushës së ndërtimit – eurokodet);

- u përgatitën dhe u publikuan mbi 300 artikuj/njoftime e shkrime sensibilizuese sa u përket zhvillimeve në fushën e standardeve, si dhe mbi 400 ekstrakte të fushave të standardeve me interes për biznesin dhe konsumatorin;


- u publikuan 20 buletine informative dhe 5 katalogë të standardeve shqiptare;

- u transpozua rregullorja e BE-së 1025/2012, “Për standardizimin evropian”, me VKM nr. 382/2018, “Për veprimtarinë e standardizimit”, si dhe u rishikuan 5 rregullore të brendshme të DPS-së që kanë të bëjnë me rregullat për veprimtarinë e standardizimit, hartimin dhe adoptimin e standardeve, organizimin e Komiteteve Teknike (KT) të DPS-së dhe pjesëmarrjen e KT-ve të DPS-së në punën evropiane të standardizimit;

- përfundoi përgatitja e gjithë dokumentacionit për aplikimin për anëtarësim me të drejta të plota në CEN&CENELEC. Në qershor 2021 u dorëzua në Qendrën e Menaxhimit të CEN&CENELEC (CCMC) kërkesa zyrtare për t’u bërë anëtare me të drejta të plota në CEN&CENELEC;

- u realizua shitja e rreth 7.000 standardeve kombëtare.

Grafik nr. 3. Paraqitje e aktiviteteve të realizuara në fushën e standardizimit



Mbetet sfida për periudhën e kësaj strategjie pjesëmarrja e Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit (në zbatim të neni 9 të ligjit nr. 9870/2008, “Për standardizimin”, i ndryshuar) në Njësinë Ndërkombëtare të Standardeve të Telekomunikacionit (ITU-T) dhe fillimi i adoptimit të tyre si Standarde Shqiptare (SSH), në mënyrë që operatorët ekonomikë dhe konsumatori vendës të përfitojnë nga qasja në procesin e hartimit, miratimit dhe publikimit të standardeve të kësaj fushe. Gjithashtu, sfida mbetet edhe plotësimi i kriterëve për anëtarësim me të drejta të plota në dy organizmat evropianë të standardizimit CEN dhe CENELEC; rritja e numrit të stafit të Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit për të përballuar volumin e madh të punës dhe funksioneve që duhet të kryhen në përputhje me procedurat e punës, siç kërkohen nga Guida 22 e CEN&CENELEC “Struktura organizative dhe proceset për vlerësimin e kriterëve për anëtarësim me të drejta të plota në CEN&CENELEC”; trajnimi i gjithë stafit (ekzistues dhe atij të ri); vazhdimi i punës për adoptimin e standardeve evropiane të publikuara nga CEN&CENELEC/ETSI e atyre ndërkombëtare të publikuara nga ISO/IEC, si SSH, si dhe rritja e numrit të përdorimit të tyre në praktikë. Gjithashtu, rritja e pjesëmarrjes aktive të ekspertëve në Komitetet Teknike në nivel kombëtar dhe evropian e ndërkombëtar është një tjetër sfida e kësaj strategjie për fushën e standardizimit.

Akreditimi

Organizmi kombëtar i akreditimit është autoriteti publik i akreditimit që vepron si shërbimi kombëtar i akreditimit në Republikën e Shqipërisë dhe është në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Bazuar në ligjin nr. 116/2014, “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të

konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ky organizëm ka të drejtë të ofrojë shërbimin e akreditimit të:

- laboratorët testues;
- laboratorët kalibrues;
- laboratorët mjekësorë;
- organet certifikuese të sistemeve të menaxhimit;
- organet certifikuese të personave;
- organet certifikuese të produkteve;
- organet inspektuese;
- organizatorët e testeve të zotësisë;
- prodhuesit e materialeve referuese të certifikuara.


Akreditimi i organeve të vlerësimit të konformitetit (OVK) kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet ndërkombëtare për akreditimin dhe dokumentet e organizmave ndërkombëtarë dhe evropianë për akreditimin.

Gjatë viteve 2017–2021 janë hedhur shumë hapa para në rrugën e zgjerimit të marrëveshjeve të njohjes reciproke. Konkretisht në vitin 2018 organizmi kombëtar i akreditimit u bë nënshkruese e EA-MLA (marrëveshjeve të njohjes reciproke) në fushën e inspektimit dhe certifikimit të sistemeve të menaxhimit, si dhe duke mbetur një nënshkrues i EA-MLA-s në fushën e testimit. Gjithashtu, më datë 31 tetor 2018 organizmi kombëtar i akreditimit ka firmosur Marrëveshjen Multilaterale me IAF (*International Accreditation Forum*) dhe ILAC (*International Laboratory Accreditation Cooperation*), sipas së cilës organizmi kombëtar i akreditimit pranohet anëtare e këtyre organizmave për certifikimin e sistemeve të menaxhimit. Organizmi kombëtar i akreditimit ka firmosur EA MLA në fushën e certifikimit të personave më datë 21 prill 2020 dhe ka kaluar në mënyrë të suksesshme tranzicionin e standardit ISO/IEC 17011:2017.

Së fundi, ky organizëm kaloi me sukses vlerësimin e kryer nga EA (Organizata Evropiane e Akreditimit) më datat 1–5 shkurt 2021 dhe 12–16 prill 2021, fakt i cili solli që EA të konfirmonte më 26 tetor 2021 se organizmi kombëtar i akreditimit mbetet një nënshkruese e EA - MLA në fushat e testimit (EN ISO/IEC 17025), Inspektimit (EN ISO/IEC 17020), certifikimit të sistemeve të menaxhimit (EN ISO/IEC 17021-1), certifikimit të personave (EN ISO/IEC 17024). Rivlerësimi tjetër i plotë do të bëhet në shkurt 2025. Nënshkrimi i këtyre marrëveshjeve përbën jo vetëm një arritje shumë të madhe për vetë organizmin kombëtar të akreditimit, por ka impakt shumë të rëndësishëm te konsumatorët dhe në eksport. Marrja e shërbimeve të vlerësimit të konformitetit të akredituara nga organizëm akreditues i njohur ndërkombëtarisht, çon në rritjen e besueshmërisë së konsumatorëve për shërbimet dhe produktet që ato konsumojnë, si dhe vendosjen në treg të produkteve dhe shërbimeve të testuara dhe certifikuara, duke mbrojtur interesat ekonomike të konsumatorëve.

Në lidhje me eksportet, nënshkrimi i këtyre marrëveshjeve mundëson që një organ i vlerësimit të konformitetit nuk do të akreditohet më shumë se një herë për të njëjtën fushë akreditimi, duke mundësuar lëvizjen e lirë të produkteve dhe shërbimeve në tregjet e huaja pa iu nënshtruar riestimit ose ricertifikimit në vendin hyrës, duke e bërë kështu akreditimin të shërbejë si një pasaportë e vlefshme në të gjitha tregjet ndërkombëtare. Fitimi i këtij statusi nga ana e DPA-së solli si pasojë që gjatë viteve 2017–2021 të konstatohet një rritje e konsiderueshme e numrit të aplikimeve për akreditim dhe, si rrjedhim, edhe një rritje e numrit të organeve të vlerësimit të konformitetit të akredituara në këto fusha, duke sjellë si domosdoshmëri rishikimin e strukturës dhe kategorisë së pagës së punonjësve të organizmit kombëtar të akreditimit. Me urdhrin nr. 2, datë 12.1.2021, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit” u miratua struktura dhe organika e re ku numri i punonjësve u rrit nga 14 në 20.

Grafik nr. 4. Paraqitje e aktiviteteve në fushën e akreditimit



Gjatë viteve 2017–2021 u arrit:

- Miratimi i vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me vendimin nr. 402, datë 13.5.2015, me vendimin nr. 823, datë 23.11.2016, me vendimin nr. 797, datë 29.12.2017 dhe me vendimin nr. 80, datë 14.2.2018”, i cili parashikon se autoritetet kontraktore për të siguruar cilësinë e produkteve dhe shërbimeve në përputhje me kërkesat e standardeve, mund t’u kërkojnë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Shoqëritë përfituese nga fondet publike duke qenë të certifikuar nga organizma certifikues të akredituar, kryenin shërbime të besueshme dhe me cilësi për konsumatorët shqiptarë.

- Digjitalizimi i të gjithë procedurës së akreditimit në vitin 2018. Aktualisht ky sistem elektronik është i lidhur me platformën *e-Albania*.

- Dyfishimi i numrit të vlerësuesve të rekrutuar që përdoren në vizitat vlerësuese.

Sfidë për organizmin kombëtar të akreditimit deri në periudhën 2030 është njohja evropiane e raporteve të ekzaminimeve mjekësore, certifikatave të kalibrimit dhe certifikatave të certifikimit të lëshuara nga laboratorët mjekësorë, laboratorët kalibruar dhe organet certifikuese të produkteve të akredituara prej tij. Gjithashtu, sfidë mbetet rritja e numrit të aplikimeve për akreditim dhe promovimi sistematik dhe i programuar i rolit të akreditimit, në mbrojtjen e konsumatorëve dhe në tregtinë e lirë.

Metrologjia

Metrologjia është një element i pandashëm i infrastrukturës bazë të çdo ekonomie moderne dhe funksionimi i saj është ndër parakushtet bazë për efikasitetin dhe sigurinë e funksionimit të shoqërisë, arritjen e cilësisë dhe konkurrueshmërisë së produkteve dhe shërbimeve. Harmonizimi në metrologji kontribuon ndjeshëm në eliminimin e barrierave teknike në tregti, mbrojtje më të madhe të konsumatorëve dhe interesave të tjera publike. Ligji nr. 126/2020, “Për metrologjinë” rregullon sistemin e njësive ligjore të matjes, etalonet e matjeve, bazat për të siguruar gjurmueshmërinë e matjeve, kontrollin meteorologjik ligjor të instrumenteve matëse dhe rregullat për organizimin e funksionimit të sistemit kombëtar meteorologjik në Republikën e Shqipërisë.

Një ndër misionet e Metrologjisë është mbrojtja e konsumatorëve, nëpërmjet organizimit të kontrollit të instrumenteve matëse në fushat e transaksioneve zyrtare dhe tregtare, mbrojtjes së shëndetit, mjedisit dhe sigurisë teknike, si dhe kontrollit sasior të parapaketimeve. Një sistem efikas dhe mirëfunksionues i metrologjisë ligjore ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve, në efektivitetin e aktivitetit të gjithë sektorit publik dhe në rritjen efektive ekonomike në sektorin privat.

Fushat bazë të veprimtarisë së infrastrukturës meteorologjike janë: metrologjia shkencore, metrologjia industriale dhe metrologjia ligjore. Njohuritë për metrologjinë dhe ofrimin e shërbimeve në metrologji, të cilat ofrohen nga sistemi kombëtar i metrologjisë, kanë një ndikim të rëndësishëm në mbarrëvajtjen e përditshme të ekonomisë dhe jetës publike.

Për sa i takon metrologjisë shkencore, Republika e Shqipërisë është anëtare e asociuar e Konferencës së Përgjithshme të Peshave dhe Masave (GCPM) që prej vitit 2007 dhe në nivel teknik përfaqësohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM), e cila ka nënshkruar Marrëveshjen për Njohjen e Ndërsjellë të etaloneve kombëtare të matjes dhe të certifikatave të kalibrimit dhe matjeve që lëshohen nga institutet kombëtare të metrologjisë” të Komitetit Ndërkombëtar të Peshave dhe Masave (CIPM MRA), po në vitin 2007. Në nivel evropian, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë është anëtare e Organizatës Rajonale të Instituteve të Metrologjisë në Evropë (EURAMET) që prej 26 majit 2010.


Plotësimi i kriterëve teknike përcaktuar nga këta dy organizma dhe marrëveshje ka mundësuar që disa prej shërbimeve meteorologjike që ofrohen, të njihen në nivel ndërkombëtar. Aktualisht, Shqipëria gëzon statusin anëtar i asociuar në Organizatën Evropiane të Metrologjisë Ligjore WELMEC, ku anëtarësimi i plotë kushtëzohet nga statusi politik i vendit kundrejt BE-së.

Laboratorët e etaloneve kombëtare të matjeve brenda institucionit funksionojnë sipas Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë, i cili është në përputhje me kërkesat e standardit ISO/IEC 17025: 2017 dhe të “Marrëveshjes së njohjes reciproke të standardeve kombëtare të matjeve dhe të certifikatave të kalibrimit, të lëshuara nga institutet kombëtare të metrologjisë”, lëshuar nga Komiteti Ndërkombëtar për Peshat dhe Masat (CIPM-MRA). Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ka regjistruar në vitin 2021 aftësitë matëse dhe kalibruese (CMC) në bazën e të dhënave të Byrosë Ndërkombëtare të Peshave dhe Masave (BIPM KCDB) në fushën e masës, vëllimit dhe presionit, sipas kërkesave të CIPM MRA.


Në nivel ndërkombëtar, Republika e Shqipërisë aderon në Konventën e Organizatës Botërore të Metrologjisë Ligjore (OIML) me të drejta të plota që prej vitit 2001, mbështetur në ligjin nr. 8818, datë 27.9.2001, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në ‘Konventën për krijimin e organizatës ndërkombëtare të metrologjisë ligjore’”, dhe në nivel teknik përfaqësohet nga DPM-ja.

Laboratorët e kalibrimit kanë realizuar shërbime kalibrimi të instrumenteve matëse të fushës së masës, volumeve, gjatësisë, temperaturës, lagështisë, elektrikut, forcës, presionit, kimisë ndërsa nëpërmjet sektorëve të shërbimit ka realizuar shërbime verifikimi të instrumenteve taksimetër, peshore automobilistike, peshore, gramarë, masa volumore etj.

Grafik nr. 5. Kalibrimet e realizuara gjatë periudhës 2017–2021



Grafik nr. 6. Instrumente matëse të verifikuara gjatë periudhës 2018–2021



Për të përmbushur të gjitha detyrimet, sfidat afatshkurtër në fushën e Metrologjisë, janë:

1. Ruajtja dhe zhvillimi i infrastrukturës bazë meteorologjike në zonat prioritare për ekonominë dhe inovacionin në industri për të ruajtur aftësinë për të siguruar gjurmueshmërinë meteorologjike të matjeve, i cili do të konsistojë në hartimin e një plani zhvillimi nga ministria përgjegjëse, ku do të përcaktohen fushat/nënfushat të cilave do t'u jepet prioritet zhvillimi, në përputhje me kërkesat e standardeve ndërkombëtare që aplikohen.

2. Harmonizimi i bazës ligjore me *acquis* e BE-së (përqasja e re dhe globale).

Në planin afatgjatë, sfida kryesore konsiston në:

Anëtarësimi me të drejta të plota i Republikës së Shqipërisë në Konventën e Metrit, si dhe plotësimi i kërkesave të Marrëveshjes së Njohjes Reciproke (CIPM MRA), për të garantuar gjurmueshmërinë dhe njohjen zyrtare të matjeve të proceseve të prodhimit në nivelin më të lartë të cilësisë, si mjet për të hequr barrierat teknike në tregti për prodhuesit dhe eksportuesit vendës.

1.4 Mbikëqyrja e tregut

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) është institucioni përgjegjës për kontrollin dhe zbatimin e kërkesave të legjislationit mbi sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorit në të gjitha fazat e zinxhirit ushqimor, prodhimit, importimit, trajtimit, përpunimit, magazinimit dhe tregtimit të produkteve ushqimore. AKU-ja përbëhet nga selia qendrore dhe 12 DRAKU. Pjesë administrative e DRAKU-së janë edhe 13 pikat e inspektimit kufitar, të cilat janë përgjegjëse për kontrollin e importit të produkteve me origjinë shtazore dhe joshtazore. AKU-ja menaxhon 7 laboratorë rajonalë, të cilët kryejnë aktivitetet gjithëvjeter në analizimin e produkteve ushqimore.

Për të garantuar mbrojtjen e shëndetit të konsumatorëve duhet siguruar funksionimi efektiv i çdo hallke të zinxhirit ushqimor. Ky princip është i vlefshëm, pavarësisht nga fakti nëse ushqimet prodhohen në Shqipëri apo importohen nga vende të tjera.

Një politikë efikase e sigurisë ushqimore duhet të njohë natyrën komplekse të prodhimit të këtyre ushqimeve, si dhe vlerësimin e monitorimit të rrisqeve mbi shëndetin e njerëzve. AKU-ja kryen gjenerimin e certifikatave të eksportit për produktet me origjinë shtazore (produktet e peshkut, produkteve të peshkimit, zorrët, këmbë bretkose, guaskë kërmilli dhe mish kërmilli, si dhe vezë të klasit "B"). Eksportet e kryera drejt vendeve të BE-së realizohen nëpërmjet sistemit TRACES, ku Shqipëria është pjesë e këtij sistemi dhe e përdor me sukses atë, në të gjitha hallkat e përfshira. Ky sistem jo vetëm lehtëson gjurmueshmërinë e produkteve të cilat shkojnë drejt BE-së, por në të njëjtën kohë ka rritur besueshmërinë e produkteve shqiptare dhe ka përmirësuar ndjeshëm funksionimin e zinxhirit të kontrollit. Këtë e tregon edhe rritja e eksporteve shqiptare me rreth 19% gjatë vitit 2021 krahasuar me vitin paraardhës dhe konkretisht: 2549 eksporte në vitin 2021 kundrejt 2066 eksporte në vitin 2020. AKU-ja ka ndërmarrë nisma e plane konkrete veprimi të miratuara e monitoruara nga MBZHR-ja, të cilat çuan në konsolidimin e AKU-së dhe forcimin e pozitës së saj si aktor kyç në luftën për garantimin e sigurisë ushqimore.

Për garantimin e sigurisë ushqimore në vend dhe mbrojtjen e konsumatorit, AKU-ja ka detyrime specifike për kontrole/inspektime ndaj subjekteve që operojnë në fushën e ushqimit, ushqimit për kafshe, inputeve bujqësore, dhe veprimtarisë prodhuese të duhan - cigareve, kryerjen e vlerësimit të riskut, menaxhimit dhe komunikimit të tij.

Në përmbushje të misionit të saj dhe bazuar në planin me bazë risku të kontroleve zyrtare dhe marrjes së mostrave të miratuar nga MBZHR-ja, AKU-ja kryen veprimtarinë e saj inspektuese në rang kombëtar nëpërmjet DRAKU-ve. Kontrollat zyrtare të AKU-së kryen nëpërmjet portalit *online* “e-Inspektim” të Inspektoratit Qendror. Gjatë kontroleve zyrtare, në rastet kur gjatë kontroleve konstatohen shkelje të kërkesave të legjislacionit në fuqi, AKU-ja merr masat administrative përkatëse sipas ligjit.

Në kuadër të digjitalizimit të sistemeve ndërqeveritare, rivitalizimi i sistemit AKU.net do të mundësojë krijimin e një sistemi të brendshëm me të dhëna statistikore të plota të kategorive të inspektimeve, rezultateve të inspektimeve, përgjigjeve të analizave laboratorike, etiketimit të produkteve ushqimore etj., që do të shërbejnë për një analizë dhe vlerësim të mirëfilltë të riskut, transparencë të aktiviteteve nga ana e AKU-së, si edhe do të mundësojë kryerjen e inspektimeve *online* në pikat e inspektimit kufitar. Të dhëna të detajuara mbi numrin e inspektimeve dhe masat administrative jepen në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 1. Numri i inspektimeve dhe masat administrative 2018–2022 (AKU)

Viti	Inspektime total	Masa administrative					
		Paralaj-mërimet	Gjopa		Bllokim produkti	Asgjësimit produkti	Ndërprerje aktiviteti
			Nr.	Vlerë ('000 lekë)			
2018	79,295	4,540	610	127,555	3 884 tonë, 92 376 litra	2 926 tonë, 6 926 litra	145
2019	75,099	1,394	321	143,580	47 tonë, 39,167 litra, 73 pako	73 tonë	40
2020	93,691	5,200	309	37,360	524 tonë, 1534 litra, 855 vezë, 1196 copë	3 767 tonë, 7 076 litra	23
2021	103,065	6,368	246	35,770	370 tonë, 41 582 litra, 824 kokrra vezë	6 399 tonë, 11 558 litra, 570 kokrra vezë	29
2022	101,535	4,959	471	76,170	412 tonë, 961 730 litra, 2 644 152 kokrra vezë, 133 copë	2 456 tonë, 2 671 236 litra, 569 843 kokrra vezë, 231 750 paketa	67

Pjesë shumë e rëndësishme e procesit të kontrollit Operatorëve të Biznesit Ushqimor (OBU) është edhe procesi i analizimit të produkteve ushqimore, i cili realizohet në zbatim të planit vjetor të marrjes së mostrave apo në rastet e një alerti nga një institucion tjetër, denoncime të ndryshme nga konsumatorët, apo një dyshimi të arsyeshëm në lidhje me sigurinë e produktit. Një nga shqetësimet kryesore që kanë paraqitur drejtoritë rajonale të AKU-së (DRAKU), për realizimin konform kërkesave ligjore të këtij procesi, ka qenë edhe mungesa e mjeteve për marrjen e mostrës, si dhe pajisjeve për dërgimin e tyre në laborator, kryesisht për mostra që kërkojnë të transportohen nën një regjim termik të caktuar. Për këtë arsye është domosdoshmëri përmirësimi i infrastrukturës për marrjen e mostrës, garantimin dhe dërgimin e tyre në laboratorët respektivë.

Trajnimi i inspektorëve është një element shumë i rëndësishëm për rritjen e kapaciteteve tekniko-profesionale, gjë që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e performancës së punës së tyre gjatë kontroleve zyrtare dhe cilësinë e inspektimeve. Në këtë kuadër, AKU-ja, përveç trajnimeve të organizuara nga organizma ndërkombëtarë, si: BTSF, EFSA, TAIEX etj. ka organizuar trajnime dhe nga sektorët përkatës në DP janë organizuar disa module trajnimi në kuadër të rritjes së cilësisë së inspektimeve. Sfidë mbetet identifikimi i nevojave për trajnimin e inspektorëve duke pasur parasysh çdo fazë të kontroleve zyrtare, duke përfshirë: dokumentacionin e procedurave të kontrollit zyrtar, kontrollin e dokumenteve që disponon çdo OBU për garantimin

e sigurisë ushqimore (regjistrin e gjurmueshmërisë, dokumentacionin e planit HACCP), marrjen e mostrave, mënyrën e raportimit, si dhe hedhjen e të dhënave në portalin e-inspektimi.

Aktiviteti laboratorik është pjesë e kontrollit zyrtar dhe si rrjedhojë veprimtaria e tyre kryhet bazuar në planin vjetor të kontrolleve me bazë risku. Gjatë vitit 2021, nga laboratorët e AKU-së janë realizuar gjithsej 13.465 analiza, si dhe për vitin 2022 në total për efekt kontrolli zyrtar janë analizuar 8 672 mostra. Nga këto, në laboratorët e AKU-së se janë analizuar 5 909 mostra. Për vitin 2022 në total për efekt kontrolli zyrtar janë analizuar 8 672 mostra. Nga këto, në laboratorët e AKU-së janë analizuar 5 909 mostra. Përmirësimi i infrastrukturës për marrjen e mostrës, garantimin dhe dërgimin e tyre në laboratorë, mbetet një nga sfidat e këtij institucioni. Në analizën vjetore të AKU-së, prej vitit 2021 një nga shqetësimet kryesore që kanë paraqitur DRAKU-të, ka qenë edhe mungesa e mjeteve për marrjen e mostrës, si dhe pajisjeve për dërgimin e tyre në laborator, kryesisht për mostra që kërkojnë të transportohen nën një regjim termik të caktuar. Sfidë mbetet pajisja e inspektorëve me mjete për marrjen e mostrave.

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor mbulon fushën e shëndetësisë dhe është struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe kontrollin e zbatueshmërisë së ligjit nr. 26/2017, “Për produktet kozmetike” dhe akteve nënligjore për produktet kozmetike që importohen, prodhohen apo tregtohen në vendin tonë. ISHSH-ja kërkon nga subjektet përgjegjëse marrjen e masave, përfshirë veprimet korrigjuese për ta sjellë produktin kozmetik në përputhje me kërkesat ligjore, për ta tërhequr atë nga tregu e kthyer mbrapsht, brenda periudhave kohore të përcaktuara në përputhje me natyrën e riskut, në rastet e mospërputhshmërisë. Nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 26/2017 “Për produktet kozmetike”, ISHSH-ja ka kryer një numër të madh inspektimesh dhe monitorimesh në terren me qëllim njohjen e subjekteve me kërkesat e ligjit dhe detyrimet që rëndojnë mbi to. Gjatë inspektimeve u konstatua një mungesë totale informimi nga ana e subjekteve për ekzistencën e një ligji për kozmetikën. Inspektimet në terren nga ana e ISHSH-së, u paraprinë nga trajnime të personelit inspektues në të gjithë vendin. Gjatë periudhës 2019–2021, megjithëse inspektimet ishin të përqendruara kryesisht mbi zbatimin e masave parandaluese ndaj infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, është arritur që pjesa më e madhe e subjekteve që operojnë në fushën e kozmetikës të njihen me ligjin nr. 26/2017 dhe të fillojnë të zbatojnë kërkesat ligjore që rrjedhin nga ky ligj. Nga muaji qershor 2018 deri në muajin maj 2019 ishin të njoftuara pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (sipas nenit 12) rreth 1500 kode produktesh. Rezultatet e inspektimeve të ISHSH-së kanë sjellë rritjen e numrit të njoftimeve pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Deri në dhjetor 2021 janë njoftuar (sipas nenit 12) të ligjit nr. 26/2017 rreth 42 500 kode produktesh kozmetike.

Tabela nr. 2. Numri i inspektimeve dhe masat administrative 2019–2022 (ISHSH)

Viti	Inspektime	Riinspektime	Total	Gjaba	Vendime	Paralajmërime
2019	59	12	71	1	0	13
2020	9	0	9	1	0	5
2021	913	97	1010	0	0	102
2022	301	2	303	8	1	1
Totali	1282	111	1393	10	1	121
	Inspektime 1.393			Masa Adm 132		

Sfidë në punën e ISHSH-së është:

- rritja e sigurisë së produkteve që ofrohen në fushën e kozmetikës;
- ofrimi i transparencës dhe përdorimi i metodave sa më bashkëkohore për kryerjen e inspektimeve nëpërmjet mbështetjes së ofruar nga një staf i përgatitur inspektorësh;
- krijimi i një sistem të brendshëm alarmi të shpejtë për të arritur në një gjurmueshmëri të plotë të të gjitha produkteve dhe mallrave brenda fushës që ai mbulon;
- ndërgjegjësimi i subjekteve për masat që duhen marrë për përmirësimin e aktivitetit të tyre në kuadër të legjislacionit në fuqi në lidhje me sigurinë e produkteve kozmetike, duke synuar plotësimin e kushteve që kërkojnë të arrihen për integrimin evropian;

- të mbrojtje konsumatorët shqiptarë në mënyrë efektive nga risqet dhe kërcënimet në fushën e kozmetikës.

Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut

Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut është institucioni përgjegjës për kontrollin dhe garantimin e sigurisë së produkteve të vendosura në treg dhe të destinuara për konsumatorët në përputhje me legjislacionin për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore, legjislacionin për tregtimin e mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

Prej krijimit të kësaj strukture në vitin 2016 e në vijim, është punuar për fuqizimin e saj në drejtim të ngritjes së kapaciteteve njerëzore, rritjes së aftësive tekniko-profesionale të stafit, përmirësimin e logjistikës, kuadrit ligjor, si dhe ofrimit të përvojave më të mira të vendeve të rajonit dhe vendeve të BE-së.

Kjo strukturë ka një fushë të gjerë veprimtarie dhe nga viti në vit është synuar shtrirja e kontroleve për të gjitha kategoritë e produkteve/instalimeve me qëllim garantimin e konformitetit të tyre në përputhje me kriteret ligjore, duke synuar rritjen e sigurisë dhe mbrojtjen e konsumatorit.

Fushat e inspektimit sipas kompetencës aktuale institucionale përfshijnë: inspektimet për produktet mekanike, produktet elektrike, inspektimin meteorologjik, inspektimet për sigurinë e përgjithshme (artikuj të kujdesit për fëmijë, lodrat në parqe etj.), inspektimet për produktet e disponueshme për konsumatorin fundor për përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi “Për menaxhimin e kimikateve” etj.). Në fokus ka qenë kontrolli për sigurinë e atyre produkteve që kanë më shumë impakt te konsumatori apo të cilat mbartin më tepër risk, si: ashensorë, lodra, instrumentet matëse ligjërish të kontrolluara, parapaketime etj. Gama e produkteve që kanë qenë në fokusin e punës së strukturës së mbikëqyrjes është zgjeruar nga viti në vit. Në vitin 2017 kemi inspektime vetëm për parapaketimet dhe lodrat dhe në vitet më pas është rritur numri i grup produkteve të inspektuara nga ky institucion (tabela nr. 3), që lidhet me funksionimin e të gjithë sektorëve të ISHMT-së, rekrutimin e stafit, trajnimin e tij, si dhe miratimi i rregulloreve të reja në kuadrin e transpozimit të direktivave të BE-së në legjislacionin shqiptar.

Tabela nr. 3. Inspektimet sipas sektorëve/grup-produkteve 2017–2021 (ISHMT)

	Fushë veprimtaria	2017	2018	2019	2020	2021
1	Inspektimi meteorologjik	80	663	533	542	515
1.1	Parapaketim	80	663	282	360	310
1.2	Inspektime për instrumentet matëse ligjërish të kontrolluara që vendosen në treg	/	/	50	175	205
1.3	Inspektime për instrumentet matëse ligjërish të kontrolluara, në përdorim	/	/	201	7	/
2	Inspektimi i produkteve elektrike	0	123	160	78	172
2.1	Inspektime për efikasitetin e energjisë	/	/	/	/	/
3	Inspektimi i produkteve/pajisjeve mekanike (ashensorë, PMP, makineri)	0	0	225	463	366
3.1	Ashensorë	/	/	209	425	336
3.2	Makineri	/	/	5	38	2
3.3	PMP	/	/	11		28
3.4	Artikuj piroteknikë	/	/	/	/	/
3.5	Avionët pa pilot	/	/	/	/	/
4	Inspektimi i produkteve qelq/këpucë/sig. e produkteve (lodra, tekstil, veshje këmbë)	13	233	115	144	196
4.1	Lodra	13	44	79	48	82
4.2	Detergjente	/	87	3	36	/
4.3	Veshje këmbë	/	37		33	/
4.4	Produkte tekstil	/	65	18	/	/
4.5	Siguria e përgjithshme			15	27	14
5	Mbrojtja e konsumatorit	0	0	98	26	72
	TOTALI	93	1019	1131	1253	1221

Kontrollet kanë qenë kryesisht kontrolle dokumentare e fizike treguese. Kontrollet laboratorike kanë qenë të pakta në raport me inspektimet e kryera, të cilat kanë qenë kryesisht për lodrat. Në vitin 2019, në 20 operatorë ekonomikë (importues në nivelin e zinxhirit të furnizimit), u morën 42 mostra lodra ku rezultoi se 80% e tyre ishin të rrezikshme.

Tabela nr. 4. Përmbledhje e rezultateve të analizimeve sipas standardit (ISHMT)

Numri i produkteve	Testim sipas standardit të harmonizuar	Risku i shfaqur
12 lodra	EN 71-1:2011	Risk të mbytjes/gëlltitjes/prerjeve etj.
16 lodra	ISO 8124-6:2018	Risk kimik kategorisë IB me toksik për riprodhimin (DEHP, DBP, BBP, DINP, DIDP, DNOP) mbi nivelin e lejuar <0,1 %
5 lodra	EN 71-3:2013	Risk kimik sistemit të riprodhimit

ISHMT-ja ka kryer jo vetëm ndalimin e tregimit të produkteve të pasigurta dhe të rrezikshme, por edhe shkatërrimin e tyre. Në vitin 2019 u realizua për herë të parë procedura e shkatërrimit të produkteve joushqimore, të cilat kanë rezultuar në jokonformitet me kërkesat minimale të sigurisë, sipas legjislacionit në fuqi “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore” dhe VKM nr. 262/2013, “Për sigurinë e lodrave”. Në shkurt 2022 u realizuar procedura e dytë. Në total janë shkatërruar 116 artikuj lodra (me një sasi totale 22.000 copë), të cilat rezultuan nga analizat laboratorike me risk kimik, fizik, të identifikuar në RAPEX apo pa markimin CE.

Mbështetur në pikën 1/d të nenit 30 të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011, i ndryshuar, ISHMT-ja ka të drejtën e bllokimit të produkteve nëse autoritetet e mbikëqyrjes së tregut në vende të tjera të BE-së kanë njoftuar se produkti është i rrezikshëm. Në këtë kuadër, janë bllokuar produkte lodra apo artikuj në kontakt me ushqimin për të cilët është publikuar njoftimi nga vendet e BE-së në Safety Gate Alert apo RASFF (AKU).

Në vitin 2020 janë ndjekur 5 ALERT-e ndërkombëtare të njoftuara nga RASFF-ja të kategorizuara me risk serioz me ndikimin në shëndetin e njeriut, prej produkteve joushqimore të kategorisë “material në kontakt me ushqimin”. Në vitin 2022 janë trajtuar 3 ALERT-e ndërkombëtare nga RASFF-i, ku janë bllokuar 280 produkte të kësaj kategorie. Inspektimet e realizuara nga ISHMT-ja prej funksionimit e deri më tani kanë qenë kryesisht të planifikuara, (proaktive), por numri i inspektimeve mbi bazën e informacionit të përcjellë nga institucionet publike/organizata/zyrtar/konsumator pranë ISHMT-së nëpërmjet adresës fizike të institucionit (administruar në protokoll), email-et zyrtare (info@ishmt.gov.al), plotësimit të formularit të ankesës që disponohet në *webiste*-n zyrtar, si dhe ato të paraqitura nga Platforma e Bashkëqeverisjes, janë ndjekur me prioritet dhe kanë qenë në rritje vit pas vit. Me gjithë punën e madhe të bërë për fuqizimin e strukturës së mbikëqyrjes së tregut për produktet joushqimore mbeten ende sfida:

- Kontrolli në vazhdimësi i konformitetit të produkteve joushqimore, pajisjeve/instalimeve, si dhe shtrirja e kontrolleve për sigurinë e grup produkteve që nuk kanë qenë objekt i kontrolleve të mëparshme, si dhe përfshirja në një shkallë më të gjerë e instrumenteve dhe pajisjeve ndihmëse në kontrollet mbikëqyrëse e cila kërkon më shumë impenjim edhe në trajnim të stafit për vënien e tyre në përdorim, si dhe kryerja e analizave laboratorike;

- Fuqizimi i mëtejshëm i ISHMT-së si një institucion i rëndësishëm në fushën e mbikëqyrjes së tregut;

- Rritja e aksesit të operatorëve ekonomikë dhe konsumatorëve ndaj informacionit të përditësuar mbi sigurinë e produkteve joushqimore.

Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial

ISHTI-ja është struktura përgjegjëse për inspektimin për zbatimin dhe përmbushjen e kërkesave ligjore dhe nënligjore në fushat më poshtë:

- a) përpunimit, transportimit dhe tregimit të naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre, sipas legjislacionit përkatës;

- b) sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve elektrike, sipas legjislacionit përkatës;

c) sigurisë së punës së instalimeve nën presion, si një linjë teknologjike e përbërë nga enë, tubacione dhe aksesore sigurie dhe që shërbejnë për mbajtjen, trajtimin dhe shpërndarjen e fluideve, sipas legjislacionit për sigurinë e enëve në presion;

ç) sigurisë së punës në veprimtarinë e sektorit të gazit natyror, përfshirë transmetimin, shpërndarjen, depozitimin, si dhe ndërtimin e operimin e infrastrukturës së gazit natyror, sipas legjislacionit të sektorit të gazit natyror;

d) sigurisë teknike të linjave teknologjike industriale të industrisë joushqimore, brenda fushës së përgjegjësisë së ministrisë përgjegjëse për industrinë, sipas legjislacionit përkatës;

dh) çdo përgjegjësi tjetër të përcaktuar me ligj apo akt nënligjor.

ISHTI-ja është organ qendror dhe ushtron juridiksionin e vet në të gjithë territorin e vendit, bazuar në ligjin nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 410, datë 13.5.2015, “Për krijimin, organizimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”.

Struktura e ISHTI-së përbëhet nga 10 drejtori, 200 punonjës dhe drejtohet nga kryeinspektori. Këto drejtori në bashkëpunim me njëra tjetrën, planifikojnë, bashkërendojnë dhe realizojnë veprimtarinë e inspektimit, sigurojnë unifikimin e praktikave të inspektimit, brenda fushës së përgjegjësisë, në shkallë vendi.

Arritjet kryesore për periudhën 2017–2021 përfshijnë:

- Rritja e kapaciteteve administrative të strukturës nga 100 punonjës në vitin 2020 në 200 punonjës, si dhe shtimi i logjistikës me 11 mjete të reja transporti në funksion të grupeve të inspektimit të cilët ka pasur një impakt të drejtpërdrejtë në zbatimin e masave ligjore në treg;

- Miratimi i rregullores së re të brendshme të ISHTI-së ka përcaktuar qartë procedurat administrative, proceset e brendshme organizative dhe përgjegjësitë përkatëse sipas strukturës së miratuar;

- Rritja e numrit të inspektimeve me 50% në nivel kombëtar dhe si pasojë e formalizimit dhe regjistrimit të shumë subjekteve;

- Bashkëpunimi me ISHMT-në, doganat, DPSHTRR-në, QKR-në, MIE-n, bashkitë, inspektoratet vendore, AKMC-ja, AKU-ja, MAS-i etj., duke përmirësuar format dhe mënyrat e komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit të ndërsjellë në formë periodike, për të identifikuar subjekte dhe aktivitete në fushën e mbulimit të ISHTI-së;

- Laboratori Qendror: Riakreditimi i Laboratorit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve sipas standardit ISO 17025, pajisja me aparatura të reja të teknologjisë së fundit sipas standardeve evropiane në fuqi, shtim i numrit të treguesve analizues të nafta bruto dhe nënproduktet e saj, dhe trajnim i personelit për standardin ISO 17025, që ka rezultuar në rritjen e kontrollit cilësor dhe përmirësimin e cilësisë dhe shërbimit për produkteve të përdorimit nga konsumatori fundor.

Tabela nr. 5. Të dhëna mbi inspektimet – periudha 2017–2022 (ISHTI)

	#	KPI (Indiktori)	2017	2018	2019	2020	2021	2022
DIGNG	1	Numri i inspektimeve të kryera në sistemin e inspektimve online, E-Inspektimi	165	805	847	860	1006	618
	2	Numri dhe evidetimi i shkeljeve ligjore dhe konstatimeve të tjera me natyrë keshilluese	384	278	248	230	214	165
	3	Niveli i masave administrative shtese pervec atyre me natyrë keshilluese	76	49	39	26	15	9
	4	Numri i incidenteve të regjistruara të lidhura me sigurinë e produkteve dhe pasisjeve.	5	4	4	4	3	3
	5	Niveli i rritjes të inpektimeve online sipas raportimeve pergjate kater mujoreve te vitit kalendatrik	3%	2%	2%	1,5 %	1,5 %	0,5 %
DIPMN	1	Numri i inspektimeve të kryera në sistemin e inspektimve online, E-Inspektimi	897	1172	1171	1083	1787	1228
	2	Numri dhe evidetimi i shkeljeve ligjore dhe konstatimeve të tjera me natyrë keshilluese	780	1060	1065	980	1610	1080
	3	Niveli i masave administrative shtese pervec atyre me natyrë keshilluese	32	24	46	42	46	17
	4	Numri i incidenteve të regjistruara të lidhura me sigurinë e produkteve dhe pasisjeve.	16	36	27	10	26	15
	5	Niveli i rritjes të inpektimeve online sipas raportimeve pergjate kater mujoreve te vitit kalendatrik	3%	16%	2%	0%	50%	0%
DIPNP	1	Numri i inspektimeve të kryera në sistemin e inspektimve online, E-Inspektimi					3075	2660
	2	Numri dhe evidetimi i shkeljeve ligjore dhe konstatimeve të tjera me natyrë keshilluese					157	190
	3	Niveli i masave administrative shtese pervec atyre me natyrë keshilluese					17	14
	4	Numri i incidenteve të regjistruara të lidhura me sigurinë e produkteve dhe pasisjeve.					23	7
	5	Niveli i rritjes të inpektimeve online sipas raportimeve pergjate kater mujoreve te vitit kalendatrik					30%	10%

Shenime: Në realizimin e viti 2022 mungojnë Tetori, Nentori, Dhjetori
Per DIPNP nuk disponohen te dhena te sakt para 2022

Mbetet sfidë:

- Ngritja e infrastrukturës IT (arkivi digjital, platformë për ruajtjen e të dhënave, EMS, CRM, rrjet i brendshëm kompjuterik, platforma për regjistrimin e pajisjeve, vetëdeklarimin e subjekteve dhe monitorimin e aktivitetit të OMVK-së etj. Mementalisht, infrastruktura dhe sistemet e IT nuk ekzistojnë.

- Rritja e kontrollit ndaj procedurave të ndjekura OMVK në proceset e vlerësimit të konformitetit dhe miratimit të këtyre subjekteve.

- Përmirësimi i logistikës së institucionit duke shtuar mjete të reja të transportit rrugor për grupet inspektuese, pasi ISHTI-ja ushtron veprimtari inspektuese në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe ka vetëm një seli qendrore në Tiranë, me qëllim përmirësimin e mbulimit territorial të tregut në RSH.

- Përmirësimi i kuadrit ligjor për të gjitha fushat e veprimtarisë inspektuese sipas fushave përkatëse të mbulimit.

- Digjitalizimin e arkiv-protokollit në të gjithë strukturën e institucionit, duke përdorur mënyrën elektronike të qarkullimit të dokumenteve, në përputhje me rregullat e përcaktuara në dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi.

- Sigurimi i ambienteve të reja për laboratorin qendror, nisur nga nevoja që ka për shkak të rrezikshmërisë së lartë, pasi laboratorit aktual ndodhet në një zonë shumë të populluar rrethuar nga institucione të arsimit parashkollor dhe 9-vjeçar, si dhe nga ndërtesa banimi me dendësi të madhe popullore. Mungesë e trajnimeve brenda dhe jashtë vendit të personelit të laboratorit.

- Analiza mjekësore të personelit të laboratorit.

- Mirëmbajtje dhe kalibrim të jashtëm të aparaturave të laboratorit për vitin 2020 dhe 2021.

1.5 Kuadri ligjor i produkteve ushqimore dhe joushqimore

Kuadri ligjor i produkteve ushqimore

Kuadri ligjor në fushën e produkteve ushqimore përbëhet nga:

Ligji nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, i ndryshuar me ligjin nr. 74/2013, ligjin nr. 16/2020 dhe ligjin 10/2022, është i harmonizuar me rregulloren 178/2002/EU. Me anë të këtij ligji u ngrit Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, si struktura përgjegjëse për kontrollet zyrtare dhe garantimin e sigurisë ushqimore për një produkt të sigurt në mbrojtje të shëndetit të konsumatorit, përmes analizës së tre komponentëve themelorë: vlerësimit të riskut, menaxhimit të riskut dhe komunikimit të riskut në fushën e ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë, mbrojtjes së bimëve. Ky ligj ka për qëllim të vendosë bazat për sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve dhe interesat e konsumatorit, duke përcaktuar: kërkesat dhe parimet e përgjithshme për higjienën dhe sigurinë e ushqimeve dhe të ushqimeve për kafshë, detyrimet e operatorëve të biznesit të ushqimeve dhe të ushqimeve për kafshë, për higjienën dhe sigurinë e këtyre ushqimeve, kërkesat e përgjithshme për cilësinë e ushqimeve, kërkesat e përgjithshme për regjistrimin e treguesve gjeografikë dhe emërtimin e origjinës së kontrolluar, kërkesat e përgjithshme për mënyrën e etiketimit të ushqimeve dhe të ushqimeve për kafshë, kërkesat e përgjithshme të nxjerrjes në treg të ushqimeve dhe të ushqimeve për kafshë, sistemin e kontrollit zyrtar të ushqimeve dhe të ushqimeve për kafshë; sistemin e laboratorëve të autorizuar për analiza dhe të laboratorëve të referencës. Gjithashtu vendosja e standardeve garanton një konkurrencë të ndershme në treg midis operatorëve të biznesit ushqimor.

Ligji nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në kuadër të reformës veterinare, ngriti Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, si struktura përgjegjëse për kontrollet zyrtare për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve, duke përcaktuar se strukturat shtetërore të shërbimit veterinar do të kryejnë profilaksinë veterinare për të mbuluar çdo njësi administrative me shërbim veterinar. Garantimi i shëndetit të kafshëve është një hallkë e rëndësishme e zinxhirit ushqimor, sepse nga kafshë me status shëndetësor të sigurt rrjedhin ushqime të sigurta, si dhe minimizohen zoonozat (sëmundje të trasmetueshme nga kafsha tek njeriu).

Ky ligj ka për qëllim: të mbrojë dhe të përmirësojë shëndetin e kafshëve, të tokës dhe të ujit; të përcaktojë procedurat për parandalimin, monitorimin, diagnostikimin, trajtimin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve të kafshëve; të mbrojë shëndetin publik nga sëmundjet zoonotike të trasmetueshme nga kafshët, si dhe nga lëndët mbetëse të dëmshme, të cilat gjenden në produktet për konsum human; të sigurojë zbatimin e masave shëndetësore veterinare për produktet me origjinë shtazore, të prodhuara në fermë, lëndët e papërpunuara, kullotat, ujin dhe vendet e pirjes së ujit për kafshët; të mbrojë shëndetin riprodhues të kafshëve, të sigurojë rritjen e prodhimtarisë dhe përmirësimin racor; të mbrojë mjedisin nga infeksionet, helmet, mbeturinat e kafshëve dhe ndotjet (biologjike, fizike, kimike, radiobiologjike), me pasoja dëmtuese për shëndetin e kafshëve dhe njerëzit; të mbrojë kafshët nga tortura dhe të sigurojë mirëqenien e tyre; të përcaktojë detyrimet e fermerëve, të personave fizikë dhe juridikë, në zbatimin e këtij ligji.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 434, datë 11.7.2018, “Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit”. Ky vendim ka për qëllim të vendosë bazën për sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së konsumatorit nëpërmjet informacionit për ushqimin, duke marrë parasysh dallimet në perceptimin e konsumatorëve dhe nevojat e tyre për informacion, si dhe duke siguruar funksionimin normal të tregut. Ky vendim përcakton parimet e përgjithshme, kërkesat dhe përgjegjësitë kryesore që rregullojnë informacionin për ushqimin dhe në veçanti, etiketimin e produkteve ushqimore. Ai përcakton mjetet për të garantuar të drejtën për informim të konsumatorëve dhe procedurat për sigurimin e informacionit për ushqimin, duke marrë parasysh nevojën për të siguruar fleksibilitet të mjaftueshëm për t’iu përgjigjur zhvillimeve të ardhshme dhe kërkesave të reja të informimit.

Ky vendim zbatohet për:

Operatorët e biznesit ushqimor, në të gjitha fazat e zinxhirit ushqimor ku aktiviteti i tyre ka të bëjë me dhënien e informacionit për ushqimin për konsumatorët;

Të gjitha ushqimet e destinuara për konsumatorin e fundit, duke përfshirë edhe ushqimet e ofruara nga furnizues masivë ushqimesh dhe ushqime të destinuara për furnizim për shërbimin *catering*;

Shërbimet e *catering*-ut të ofruara nga ndërmarrjet e transportit.

Aktet e tjera nënligjore që lidhen me kriteret mikrobiologjike, paketën higjienike për kontrollin e mishit në thertore dhe parametra të tjerë në fushën e sigurisë ushqimore, plotësojnë kuadrin ligjor në fushën e sigurisë ushqimore në rritjen e standardeve dhe sigurinë e produkteve të vendosura në treg për konsumatorin shqiptar. I gjithë legjislacioni i përgatitur është në përshtatje me legjislacionin e BE-së. Legjislacioni për Sigurinë Ushqimore gjendet në faqen zyrtare të Ministrisë të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe në faqen e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit¹.

Kuadri ligjor i produkteve joushqimore

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit

Parimet e tregtimit, sigurisë së produkteve dhe mbikëqyrjes së tregut në Shqipëri rregullohen nga:

- ligji nr. 10489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, i ndryshuar²;

- ligji nr. 10480, datë 17.11. 2011 “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore”;

- legjislacioni specifik që rregullon veprimtarinë e institucioneve të infrastrukturës së cilësisë (standardizimi, akreditimi, metrologjia dhe mbikëqyrja e tregut).

Ligji horizontal për tregtimin e produkteve dhe mbikëqyrjen e tregut përcakton detyrimet e operatorëve ekonomikë për të vendosur në treg produkte që janë në përputhje me kërkesat ligjore në lidhje me to. Gjithashtu, në këtë ligj parashikohet kontrolli i produkteve që hyjnë në territorin shqiptar nga autoritetet doganore, të cilat mund të pezullojnë zhdoganimin e produkteve që paraqesin risk serioz për shëndetin, sigurinë apo interesat të tjera publike, si dhe detyrimi i personave përgjegjës për garantimin e sigurisë së produkteve dhe instalimeve që janë në përdorim.

Ligji për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore përcakton të drejtat dhe detyrimet e prodhuesve e të shpërndarësve, me qëllim që produktet për konsumatorin të vendosura në treg të jenë të sigurta, si dhe kompetencat e strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut.

Krahas legjislacionit horizontal, në zbatim të tij janë miratuar edhe aktet nënligjore/rregullat teknike, sipas fushave të produkteve që bien nën përgjegjësinë e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (pajisjet elektrike brenda kufijve të tensionit (LVD), përputhshmëria elektromagnetike, lodrat, ashensorët për përdorim civil, makineritë, pajisjet mbrojtëse personale, pajisjet e gazit, enët e thjeshta nën presion, instrumentet matës, emetimi i zhurmave nga pajisjet, pajisjet e aerosolit, veshjet e këmbës etj.). Qëllimi i miratimit të këtyre rregullave teknike është përcaktimi i kërkesave themelore të sigurisë së produkteve për të garantuar një nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së jetës, shëndetit të njerëzve, sigurisë së përdoruesve, si dhe lëvizjen e lirë në treg, në përputhje me kërkesat evropiane. Gjithashtu, rregullat teknike përcaktojnë edhe aspekte të tjera që lidhen me: detyrimet e operatorëve, veprimtarinë e strukturave të mbikëqyrjes së tregut, procedurat e vlerësimit të konformitetit me kërkesat e përcaktuara, prezumimi i konformitetit, trajtimi i produkteve të cilat paraqesin rrezik, duke garantuar kështu produkte të sigurta dhe konsumatorë të mbrojtur në treg etj.

Në përputhje me zhvillimet e legjislacionit të BE-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave dhe hyrjes në fuqi të rregullores (BE) 2019/1020 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 20 qershorit 2019 “Mbi mbikëqyrjen e tregut dhe përputhshmërinë e produkteve”, Shqipëria, siç është parashikuar në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian, do të marrë angazhimin për përafrimin/harmonizimin e kësaj rregulloreje, përmes iniciativës për kryerjen e ndryshimeve ligjore përkatëse të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”. Kjo do të sigurojë koherencën me zhvillimet legjislative evropiane dhe forcimin e kuadrit ligjor horizontal në vend, me qëllim garantimin e mbulimit sa më të plotë dhe vënien në

¹ www.aku.gov.al, www.bujqesia.gov.al

² Ndryshuar me ligjin nr. 17/2013.

zbatim të mekanizmave për lëvizjen e lirë të mallrave, sigurinë e produkteve joushqimore dhe mbikëqyrjen sa më efektive të tregut.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Kuadri ligjor në fushën e kimikateve përbëhet nga:

- ligji nr. 27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”³;
- ligji nr. 7/2020, datë 3.2.2020, “Për ratifikimin e Konventës së Minamatës ‘Për merkurin’”.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

- Pajisjet mjekësore rregullohen me ligjin nr. 89/2014, “Për pajisjet mjekësore”, i amenduar me ligjin nr. 21/2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 89/2014, “Për pajisjet mjekësore”, i cili përaftron legjislacionin evropian për pajisjet mjekësore. Referuar kuadrit rregullator të përbërë nga akte nënligjore dhe urdhra të ministrit, rregullohet tregtimi dhe vendosja në treg e pajisjeve mjekësore të certifikuara dhe të sigurta, përcaktohen procedurat e kryerjes së hetimeve klinike, procedurat e vlerësimit të konformitetit, regjistrimi me qëllim gjurmimin në rast nevojë, inspektimi, shitja nëpërmjet internetit, publiciteti etj.⁴

- Ligj nr. 26/2017, “Për produktet kozmetike” ka si qëllim mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe garantimin e cilësisë së produkteve kozmetike të bëra të disponueshme në treg, duke përcaktuar kërkesat që duhet të përmbushë çdo produkt kozmetik⁵.

Kuadri Ligjor mbi Infrastrukturën e Cilësisë

Standardizimi

Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS) organizohet dhe ushtron veprimtarinë e saj bazuar në ligjin nr. 9870/2008, “Për standardizimin”, të ndryshuar, aktet e tjera në zbatim të tij, si dhe bazuar në rregulloret e brendshme e procedurat e punës.

Vendimi nr. 382/2018 i Këshillit të Ministrave, “Për veprimtarinë e Standardizimit”, i ndryshuar, ka transpozuar plotësisht rregulloren evropiane 1025/2012, “Për standardizimin evropian”.

Të gjitha aktet ligjore e nënligjore të DPS-së gjenden të publikuara në faqen e saj të internetit⁶.

Akreditimi

Organizmi kombëtar i akreditimit është në varësi të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë dhe funksionon në bazë të ligjit nr. 116/2014, datë 11.9.2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”⁷.

VKM nr. 667, datë 29.7.2015, “Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të DPA-së”⁸ dhe me kërkesat e standardit ISO/IEC 17011:2017 “Kërkesat për organizmat akreditues që akreditojnë organet e vlerësimit të konformitetit”.

Metrologjia

Institucioni përgjegjës për zhvillimin e metrologjisë në vend është nën varësinë e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe funksionon në bazë të ligjit nr. 126, datë 15.10.2020, “Për metrologjinë”, dhe akteve nënligjore, një pjesë e të cilave janë të listuara më poshtë:

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 18.5.2022, “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë të Përgjithshme të Metrologjisë”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 324, datë 18.5.2022, “Për përcaktimin e kërkesave kushteve që duhet të plotësojë një standard matjeje për t’u deklaruar etalon kombëtar matjeje”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 29.4.2022, “Për njësitë bazë të Sistemit Ndërkombëtar të Njësive, që do të përdoren në Shqipëri, njësitë që rrjedhin prej tyre”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 217, datë 13.4.2022, “Për krijimin, administrimin dhe përdorimin e bazës së të dhënave të regjistrat elektronik të DPM-së”;

³ Për aktet nën ligjore mbi kimikatet: <https://turizmi.gov.al/kimikate>, <https://akm.gov.al/legjislacione/>

⁴ https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/ligj_nr_89_dt_17_7_2014_18594_1.pdf

⁵ <https://shendetesia.gov.al/publikime-kozmetika/>

⁶ www.dps.gov.al

⁷ http://dpa.gov.al/wp-content/uploads/2019/06/dpa_ligj_116-2014_11.09.2014.pdf

⁸ <http://dpa.gov.al/ep-content/uploads/2019/09/667.pdf>

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 152, datë 11.3.2022, “Për përbërjen, organizimin, funksionimin dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të këshillit të metrologjisë”;
 - Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 443, datë 22.7.2021, “Për miratimin e rregullores për parapaketimet”;
 - Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 349, datë 16.6.2021, “Për miratimin e rregullores për shishet enëmatëse”;
 - Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 631, datë 25.9.2019, “Për miratimin e rregullit teknik “Për instrumentet e peshimit joautomatik” dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”;
 - Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 770, datë 2.11.2016 “Për miratimin e rregullit teknik “Për instrumentet matëse”, për disa ndryshime në vendimin nr. 1351, datë 3.10.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për kërkesat dhe meteorologjike për instrumentet matëse, ligjërisht të kontrolluara”, dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”;
 - Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1052, datë 23.12.2015, “Për deklarimin e etaloneve kombëtare të matjeve dhe mbajtësit e tyre”;
 - Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1351, datë 3.10.2008, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe meteorologjike për instrumentet matëse ligjërisht të kontrolluara”;
- Të gjitha aktet nënligjore të DPM-së gjenden të publikuara në faqen e saj të internetit <https://www.dpm.gov.al/legjislacioni-3/>.

Kuadri ligjor i mbikëqyrjes së tregut

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit

Ligji nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, i ndryshuar me ligjin 74/2013, ligjin nr. 16/2020 dhe ligjin nr. 10/2022 është i harmonizuar me rregulloren 178/2002/EU me anë të së cilës u ngrit Autoriteti Kombëtar i Ushqimit si struktura përgjegjëse për kontrollet zyrtare dhe garantimin e sigurisë ushqimore për një produkt të sigurt në mbrojtje të shëndetit të konsumatorit përmes analizës së tre komponentëve themelorë: vlerësimit të riskut, menaxhimit të riskut dhe komunikimit të riskut në fushën e ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë, mbrojtjes së bimëve.

Legjislacioni horizontal mbi të cilën mbështetet veprimtaria kontrolluese e AKU-së për garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e sigurisë ushqimore i përshtatur me atë evropian përfshin paketën higjienike, kriteret mikrobiologjike, kriteret shëndetësore për produktet me origjinë shtazore të importuara, kontaminantet dhe aditivët ushqimore, materialet në kontakt me ushqimin, etiketimin e produkteve ushqimore, kërkesat shëndetësore për produktet ujore, ushqimet për fëmijë etj.

Për garantimin e sigurisë ushqimore dhe respektimit të kërkesave ligjore janë ligjet e mëposhtme:

- Ligji nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9441, datë 11.11.2005, “Për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e qumështit dhe të produkteve me bazë qumështi”, i ndryshuar;
- Ligji 87/2012, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 4, datë 16.8.2012, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave për therjen e kafshëve dhe tregtimin e mishit të tyre”;
- Ligji nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 17/2020, “Për produktet plehëruese”;
- Ligji nr. 8691, datë 16.11.2000, “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve”, i ndryshuar;
- Ligj nr. 10433, datë 16. 6. 2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”;
- VKM-në nr. 708, datë 9.9.2020, “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”.

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor

Legjislacioni horizontal mbi të cilën mbështetet veprimtaria inspektuese e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor (ISHSH), për garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e shëndetit publik janë ligjet e mëposhtme⁹:

- Ligji nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”,
- Ligji nr. 7643, datë 2.12.1992, “Për inspektoratin Sanitar Shtetëror”, i ndryshuar
- Ligji nr. 26/2017, “Për produktet kozmetike”.

***Inspektorati Shtetëror Mbikëqyrjes së Tregut*¹⁰**

Kuadri ligjor për mbikëqyrjen e tregut në kompetencë të ISHMT-së përbëhet nga aktet më poshtë:

- VKM nr. 36, datë 20.1.2016, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut”;
- VKM nr. 172, datë 18.3.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 36, datë 20.1.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut”, të ndryshuar;
- Ligji nr. 10489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10480/2011, “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 126, datë 15.10.2020, “Për metrologjinë;
- Ligji nr. 68/2012, “Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji”;
- Ligji nr. 10216, datë 21.1.2010, “Për detergjentet”;
- Ligji nr. 73/2021, “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë”.

Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial

Kuadri ligjor për mbikëqyrjen e tregut në kompetencë të ISHTI-së përbëhet nga aktet më poshtë:

- VKM nr. 410, datë 13.5.2015, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”;
- Ligji nr. 32/2016, datë 24.3.2016, “Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve nën presion”;
- Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, për transportin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”;
- Ligji nr. 9876, datë 14.2.2008, “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse të rinovushme për transport”;
- Ligji nr. 102, datë 23.9.2015, “Për sektorin e gazit natyror”;
- Urdhri i ministrit nr. 184, datë 5.7.2005, “Kodi i Hidrokarbureve, për kushtet teknike dhe normat e projektimit të impianteve e instalimeve të transportimit, depozitimit, dhe tregtimit të tyre”;
- Urdhri nr. 288, datë 13.10.2020, “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e inspektoratit shtetëror teknik dhe industrial”.

I.2 Shtylla II: Çështje të mbrojtjes së konsumatorëve që nuk lidhen me aspektet e sigurisë

2.1 Kuadri institucional

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit

Mbrojtja e konsumatorit, për çështje që nuk lidhen me sigurinë e produkteve të konsumatorëve, përfshin kryesisht mbrojtjen e interesave ekonomike, individuale apo kolektive dhe të drejtave të tjera të konsumatorëve, në aspektet e lidhura me politikën, legjislacionin dhe zbatimin e tij.

⁹ Për më shumë informacion: www.ins-shendetesor.gov.al

¹⁰ Për më shumë informacion: www.ishmt.gov.al

Në terma më specifike këtu përfshihen çështje të tilla si: të drejtat e konsumatorëve në kontratat e blerjeve të mallrave apo shërbimeve në qendra tregtare, edhe jashtë qendrave apo shitjeve në largësi, praktikat e padrejta tregtare, shitja e mallrave të konsumatorëve të shoqëruara me garancitë, kushtet e padrejta në kontrata, treguesi i çmimit, kreditë konsumatore, publiciteti çorientues dhe krahasues, zgjidhja alternative dhe *online* e mosmarrëveshjeve me konsumatorët, vendimet për mbrojtjen e konsumatorëve, mjedisi, turizmi, digjitalizimi etj.

Hapat e ndërmarrë në vite në lidhje me fushën e mbrojtjes së konsumatorëve kanë mundësuar adoptimin e një kuadri ligjor rregullator efikas për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve, të përafruar me direktivat e BE-së në këtë fushë. Pra, konsumatorët shqiptarë kanë një kuadër institucional dhe legjislativ, që mundësojnë nivel të njëjtë mbrojtjeje me konsumatorët e vendeve evropiane edhe në drejtim të mbrojtjes së interesave ekonomike të tyre.

Ndër arritjet e rëndësishme për periudhën 2017–2021, përmenden:

- Plotësimi dhe përmirësimi i bazës ligjore të mbrojtjes së konsumatorëve, duke siguruar fuqizimin e rolit të konsumatorit në treg. Konkretisht, janë miratuar 1 akt ligjor dhe 4 akte nënligjore, që kanë përcaktuar detyrime mbi subjektet tregtare për informimin më të mirë të konsumatorëve, rritjen e transparencës së informacionit, mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve etj., në fushat e shitjeve drejtpërdrejtë, jashtë qendrave të tregtimit dhe në largësi të produkteve dhe shërbimeve për konsumatorët, shërbimeve financiare në largësi, si dhe për ngritjen e strukturës për trajtimin e ankesave të konsumatorëve.

- Funksionimi efektiv i strukturave administrative të ngarkuara me çështjet e mbrojtjes së konsumatorëve.

- Sektori i Tregut të Brendshëm nën:

- Ministrinë përgjegjëse për ekonominë, në drejtim të hartimit të politikave dhe sigurimit të instrumenteve rregullues për mbrojtjen e konsumatorëve;

- Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve, si struktura kryesore zbatuese e legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorit, i cili në zbatim të dispozitave të reja legjislacionit të mbrojtjes së konsumatorëve, ka gjithashtu edhe rolin e autoritetit kompetent për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e procedurave të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve nga të gjitha strukturat ZAM.

- Strukturat e posaçme pranë njërive të vetëqeverisjes vendore, për kryerjen e funksioneve për informimin, njoftimin dhe ndërgjegjësimin e konsumatorëve, si dhe për mbledhjen, seleksionimin e ankesave të konsumatorëve. Përmendet këtu, se 31 bashki kanë një strukturë të posaçme ose një nëpunës me funksionet e mbrojtjes së konsumatorëve, ndërsa 30 njësi të vetëqeverisjes vendore nuk kanë strukturë apo një nëpunës për këtë qëllim.

- Ngritja e Strukturës përgjegjëse për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve të tjera nga ato që lidhen me shërbimet me interes publik, e emërtuar Drejtoria e Përgjithshme për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve (DPZAM), në varësi të ministrisë përgjegjëse për ekonominë është një nga arritjet kryesore të kësaj periudhe. Kjo strukturë plotëson sistemin institucional për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, duke siguruar që skemat ZAM, të jenë në dispozicion të konsumatorëve në të gjithë sektorët e tregut të shitjes së mallrave dhe shërbimeve. DPZAM-ja pritet të jetë funksionale brenda vitit 2022, pasi aktualisht është në ndjekje të procedurave të rekrutimit të nëpunësve të administratës publike.

- Rinovimi i përbërjes së Këshillit Bashkërendues për çështjet e mbrojtjes së konsumatorëve dhe mbikëqyrjes së tregut, nëpërmjet urdhrit të Kryeministrit nr. 62, datë 6.4.2022, “Për miratimin e përbërjes së Këshillit Bashkërendues për Mbrojtjen e Konsumatorëve”. Këshilli ka në kompetencë të nxisë diskutimet, të shkëmbejë mendime, të miratojë deklarata, opinione dhe të japë rekomandime në lidhje me çështje që kanë ndikim në mbrojtjen e konsumatorit.

- Në drejtim të zbatimit të legjislacionit të mbrojtjes së konsumatorëve, Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve ka funksionuar në mënyrë të rregullt, duke zhvilluar rreth 30 mbledhje. KMK-ja ka gjykuar çështjeve me interes publik të konsumatorëve, duke mbrojtur interesa kolektive dhe çështje me interes individual. Komisioni ka marrë rreth 45 vendime, 30 prej të cilave, në mbrojtje të interesit të përgjithshëm publik për çështje të tilla, si: praktika të padrejta tregtare, publicitet

krahasues të palejuar, mospërbushje të shërbimeve të ofruara, mungesë informacioni etj. Përmendet këtu marrja e 18 vendimeve, në lidhje me kushtet standarde të kontratës në fushën e arsimit universitar nga institucionet e arsimit të lartë universitar jopublik, me synim gjetjen dhe eliminimin e kushteve të padrejta në këto kontrata, në vijim të praktikës së ndjekur në vite nga KMK-ja për kushtet e padrejta në kontratat standarde të konsumatorëve të fushave tjera, si: furnizimi me ujë, energji elektrike etj.;

Masa të tjera të marra janë edhe:

- Inicimi në bashkëpunim me AKEP-in i hartimit të një Kodi Sjellje në fushën e komunikimeve elektronike, të nënshkruar nga operatorët e telefonisë celulare me synim ndalimin e praktikave të padrejta tregtare në fushën e komunikimeve elektronike;

- Nënshkrimi i një marrëveshje bashkëpunimi midis AMA-s dhe ministrinë përgjegjëse për ekonominë, në lidhje me mbrojtjen e konsumatorëve nga praktikat e padrejta tregtare në fushën e mediave audiovizive.

Trajtimi dhe zgjidhja e ankesave individuale të konsumatorëve, si pjesë e punës së KMK-së ka shoqëruar të gjithë periudhën e zbatimit të strategjisë. Pranë Komisionit janë paraqitur gjithsej 200 ankesa me objekt mbrojtjen e interesave individualë të konsumatorëve, nga të cilat 170 ankesa të ardhura nga konsumatorët, shoqata apo organizata të mbrojtjes së konsumatorëve, nga pushteti vendor, platforma e bashkëqeverisjes dhe 30 nga biznesi, të përmbledhura në tabelën në vijim:

Tabela nr. 6. Ankesat e konsumatorëve sipas burimit 2017–2021 (KMK)

Burimi i ankesave	Numri i ankesave në vite				
	2017	2018	2019	2020	2021
Nga konsumatorë/organizata/platforma	22	24	28	45	51
Nga tregtarë	4	6	3	10	7
Ankesa gjithsej	26	30	31	55	58

Problematicat e ankesave të konsumatorëve konsistojnë kryesisht në: mospërbushje e shërbimeve të ofruara në përputhje me kushtet kontraktore, mospërputhshmëria me kushtet e kontratës në blerjen e mallit dhe garancia e produkteve, mungesa e zbatimit të së drejtës së konsumatorit për të hequr dorë nga kontratat në largësi, kushtet e padrejta në kontratat konsumatore: në kredinë konsumatore, të paketave të udhëtimit; informacioneve të pavërteta në publicitete të ndryshme, publicitet krahasues të palejuar etj.

Një paraqitje skematike e problematikave të sipërpërmendura të ankesave, për vitin 2021 jepet në vijim:

Grafik nr. 7. Ankesat e konsumatorëve sipas problematikave



Zgjidhja e ankesave është siguruar nëpërmjet: vendimeve të KMK-së; zgjidhje me mirëkuptim/ndërmjetësim me tregtarët, duke përbushur funksionet e një strukture për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve (ZAM); delegim tek institucionet përkatëse për trajtim të mëtejshëm, në bazë të fushës së përgjegjësisë (AKEP, ISHMT, ERRU, ERE, MTM etj.).

Sfidat kryesore në këtë fushë janë: përmirësimi i mëtejshëm i legjislacionit të mbrojtjes së konsumatorëve, në kushtet e zhvillimeve të vazhdueshme teknologjike në tregun *online*, të shërbimeve digjitale apo/dhe përdorimit të mjeteve digjitale nga konsumatorët, si dhe përafrimi i tij me zhvillimet/ndryshimet më të fundit të legjislacionit evropian në këtë fushë.

Këto ndryshime ligjore, pjesë e direktivave të reja evropiane synojnë të garantojnë transparencën e duhur ndaj konsumatorëve, zbatimin e të drejtave të tyre, si dhe përmirësimin e funksionimit të tregut; fuqizimi i kapaciteteve administrative dhe burimeve njerëzore të strukturës përgjegjëse të mbrojtjes së konsumatorëve, Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve, si dhe institucioneve të tjera përkatëse në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve; ngritja dhe bërja e funksionale e strukturave të posaçme të mbrojtjes së konsumatorëve, pranë të gjitha njësive të vetëqeverisjes vendore në vend.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka si mision ndër të tjera: hartimin dhe zbatimin e politikave për një zhvillim të qëndrueshëm të turizmit nëpërmjet nxitjes së investimeve në fushën e turizmit, të agroturizmit, ekoturizmit, turizmit ujor, zonave bregdetare, ngritjen, monitorimin dhe kontrollimin e sistemit të standardeve në turizëm dhe edukimit të biznesit në fushën e turizmit, të promovimit të produktit dhe destinacioneve turistike, si dhe koordinimit e bashkëpunimit me strukturat e tjera shtetërore me qëllim arritjen e objektivit të saj.

Garantimi i sigurisë së turistëve, paralelisht me krijimin e standardeve në ofrimin e shërbimeve në sektorin e turizmit janë në fokus të politikave të ministrisë përgjegjëse për turizmin.

Risi është aderimi i Shqipërisë në vitin 2022 në rezolutën 732 të Kodit Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Turistëve (ICPT) të Organizatës Botërore të Turizmit. Ky kod do të shërbejë si një udhëzues praktik mbi mënyrën se si mund të asistohen turistët në situata krize, si dhe mbi zhvillimin dhe harmonizimin e të drejtave konsumatore të turistëve në realitetin postcovid, duke mbuluar çështje kryesore si:

- Ndihmë/asistencë për turistët ndërkombëtarë në situata emergjente;
- Mbrojtja e turistëve në kontrata;
- Zgjidhja ndërkombëtare e mosmarrëveshjeve të udhëtimit dhe turizmit nëpërmjet mjeteve alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

Sfidat kryesore sa i takon çështjes së mbrojtjes së konsumatorëve turistë kanë të bëjnë me pasjen e një kornize ligjore sa më të plotë në këtë fushë, si dhe nga ana tjetër sigurimin e implementimit të kuadrit ligjor nga të gjithë operatorët dhe subjektet private që ushtrojnë veprimtari në sektorin e turizmit. Në kontekstin e plotësimit të kornizës ligjore në sektorin e turizmit me fokus mbrojtjen e konsumatorit/turistit dhe njëkohësisht vendosjen e standardeve, janë hartuar dhe rishikuar së fundmi:

- VKM-ja për stacionet e plazhit që parashikon masa për sigurinë shëndetësore dhe fizike të turistëve që pushojnë në zonat bregdetare nëpërmjet përcaktimeve për vrojtuesit e plazhit, perimetrit e sigurisë në zonat e lejuara për notim dhe korridoret për hyrje-daljen e mjeteve lundruese;

- Ligji për turizmin detar që përfshin ndër të tjera përcaktimet për kolaudimin e mjeteve lundruese dhe sigurimin ndaj palëve të treta;

- VKM-ja për disiplinimin e lëvizjes dhe ankorimit të mjeteve lundruese.

Sfidat në sektorin e turizmit, janë:

- përmirësimi i kuadrit ligjor, i cili do të impaktojë marrëdhëniet të cilat do të ofrojnë një mbrojtje më të madhe të të drejtave të turistit dhe do të qartësojë detyrimet e operatorëve ekonomikë;
- informimi i turistëve mbi të drejtat e tyre në fushën e turizmit;
- monitorimi i cilësisë së shërbimit turistik mbetet një sfidë për të përmirësuar shërbimin sipas standardeve të përcaktuara ligjore.

Adresa e postës elektronike për dërgimin e ankesave: info@turizmi.gov.al, link; “E drejta për t’u informimin dhe për t’u ankuar” - *My Blog* (bregdeti.gov.al).

Tabela nr. 7. Të dhënat e inspektimeve në fushën e turizmit 2017–2021 (AKB)

DREJTORIA E SIGURIMIT TË ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM TË TURIZMIT DHE ZONAVE BREGDETARE

Vi ti	Institucio ni	Aktivite kontrolluese /inspektuese Total	Inspe ktime Total	Inspek time AU+O T+UT	Inspe ktime SP	Inspe ktime SA	Monitori me SA+Agr oturizë m	Monit orime SP	Monit orime AU	Masa Admini strative	Paralaj mërim e	Gj ob a
20 17	ISHMT	726	726	29	697					50		50
20 18	ISHMT & ISHMPUT	890	347	347				543		20		20
20 19	ISHMPUT	2078	457	163	294		820	801		193	153	40
20 20	AKB	2214	117	1	116		1797	300		71	53	18
20 21		1652	50		50		454	769	379	40	27	13
20 22		1106	773	120	427	226	167	166		208	120	88
T ot al		8666	2470	660	1584	226	3238	2579	379	582	353	229

Legjenda:

AU - agjenci udhëtimi;

OT - operator turistik;

UT - udhërrëfyes turistik;

SP - stacion plazhi;

SA - strukturë akomoduese.

Enti Rregullator në fushën e Energjisë

Enti Rregullator i Energjisë është autoriteti rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe të gazit natyror në Shqipëri, i cili funksionon në bazë të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, si dhe akte të tjera nënligjore të miratuara në zbatim të tyre. Në vijim me hyrjen në fuqi të tij, ligji i aplikueshëm për burimet e rinovueshme do të jetë ligji nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.

Ndër objektivat kryesorë të ERE-s është mbrojtja e interesave të konsumatorëve, në lidhje me shërbimet e rregulluara të ofruara nga operatorët e sektorit të energjisë elektrike apo gazit natyror. ERE kryen funksionet e saj në vlerësim të çuarjes përpara të objektivave të përcaktuar në ligj, duke promovuar konkurrencë efektive dhe transparente midis pjesëmarrësve të tregut. Në metodologjinë e punës së ERE për të kryer funksionet e saj për qëllime të promovimit të konkurrencës, ERE mban në konsideratë shkallën në të cilën interesat e konsumatorëve duhet të mbrohen si rrjedhojë e ushtrimit të këtyre funksioneve, si dhe nëse ato do të promovojnë ose jo transparencën në veprimtarinë në treg.

Ndër arritjet më efektprurëse për këtë qëllim ka qenë miratimi nga ERE i një sërë aktesh që lidhen ngushtësisht me realizimin e shërbimit me standard nga ana e të licencuarve, siç janë rregulloret e standardeve të cilësisë të miratuara nga ERE, por edhe kujdesi për të rregulluar me akte nënligjore modalitetet e ofrimit të një shërbimi me standarde për konsumatorin. Këtu mund të përmendet rregullorja mbi masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimi nga ERE për performancën e shërbimit ndaj klientit.

Gjatë këtij 5-vjeçari, ERE miratoi rregulloren për standardet e trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit, çka vendos kornizën e duhur ligjore për të mbrojtur konsumatorin gjatë praktikave të ankimimit të të licencuarit. Ndarja e operatorit të sistemit të shpërndarjes nga veprimtaritë e tjera në sektor, një detyrim i ligjit të sektorit të energjisë, garantoj shërbimet e ndërshtetërisht të aktivitetit nëpërmjet tarifave të ndara të aksesit në rrjet nga ato të aktivitetit të tjera në sektor. Gjatë viteve

2017–2021 janë miratuar mbi 90 akte nënligjore në zbatim të ligjit të energjisë elektrike dhe atij të gazit natyror, 80 % e të cilave lidhen me rregullim të sektorit me impakt të drejtpërdrejtë të konsumatori.

Numri i përgjithshëm i konsumatorëve të energjisë elektrike për vitin 2021 është 1,279,460 dhe krahasuar me vitin 2020 vihet re një rritje e numrit të përgjithshëm të klientëve me rreth 6,460. Ndërkohë numri total i konsumatorëve të energjisë elektrike që janë shërbyer me kontratë furnizimit gjatë vitit 2017 ka qenë 1,209,958 klientë duke shënuar një rritje jo të vogël në këtë 5-vjeçar. Për vitin 2021 pjesën më të madhe të klientëve të Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) sh.a. e zënë klientët familjarë që shkojnë në 86.17% të numrit total të klientëve të FSHU sh.a. Në të njëjtën kohë klientët familjarë zënë pjesën më të madhe në FSHU sh.a. dhe pjesën më të madhe të energjisë së faturuar për vitin 2021 respektivisht 49.36% të faturimit të realizuar për vitin 2021, ku 36.92% e përbëjnë klientët privatë, dhe pjesën tjetër klientët buxhetorë me rreth 5.99% dhe jobuxhetorë 7.72%.

Trajtimi i ankesave është një pjesë e rëndësishme e punës së ERE-s, që konsiston në funksionin e saj si një Strukturë për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve, çka përfshin trajtimin e ankesave të regjistruara në ERE për zgjidhje apo trajtimin e ankesave dhe konflikteve direkte që lindin nga marrëdhëniet midis furnizuesit të energjisë elektrike apo gazit natyror dhe klientëve, duke pasur si qëllim mbrojtjen e interesave të klientëve në aspektin individual dhe ekuilibrimin e interesave të palëve. Një pjesë e konsiderueshme e ankesave që paraqiten në ERE, kanë si shkak kryesor mungesën e informacionit në lidhje me detyrimet e konsumatorëve ndaj shoqërive të licencuara, por edhe kërkesa/ankesa që gjenerohen nga mosnjohja e rolit të ERE-s. Për të shmangur sa më sipër, ERE duke konstatuar dhe mungesën e informacionit nga konsumatorët, ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të informuar konsumatorin në lidhje me të drejtat dhe detyrimet ndaj operatorëve të licencuar, por edhe për të drejtat e tyre në raport me ERE-n, me qëllim shmangien e konflikteve mes palëve. Kështu, për këtë qëllim janë organizuar fushata të mirëfillta informimi nëpërmjet broshurave informative për konsumatorin, aksesit në të cilat është grantuar jo vetëm në ambientet e ERE-s, por edhe nëpërmjet bashkëpunimit me shoqata të mbrojtjes së konsumatorit, nëpërmjet publikimeve periodike në faqen e internetit të ERE, por edhe nëpër rrjetet sociale të saj, si një mjet i shpejtë dhe eficient në arritjen e qëllimit për informim. Janë zhvilluar gjithashtu takime me shoqata për mbrojtjen e konsumatorit, si dhe janë nënshkruar një sërë memorandumesh bashkëpunimi me universitete pikërisht me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të kategorive të caktuara të konsumatorit në lidhje me fushën e përgjegjësisë së ERE, por edhe rolin e saj në mbrojtjen e konsumatorit.

Ndër sfidat kryesore ka qenë dhe është ruajtja e balancës mes nevojës për rregullimin e tregut, përcaktimit të tarifave të drejta e jodiskriminuese, vendosja e standardeve objektive e të arritshme për operatorët e rrjetit dhe informimi i konsumatorit mbi këto zhvillime, si dhe mbrojtja e tij ndaj praktikave të padrejta nga ana e të licencuarve.

Tabela nr. 8. Trajtimi i ankesave 2017–2021 (ERE)

Viti	Numri i ankesave gjithsej	Zgjidhja e ankesës			
		Zgjidhur nga institucioni	Deleguar	Jashtë kompetencës	Tjetër – trajtim jashtë afatit nga institucioni i deleguar
2017	564	492			72
2018	279	158			121
2019	182	78			104
2020	165	106			59
2021	155	139			16

Ankesat në ERE adresohen nëpërmjet këtyre burimeve aksesit:

- 1) shërbimit postar. Adresa: Blvd “Bajram Curri, Rr. Viktor Eftemiu 1023,
- 2) E-mail: erealb@ere.gov.al,
- 3) plotësimi të ankesës në www.ere.gov.al.

Numri i gjelbër 0800 23 23 është në dispozicion pa pagesë për të gjithë konsumatorët.

Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura.

Enti Rregullator i Ujit është autoriteti rregullator i sektorit të furnizimit me ujë, grumbullimit, largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura në Shqipëri, i cili funksionon në bazë të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, i ndryshuar. Në fokus të objektivave institucionale është krijimi i një sektori të vetëqëndrueshëm financiarisht që ofron shërbime të një cilësie të lartë dhe të përballueshme për të gjithë konsumatorët.

Në sektorin UK shërbimi i “grumbullimit, shpërndarjes së ujit për konsum publik” për vitin 2021 është ofruar nga 58 shoqëri ujësjellës-kanalizime nga të cilat vetëm 1 prej tyre kryen edhe shërbimin e “përpunimit të ujit të pijshëm për konsum publik”. Shërbimi i “grumbullimit e largimit të ujërave të ndotura” ofrohet nga 53 shoqëri ndërsa përpunimi i tyre arrihet të kryhet nëpërmjet 8 impianteve të përpunimit të ujërave të ndotura.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 11.5.2022, “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” pati si pasojë **agregimin e sektorit nga 58 shoqëri individuale UK në 15 shoqëri rajonale për ofrimin e shërbimit UK me pronar qeverinë qendrore, me 51% të aksioneve, si dhe njësitë e qeverisjes vendore me 49% të tyre.** Qëllimi i riorganizimit të sektorit është përmirësimi i gjendjes financiare të shoqërive rajonale dhe sigurimi i furnizimit me ujë dhe të shërbimeve të kanalizimeve në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke plotësuar nevojat e një ekonomie në zhvillim, si dhe duke mbrojtur mjedisin, shëndetin e sigurinë e qytetarëve. Gjatë viteve 2017–2021 në fokus të punës së rregullatorit, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorit, ka qenë përmirësimi i standardeve të shërbimeve në sektorin UK nëpërmjet instrumenteve rregullatore si më poshtë:

Seanca dëgjimore me publikun

Vendosja e organizimit të seancave dëgjimore me publikun si një nga hallkat e domosdoshme në procesin e miratimit të tarifave dhe hartimi i një rregullore për organizimin e saj në vitin 2018 pati si qëllim sqarimin dhe përfshirjen e publikut në procesin e propozimit të tarifave të reja, rritjen e transparencës, besimit dhe bashkëpunimit të shoqërive UK me publikun. Gjithashtu, informimin e konsumatorëve në lidhje me detyrimin dhe problematikën që hasin shoqëritë për të plotësuar standardet e cilësisë së shërbimeve, njohjen me objektivat e shoqërisë për të ardhmen, nga ana tjetër dhe ndërgjegjësimin e tyre në lidhje me detyrimet që duhet të përmbushin konsumatorët (publiku) ndaj shoqërisë UK. Zhvillimi i këtyre seancave në qendër të qyteteve ku aksesimi i konsumatorit është më i thjeshtë ka rritur njohjen dhe ndërgjegjësimin e konsumatorëve jo vetëm për procesin e vendosjes së tarifave, por edhe për të shprehur pakënaqësitë në lidhje me shërbimin apo çfarë duhet të përmirësohet nga shoqëria. Përgjatë viteve 2017–2021 janë organizuar 32 seanca dëgjimore dhe prania e përfaqësuesve të rregullatorit në këto seanca ka ndikuar në vendosjen e objektivave konkretë për shoqërinë në drejtim të ofrimit të shërbimit.

Trajtimi i ankesave ndaj konsumatorëve

Detyrimi ligjor që nëpërmjet trajtimit të ankesave të konsumatorëve, të sigurohet që dhënia e shërbimit nga ana e shoqërive UK të jetë në përputhje me aktet nënligjore duke siguruar kështu cilësinë, eficiencën dhe vazhdueshmërinë e shërbimit është në fokus të rregullores së trajtimit të ankesave të ERRU-së miratuar në vitin 2019. Trajtimi i ankesave me rregulla të përcaktuara rriti angazhimin e shoqërive në trajtimin e ankesave, si dhe zgjidhjen e tyre më shumë në favor të konsumatorit në raport me nivelin total të ankesave. Konsumatorët në sektorin e ujit janë të ndarë në tri kategori kryesore: konsumatorët familjarë, konsumatorë publik dhe konsumatorë privat. 90% e ankesave të drejtuara në ERRU janë nga konsumatorë familjare.

Natyra e ankesave të paraqitura pranë ERRU-së në vitet e raportuara në tabelën e mëposhtme ka qenë kryesisht mbi “faturimin aforfe”, “zëvendësimin e shpeshtë të ujëmatësit dhe pa respektuar procedurat nga shoqëria UK”, “mbifaturimi”, “mosnjohjen e detyrimeve nga ana e konsumatorëve”, “problemet me kontratën për shërbime ujësjellës-kanalizime”.

Tabela nr. 9. Trajtimi i ankesave 2017–2021 (ERRU)

Viti	Numri i ankesave gjithsej	Zgjidhja e ankesës				Komente
		Zgjidhur nga institucioni	Deleguar	Jashtë kompetencës	Tjetër	
2017	58	14	0	0	0	Ndjekur rrugën gjyqësore; konsumatori ka ndërvepruar me shoqërinë UK
2018	39	10	0	0	0	Ndjekur rrugën gjyqësore; konsumatori ka ndërvepruar me shoqërinë UK
2019	18	6	0	0	0	Ndjekur rrugën gjyqësore; konsumatori ka ndërvepruar me shoqërinë UK
2020	9	5	0	0	0	Ndjekur rrugën gjyqësore; konsumatori ka ndërvepruar me shoqërinë UK
2021	16	7	0	0	0	Ndjekur rrugën gjyqësore; konsumatori ka ndërvepruar me shoqërinë UK

Mjetet e ankimit të vendosura në dispozicion nga ERRU për ankesat e konsumatorëve janë:

- 1) Posta zyrtare Adresa: Blvd “Bajram Curri, Rr. Viktor Eftimiu 1023,
- 2) E-mail: public@erru.al,
- 3) Plotësimi i ankesës *online* në www.erru.al.

Struktura e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve

Në zbatim të legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorit, në vitin 2021 është krijuar brenda strukturës së ERRU-së struktura përgjegjëse ZAM e përbërë nga 3 anëtarë (SZAM) dhe është hartuar rregullorja e brendshme për përcaktimin e procedurës dhe mekanizmave për funksionimin e strukturës përgjegjëse për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve. Rreth 30% e ankesave të konsumatorëve kanë gjetur një zgjidhje të kënaqshme për konsumatorët me ndërmjetësimin e rregullatorit. Pjesa tjetër e ankesave kanë ndjekur rrugën gjyqësore për zgjidhjen e ankesës së tyre, kryesisht ato me natyrë “Mbifaturimi” apo “Faturimi aforfe” ose kanë vijuar me zgjidhjen e ankesës ku secila palë ka përmbyshur detyrimet sipas kontratës së shërbimit.

Monitorimi për ankesat e konsumatorëve ndaj shoqërive UK

Përgjatë viteve 2020–2022 janë zhvilluar 3 monitorime në shoqëritë me numrin më të madh të klientëve UK Tiranë, UK Durrës dhe UK Elbasan, ku raportet e monitorimit kanë evidentuar gjetjet dhe përbajnë rekomandime konkrete në lidhje me përmirësimin e punës së shoqërive UK në trajtimin e ankesave të konsumatorëve. Realizimi i këtyre rekomandimeve është sërish subjekt monitorimi.

Institucioni përgjegjës në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare

Rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike të ofruara nga rrjete celulare dhe fikse, gjatë viteve të fundit kanë vijuar të jenë mbështetës të rëndësishëm të lehtësimit të komunikimit ndërmjet konsumatorëve, si dhe përdorimit prej tyre të platformave elektronike *online*, që mundësojnë ofrimin e shërbimeve të ekonomisë digjitale, si: tregtia elektronike, shërbime e-qeverisja, edukimi etj.

Bazuar në raportimet e AKEP-it për vitin 2022 mbi komunikimet elektronike rezultojnë këto të dhëna:

- Numri i pajtimtarëve aktivë të shërbimeve nga rrjete celulare: 2.8 milionë;
- Numri total i pajtimtarëve aktivë (përdorim të shërbimeve gjatë 3 muajve të fundit) të shërbimeve nga rrjete celulare arriti në 2.6 milionë;
- Përdorues me akses *broadband* mobile: 2.1 milionë ose 77% (4% më shumë se në vitin 2021);
- Volumi i konsumit të internetit mobile arriti 184 milionë GB ose 7,3 GB në muaj/përdorues (18% më shumë se në vitin 2021);
- Mbulimi i popullsisë me rrjete 3G/4G në nivele rreth 99%;
- Në rrjetet fikse *broadband* në fund të vitit 2022, janë 582,110 pajtimtare me akses *broadband* fiks. Pavarësisht terrenit malor, Shqipëria ka mbulim shumë të mirë me rrjete celulare 2G/3G/4G. Përmirësimi i ndjeshëm në mbulimin me rrjet 4G ka sjellë njëkohësisht rritje të ndjeshme të shpejtësisë së shërbimit të internetit celular, si dhe të përdorimit të të dhënave, ku në vitin 2022

një përdorues celular konsumoi mesatarisht rreth 7.3 GB të dhëna në muaj apo 3.4 herë më shumë se në vitin 2017 (2.1 GB).

Megjithëse historikisht Shqipëria ka pasur një mbulim shumë të kufizuar me rrjete fikse telefonike dhe më pas internet, kryesisht në zona urbane, rritja e kërkesës për akses në internet ka ndikuar në rritjen e ndjeshme të investimeve dhe mbulimit me rrjete fikse *broadband* në periudhën 2017-2022. Numri pajtimtarëve me akses *broadband* fiks në fund të vitit 2022 arriti në 582 mijë, që përbën një rritje mbi 85% krahasuar me vitin 2017.

Për sa u përket shërbimeve postare, një ndër ndryshimet kryesore është zhvendosja nga komunikimi tradicional i bazuar në letër drejt komunikimeve me mjete elektronike, gjë e cila ka çuar në rënie të konsiderueshme të sasisë së objekteve postare. Në të njëjtën kohë, digjitalizimi ka nxitur rritjen e sasisë së pakove postare për shkak të rritjes së tregtisë elektronike (*e-Commerce*).

Pas një periudhe rënie me ritme të moderuara të numrit të objekteve postare në dy vitet e fundit, për shkak edhe të pandemisë Covid-19, në vitin 2021 është vërejtur një rritje e sasisë së pakove postare. Numri total i objekteve postare në Shqipëri gjatë vitit 2021 ishte rreth 27.2 milionë, një rritje me 9.8% krahasuar me vitin 2020 dhe me 9% në krahasim me vitin 2017.

Në periudhën 2017–2021, AKEP-i dhe MIE-ja kanë qenë pjesë e procesit të bashkëpunimit rajonal të Ballkanit Perëndimor (në vijim “BP”) për reduktimin dhe heqjen e tarifave *roaming* në vendet e BP-së. Falë këtij procesi bashkëpunimi, të asistuar nga KE-ja dhe RCC-ja, ministritë përgjegjëse për komunikimet elektronike të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor (Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Serbia), nënshkruan më 4 prill 2019 “Marrëveshjen mbi reduktimin e çmimeve të shërbimeve *roaming* në rrjetet publike të komunikimit celular në rajonin e Ballkanit Perëndimor”.

Në zbatim të kësaj marrëveshje, duke filluar nga data 1.7.2021, të gjithë pajtimtarët (konsumatorë dhe biznese) e rrjeteve celularë të RSH-së që udhëtojnë në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor (Kosovë, Bosnjë-Hercegovinë, Mali i Zi, Maqedoni e Veriut dhe Serbi) gëzojnë të drejtën e përdorimit të të gjitha shërbimeve celulare *roaming* të rregulluara në këto vende të BP-së sikundër të ishin në Shqipëri, pra pa tarifa/shpenzime shtesë për *roaming* (RLAH-Roam Like At Home). Implementimi me sukses i RLAH-it me BP në Shqipëri, duke filluar nga data 1.7.2021 përbën një nga arritjet më të rëndësishme jo vetëm në kuadër të bashkëpunimit rajonal dhe me KE-në, por sidomos për përfitimet e qytetarëve të RSH-së në përdorimin e shërbimeve celulare. Një ndër prioritet kryesorë të punës së AKEP-it në vitin 2021 ka qenë dhe marrja e masave për përfshirjen dhe integrimin shoqëror të personave me aftësi të kufizuar në aksesin dhe përdorimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike. Rregullorja nr. 49/2021 “Për mbrojtjen e konsumatorëve dhe pajtimtarëve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike” përmban një kapitull të veçantë për masat që duhet të ndërmarrin operatorët për të garantuar akses të barabartë për personat me aftësi të kufizuar në shërbimet e komunikimeve elektronike. Tre operatorët kryesorë të komunikimeve elektronike kanë publikuar në faqet e tyre të internetit seksione të dedikuara për masa të veçanta për personat me aftësi të kufizuar, sipas llojit të aftësisë së kufizuar si kufizime në shikim, dëgjim/artikulum, lëvizje etj., përfshirë ofrimin e paketave të veçanta tarimore me skonto për këto kategori përdoruesish dhe udhëzime lehtësirat e ofruar dhe komunikim të veçantë të kujdesit të klientit të operatorit me këta pajtimtarë.

Gjatë vitit 2021, AKEP-i ka administruar 2077 ankesa të përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe postare, krahasuar me 90 ankesa në vitin 2017. Në vitin 2021, 2066 ankesa ishin me objekt përdorimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike (prej të cilave 1903 ishin ankesa për portim numri celulare dhe 163 ankesa për pengesa të operatorëve për mbyllje kontrate, çështje të lidhura me faturimin apo pagesat, probleme me cilësinë e shërbimit të aksesit në internet, dhe reduktimi/ndryshimi i kanaleve TV në paketat e integruara të shërbimeve të rrjeteve fikse), 5 ankesa nga përdorues të shërbimeve postare, dhe 3 ankesa jo të lidhura me shërbime të komunikimeve elektronike dhe postare (blerje *online* dhe telefonata pa kërkesë). Në shumicën e rasteve, ankesat e ardhura në AKEP dhe të përcjella për trajtim tek ofruesi i shërbimit elektronik ose postar i ankimuar janë zgjidhur prej ofruesit të shërbimit, dhe përdoruesit kanë qenë

dakord me zgjidhjen/sqarimet, duke mos pasur nevojë për kalim në procedurë formale zgjidhje (alternative) mosmarrëveshje apo ZAM nga AKEP-i. Për të adresuar problematikat në lidhje me refuzimin e bartjes së numrit, AKEP-i gjatë viteve 2021 dhe 2022 ka kryer dy procese inspektimi të të tre operatorëve celularë. Ndaj tri subjekteve të inspektuara, AKEP-i ka vendosur masa kryesore administrative “gjobë”, si dhe dënim administrativ plotësues në formën e rekomandimeve, si dhe korrigjim të shkeljeve të konstatuara brenda një afati kohor të arsyeshëm. Gjithashtu për vitin 2022, AKEP-i ka planifikuar që të kryejë ndryshime në rregulloren e portabilitetit, me qëllim që të përmirësojë procesin e realizimit të bartjes së numrit nëpërmjet përcaktimeve më të qarta për të adresuar numrin e lartë të refuzimeve të kërkesave për shkak të ID-së dhe detyrimeve kontraktore të pajtimtarit ndaj operatorit dhënës.

Sfidat e sektorit të komunikimeve elektronike janë:

1. Pengesat/barrierat e ofruesve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike publike të lidhura me kushtet kontraktore për kohëzgjatjen, rinovimin dhe përfundimin e kontratave të pajtimtarit, si dhe procedurat për trajtimin e ankesave të konsumatorëve/pajtimtarëve;
2. Pengesat/barrierat e operatorëve të rrjeteve celulare për konsumatorët/pajtimtarët që të ushtrojnë të drejtën e tyre të portimit të numrit celular sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara në aktet ligjore dhe rregullore;
3. Probleme me cilësinë/shpejtësinë e shërbimit të aksesit në internet;
4. Problematika e telefonatave të padëshiruara të kompanive të marketingut në drejtim të konsumatorëve.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

Mbrojtja e konsumatorit dhe investitorit është një drejtim i rëndësishëm ku është fokusuar puna e Autoritetit gjatë këtyre viteve. Ky objektivi kryesor i veprimtarisë rregullore dhe mbikëqyrëse të Autoritetit u realizua nëpërmjet proceseve të:

- Shqyrtimit dhe trajtimit të ankesave të konsumatorëve dhe investitorëve;
- Monitorimit të zbatimit të legjislacionit në fuqi lidhur me detyrimin për informim të publikut, si dhe afatet e trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim;
- Rritjes së edukimit financiar për publikun.

Autoriteti ka realizuar reformimin e strukturës organizative si një strukturë e posaçme, e dedikuar për mbrojtjen e konsumatorit dhe edukimin financiar të tij.

AMF-ja ka në funksionim mekanizma komunikimi me qytetarët të cilat mundësojnë asistencën ndaj tyre jo vetëm nëpërmjet trajtimit formal të ankesave e kërkesave, por edhe duke krijuar mundësinë që konsumatori të vihet në kontakt lehtësisht dhe në çdo kohë me AMF-në. Për këtë Autoriteti ka në dispozicion të publikut numrin e telefonit (tel: +355(0)42257560, 0800 6969, Celular +355 694060671) dhe adresë email-i konsumatori@amf.gov.al, të cilat janë të aksesueshme në faqen zyrtare *online* të Autoritetit. Gjithashtu faqja zyrtare *online* e Autoritetit ofron informacion të vazhdueshëm mbi zhvillimin e tregjeve nën mbikëqyrje, me bazën ligjore të përditësuar, njoftimet për veprimtarinë vendimmarrëse të Bordit të Autoritetit etj. Në rubrika të veçanta të saj pasqyrohen raporte periodike statistikore, informacione edukuese për konsumatorin, si edhe njoftime për zhvillimet e reja në vendet e rajonit për këto tregje, nëpërmjet publikimeve të përmuajshme të lajmeve. Faqja *online* pasqyron informacion për subjektet që veprojnë në tregjet e mbikëqyrura duke dhënë formën e organizmit dhe stafin drejtues ekzekutiv.

Për të rritur mundësinë e informimit të publikut, AMF-ja ka përgatitur dhe publikuar materiale informuese, të cilat renditen:

- Hartim i broshurave informuese (sigurimi i pronës, sigurimi i shëndetit, tregu i sigurimeve);
- Materiale informative të publikuara në faqen e Autoritetit (tregu i sigurimeve “Pyetjet më të shpeshta”).

Shqyrtimi dhe trajtimi i ankesave të konsumatorëve dhe investitorëve gjatë 4 viteve të fundit ka rezultuar si më poshtë:

Tabela nr. 10. Të dhëna mbi ankesat në fushën e shërbimeve financiare (AMF)

Viti	Numri i ankesave gjithsej	Zgjidhja e ankesës				Kërkesa për informacion nga konsumatori
		Zgjidhur nga institucioni	Deleguar	Jashtë kompetencës	Nuk u konstatuan shkelje	
2018	82	51	0	2	29	0
2019	94	47		5	30	12
2020	181	108	0	14	49	10
2021	221	135	0	9	53	24

Shqyrtimi i ankesave të konsumatorit/investitorit ka synuar zgjidhjen në mënyrë profesionale, të paanshme e të shpejtë të ankesave të depozituara. Autoriteti nëpërmjet shqyrtimit të ankesave ka evidentuar problematikat e subjekteve duke ndërhyrë në kohë për të zgjidhur çështje konkrete, si dhe për të marrë masat e duhura për të shmangur përsëritjen e problematikave të njëjta në të ardhmen.

Në funksion të verifikimit të vazhdueshëm të respektimit të afateve ligjore të trajtimit dhe pagesës së dëmshpërblimeve që rrjedhin nga kontratat e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit, shërbeu edhe përditësimi i funksionimit të regjistrat elektronik të dëmeve, duke bërë të mundur që afatet e trajtimit të dëmshpërblimeve të monitorohen në kohë reale nga Autoriteti, duke ndërhyrë në rast evidentimi të vonësive në trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim, edhe në rastet kur konsumatori nuk ka paraqitur ankesë.

Gjatë kësaj periudhe është punuar për të bërë të mundur depozitimin nëpërmjet sistemit *online* të ankesave që mund të kenë konsumatorët për shërbimet që ata përfitojnë nga subjektet, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në tregjet që mbikëqyren nga Autoriteti, i cili u finalizua dhe u vu në funksionim në muajin shkurt 2019.

E rëndësishme ishte edhe hartimi i “Kartës së të drejtave të konsumatorit dhe investitorit në tregjet nën mbikëqyrje”. Karta përcakton të drejtat themelore që gëzon konsumatori dhe investitori në marrjen e shërbimeve në tregjet financiare nën mbikëqyrjen e Autoritetit, në përputhje me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e AMF-së dhe ligjeve specifike, që rregullojnë secilin nga tregjet financiare jobankare.

Sfida e Autoritetit është të sigurojë vendosjen dhe zbatimin në vazhdimësi të rregullave të reja për mbrojtjen e konsumatorit, në linjë me zhvillimet e tregut, për t’u paraprirë problemeve si:

- Garantimi i mbrojtjes së konsumatorëve nëpërmjet identifikimit paraprak dhe ndërhyrjeve në rast të produkteve të papërshtatshme ose me përshtatshmëri të ulët për sa u përket kushteve të mbulimit të produkteve të sigurimit.

- Garantimi i mbrojtjes së konsumatorëve nëpërmjet ndërhyrjeve në rast të konstatimit të tarifave të larta të primeve duke urdhëruar rishikimin e tarifave në përputhje me parimet aktuariale dhe metodologjinë e përdorur për përfshirjen e faktorëve të riskut të përcaktuara me rregullore nga Autoriteti.

- Sigurimi i trajtimit të drejtë dhe të përshtatshëm të konsumatorëve gjatë procesit të trajtimit të ngjarjeve të siguruar.

Banka e Shqipërisë

Gjatë 5 viteve të fundit Banka e Shqipërisë renditet ndër institucionet kontribuese në përmirësimin e mbrojtjes konsumatore në ato fusha ku është përgjegjëse. Vlen të përmendet përmirësimi i vazhdueshëm i kuadrit ligjor dhe rregullator të lidhur me kredinë konsumatore dhe hipotekare, për transparencën, tarifat dhe penaltetet për shërbimet bankare dhe financiare dhe edukimi i vazhdueshëm i publikut. Aktet nënligjore aktualisht në fuqi të Bankës së Shqipërisë kanë përafruar në një nivel të lartë direktivat respektive evropiane për kredinë konsumatore dhe për kredinë hipotekare. Plotësimi i këtyre kërkesave monitorohet dhe mbikëqyret në mënyrë të vazhdueshme nga Banka e Shqipërisë. Gjithashtu, prej më se 15 vjetësh, Banka e Shqipërisë është angazhuar në zgjerimin dhe thellimin e kulturës financiare të publikut në vend. Në mënyrë të përgjithshme, programet, aktivitetet dhe botimet e veçanta edukative të përgatitura nga Banka e Shqipërisë në këtë drejtim, kanë synuar në kultivimin dhe përforcimin e një kulture financiare në shoqërinë shqiptare, si dhe në nxitjen e përfshirjes financiare.

Nismat e Bankës së Shqipërisë të ndërmarra për kultivimin e kulturës financiare ndër vite kanë qenë të shumta dhe të larmishme (rreth 83 aktivitete), ndër të cilat veçojmë botimet edukative, programet edukative për gazetarët, programet edukative dedikuar mësuesve, programet edukative dedikuar fëmijëve, programet edukative dedikuar studentëve, javën globale të parasë, fushatat ndërgjegjëse, me qëllim informimin dhe edukimin e konsumatorit, dhe së fundi Strategjinë Kombëtare të Edukimit Financiar. Viti 2021 shënoi fillimin e përpjekjeve të BSH-së në bashkëpunim me autoritetet vendimmarrëse dhe aktorët e tjerë të tregut për hartimin e një dokumenti strategjik kombëtar për edukimin financiar, i cili do të synojë përmirësimin e kulturës dhe përfshirjes financiare të publikut të gjerë, si një ndihmë konkrete për aftësimin e konsumatorit shqiptar.

Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me aktorë të tjerë publikë dhe privatë dhe me asistencën e Bankës Botërore ka hartuar Strategjinë Kombëtare për pagesat në vlerë të vogël 2018-2023. Kjo strategji e ka vënë theksin në shërbime shërbimet e pagesave me në qendër klientin dhe të përballueshme për të, bazuar në llogari, të cilat janë përkthyer në: (i) dizenjimi i produkteve konvencionale të pagesave për individët të cilët nuk zotërojnë llogari bankare, të cilat janë të përballueshme, duke ruajtur gjithsesi tiparet thelbësore të një llogarie transaksioni; (ii) krijimin e produkteve të pagesave më të volitshme në përgjithësi, duke mundësuar ndërveprim të të gjitha llogarive të transaksioneve (domethënë midis llogarive rrjedhëse bankare dhe llogarive të parasë elektronike); (iii) përdorimin e tarifimit si nxitës për përdorimin e pagesave elektronike; dhe (iv) rishikimin/publikimin e rregullt të bazës së të dhënave të vetë BSH-së për tarifat e shërbimeve bankare, si instrument në duart e klientëve, për të krahasuar në mënyrë efektive produktet.

Megjithatë, në Shqipëri politikat për mbrojtjen e konsumatorit përfshirë sektorin financiar janë duke u përballur me sfida të reja ngushtësisht të lidhura me zhvillimet e kohëve të fundit, të tilla si: transformimi digjital, pasojat nga pandemia COVID-19 dhe së fundi impaktet nga ndryshimi klimaterik. Sfidë mbetet rregullimi i duhur lidhur me transformimin digjital në sektorin financiar dhe bankar për të siguruar konsumatorët dhe klientët përdorues të tyre se çdo produkt i ofruar nëpërmjet këtyre platformave kryhet në përputhje me disa standarde. Në kushtet e hartimit të një agjende të re për konsumatorët deri në vitin 2030, Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me institucione homologe ndërkombëtare do të vijojë me përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor dhe rregullativ për të garantuar interesat e konsumatorëve dhe rritur nivelin e mbrojtjes së tyre së klientëve të shërbimeve financiare dhe bankare.

Banka e Shqipërisë trajton me prioritet të veçantë ankesat e paraqitura në format letër ose *online* nëpërmjet adresës së *e-mail*-it (public@bankofalbania.org), të publikuar në faqen e saj të internetit nga individë dhe persona fizikë. Gjithashtu, nëpërmjet një rubrike të posaçme në faqen e internetit (https://www.bankofalbania.org/Mbikeqyrja/Trajtimi_i_ankesave/) janë dhënë udhëzimet e nevojshme për të paraqitur dhe trajtuar një ankesë nga Banka e Shqipërisë. Gjatë pesë viteve të fundit nga Banka e Shqipërisë janë trajtuar rastet si më poshtë:

Tabela nr. 11. Të dhëna mbi ankesat në fushën e shërbimeve bankare (BSH)

Viti	Numri i ankesave gjithsej	Zgjidhja e ankesës				Komente
		Zgjidhur nga institucioni*	Deleguar	Jashtë kompetencës	Tjetër	
2017	97	35	n/a	62	n/a	4 ankesa me <i>e-mail</i> nëpërmjet adresës së në faqen zyrtare të BSH
2018	109	30	n/a	79	n/a	15 ankesa me <i>e-mail</i> nëpërmjet adresës së në faqen zyrtare të BSH
2019	98	17	n/a	81	n/a	14 ankesa me <i>e-mail</i> nëpërmjet adresës së në faqen zyrtare të BSH
2020**	175	18	n/a	157	n/a	52 ankesa me <i>e-mail</i> nëpërmjet adresës së në faqen zyrtare të BSH
2021	158	22	n/a	136	n/a	62 ankesa me <i>e-mail</i> nëpërmjet adresës së në faqen zyrtare të BSH-së

** janë trajtuar rreth 350 kërkesa të qytetarëve (nëpërmjet adresës në web të Bankës së Shqipërisë), në kushtet e jashtëzakonshme të krijuara nga pandemia, lidhur me shqetësimet e tyre për riskedulimin e pagesave të kësteve të kredisë për të përfituar nga urdhri i përbashkët i nënshkruar nga Banka e Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë datë 17.3.2020, “Për shtyrjen e afatit të pagimit të kësteve të kredisë për biznese dhe individë”.

Autoriteti i Aviacionit Civil

Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC) nëpërmjet SDP-së (Sektori i të Drejtave të Pasagjerëve) monitoron në mënyrë të rregullt mbrojtjen e të drejtave të pasagjerëve që udhëtojnë nga ajri. Në mënyrë të veçantë, AAC-ja tregon kujdes dhe vëmendje për sensibilizimin e pasagjerëve për të drejtat e tyre, në rastet e vonesave apo anulimeve të fluturimeve nga operatorët ajrore, si dhe shlyerjes së detyrimeve që ata kanë për pasagjerët në mënyrë specifike.

Autoriteti zhvillon aktivitetin e tij monitorues për mbrojtjen e të drejtave të pasagjerëve në zbatim të kuadrit rregullator në fuqi. Vitet 2018–2019 shënojnë një periudhë të rëndësishme në ndjekjen e rasteve të ankimuara dhe komunikimeve me operatorët ajrore, kjo edhe për shkak të rritjes së konsiderueshme të fluturimeve gjatë vitit 2019. Viti 2019 numëroi 3.3 milionë pasagjerë drejt/nga Shqipëria.

Më tej, periudha 2020–2021 shënoi gati një mbyllje të fluturimeve në TIA për shkak të pandemisë së COVID-19. Ato pak fluturime të kryera kishin më shumë karakter riatdhesimi, ku vonesat dhe anulimet e linjave ishin të pakta dhe për pasojë rastet e ankimeve ishin të ulëta. Asistenca ndaj pasagjerit në të shumtën e rasteve gjatë kësaj periudhe ka konsistuar në drejtimin e pasagjerëve për të marrë informacionin e duhur nga kompanitë, orientimin për mënyrën e ankimimit dhe të drejtën e kompensimit për fluturimet e anuluar për shkak të pandemisë (kompensim me *voucher*/rezervim i një fluturimi alternativ etj.). Viti 2022 shënoi një vit rimëkëmbje për aviacionin civil në Shqipëri (si për mbarë aviacionin civil në botë). Ky vit kapi shifrën e 5.5 milionë pasagjerëve.

Autoriteti ka përpiluar strategjinë e Sektorit të Drejtave të Pasagjerëve deri në vitin 2025 me qëllim sigurimin e mbrojtje së të drejtave të pasagjerëve. Kjo strategji përbëhet nga një platformë e plotë hapash për ngritjen e një sistemi të plotë të të dhënave mbi ankesat e pasagjerëve dhe ndjekjen e tyre deri në zgjidhje ligjore; analiza, vlerësimi dhe menaxhimi i rrezikut; fushatë ndërgjegjësimi të pasagjerëve për të drejtat e tyre; monitorimin e performancës së linjave ajrore, krijimi dhe mirëmbajtja e databazave përkatëse për mbajtjen e të dhënave dhe përpunimin e tyre sipas nevojave, aktivitete për rritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve të stafit, fokus të veçantë ndaj pasagjerëve me aftësi ndryshe, si dhe planifikime për përdorimin e një sistemi soft për regjistrimin dhe ndjekjen e ankesave.

Për t’iu përgjigjur kërkesave dhe nevojave të pasagjerëve që udhëtojnë nëpërmjet ajrit në kohë dhe me cilësi, AAC-ja ka shtuar numrin e punonjësve të strukturës së saj të dedikuar për të drejtat e pasagjerëve me ristrukturimin e kryer sipas urdhrit nr. 3, datë 12.1.2023, të Kryeministrit, “Për organikën dhe strukturën e Autoritetit të Aviacionit Civil”. Ky staf është gjithmonë dhe do të vijojë të jetë pjesë e aktiviteteve trajnuese dhe zhvilluese në funksion të respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të pasagjerëve.

AAC-ja bashkëpunon me institucionet homologe për të shkëmbyer përvojat më të mira në fushën e mbrojtjes së të drejtave të pasagjerëve. Gjithashtu bashkëpunohet me Agjencinë e Mbrojtjes së Konsumatorëve Bashkia Tiranë për rastet e ankesave të deleguara nga kjo agjenci.

Problematikat më të shpeshta në lidhje me përmbushjen e funksionit të AAC-së dhe Sektorit të të Drejtave të Pasagjerit kanë të bëjnë me ndërmjetësimin me kompanitë ajrore (vendëse dhe të huaja), mbi problematikat në rast të shkeljes së të drejtave të pasagjerëve, në mënyrë që kompanitë të dëmshpërblejnë dhe kompesojnë konsumatorët konform legjislacionit në fuqi.

Pavarësisht problematikave të hasura, me rritjen e bashkëpunimit të AAC-së me operatorët ajrorë dhe duke edukuar dhe bërë pjesë aktive pasagjerët për zgjidhjen e ankesave të tyre, konstatohet një përmirësim i dukshëm i përqasjes së të gjithë aktorëve në mbrojtjen e të drejtave të pasagjerëve.

Mbrojtja e së drejtës së pasagjerëve dhe shqyrtim i ankesave të pasagjerëve ndaj operatorëve ajrorë vendës dhe të huaj, është realizuar nëpërmjet disa hapave, të cilët konsistojnë në informimin/ndërgjegjësimin e pasagjerëve nëpërmjet mjeteve të informimit të shkruar në media sociale, në faqen zyrtare të AAC-së, e cila përmban seksion të dedikuar për të gjithë hapat që duhet të ndjekin pasagjerët në rast të cenimit të të drejtave të tyre, informacion mbi përgjigjet për pyetjet më të shpeshta, si dhe informacion të posaçëm për pasagjerët invalidë apo personat me aftësi të kufizuara etj.), si dhe komunikimit verbal (inspektimeve dhe kontakteve direkte të specialistëve të SDP me pasagjerët në aeroport).

Nga ana tjetër, shqyrtimi i ankesave të pasagjerëve sjell një informacion të vlefshëm edhe për vlerësimin e performancës dhe cilësinë e shërbimit të veprimtarisë së operatorëve ajrorë dhe evidentimin e problematikave të subjekteve. Kjo i jep mundësinë Autoritetit të ndërhyjë në kohë për të zgjidhur çështje konkrete dhe marrjen e masave të nevojshme për të shmangur përsëritjen e problematikave në të ardhmen.

Rritja e numrit të pasagjerëve që udhëtojnë nëpërmjet ajrit vit pas viti, ka sjellë, gjithashtu, rritje të numrit të pasagjerëve me aftësi ndryshe, për të cilët në bazë të rregullores përkatëse po zbatohen të gjitha detyrimet ligjore që rrjedhin për transportuesit ajrorë, entin menaxhues të aeroportit. AAC-ja, përveçse po monitoron këto zbatime, po jep edhe konsulencë dhe asistencë teknike për përmirësime në ofrimin e shërbimeve këtij targeti.

2.2 Kuadri ligjor mbi çështjet e mbrojtjes së konsumatorëve që nuk lidhen me aspektet e sigurisë

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit

Në lidhje me aspektet që nuk lidhen me sigurinë, për çështjet e mbrojtjes së interesave ekonomike dhe të drejtave të tjera të konsumatorëve, vepron legjislacioni, respektivisht sipas fushave, si vijon:

Ligji nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar¹¹ së bashku me aktet nënligjore, kanë krijuar një bazë të fortë në mbrojtje të të drejtave të konsumatorëve përkundrejt praktikave të padrejta tregtare, kushteve të padrejta në kontrata, të drejtave të konsumatorit në kontratat në largësi, mungesën e transparencës për informim etj., me të cilat konsumatorët ndeshen vazhdimisht në treg. Ky kuadër ligjor ka karakter horizontal zbatohet mbi të gjitha llojet e marrëdhënieve ndërmjet tregtarëve dhe konsumatorëve e që kanë të bëjnë me mallrat apo shërbimet e konsumatorëve, me përjashtim kur fusha të veçanta kanë legjislacionin e tyre specifik.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Ligji nr. 93/2015, “Për turizmin” e prek çështjen e mbrojtjes së konsumatorit (turistit) sa i takon hartimit të paketave të udhëtimit duke përcaktuar ndër të tjera, detyrimin për zbatimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e konsumatorit.

Konkretisht, nenet 54 dhe 55 të ligjit nr. 93/2015 “Për turizmin” përcaktojnë të dhënat bazë që duhet të përmbajë kontrata mes konsumatorit/turistit dhe operatorit turistik apo agjencisë së udhëtimit, si dhe garancitë e operatorit turistik me qëllim mbrojtjen e konsumatorit në situatën e mospërmbytjes së detyrimeve si rezultat i falimentimit dhe paaftësisë paguese.

Gjithashtu, nenet 15, 16 dhe 17 të ligjit “Për turizmin” përcaktojnë kompetencat dhe detyrat e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe Inspektoratit të Turizmit (aktualisht i përfshirë nën strukturën e AKB-së) si struktura përgjegjëse për garantimin e zbatimit të legjislacionit të turizmit

¹¹ Ky ligj është botuar në FZ nr. 61/2008 dhe është i ndryshuar me:

- Ligjin nr. 10444, datë 14.7.2011, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9902, datë 17.4.2008, ‘Për mbrojtjen e konsumatorëve’”,

- Ligjin nr. 15/2013, datë 14.2.2013, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 9902, datë 17.4.2008, ‘Për mbrojtjen e konsumatorëve’”, të ndryshuar. FZ nr. 29/2013.

- Ligjin nr. 71/2018, datë 18.10.2018, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9902, datë 17.4.2008, ‘Për mbrojtjen e konsumatorëve’”, të ndryshuar.

gjatë ushtrimit të veprimtarive turistike nga subjektet private dhe shqyrtimin e ankesave të ardhura nga konsumatorët dhe ndjekjen e tyre.

Enti Rregullator i Energjisë

Ligjet bazë mbi të cilat mbështetet veprimtaria e ERE-s, janë:

- Ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 7/2017, “Për përdorimin e energjisë nga burimet e rinovueshme”.

Në zbatim të ligjeve të mësipërme, në cilësinë e institucionit përgjegjës për miratimin e kuadrit rregullator, ERE ka miratuar një sërë aktesh rregullatore me impakt të drejtpërdrejtë në adresimin e të drejtave të konsumatorit, tutelimin e këtyre të drejtave, por edhe garantimin e një shërbimi më cilësi të konsumatorit sa i përket këtij malli kaq të rëndësishëm siç është energjia elektrike¹².

Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura

Fusha e shërbimeve të ujësjellës-kanalizime rregullohet nga kuadri i mëposhtëm ligjor:

- Strategjia Kombëtare e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, 2020–2030;
- Enti Rregullator i Ujit është krijuar dhe funksionon në bazë të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit dhe Përpunimit të Ujërave të Ndotura”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 11/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”.

Institucioni përgjegjës në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare

Fusha e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe postare rregullohet nga kuadri i mëposhtëm ligjor:

Ligji nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Ndryshimi kryesor ligjor në vitin 2012 për sa i përket mbrojtjes së konsumatorit ishte përfshirja në kompetencën e AKEP-it e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve midis pajtimtarëve dhe sipërmarrëseve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike.

Ligji nr. 9918/2008 është i përafëruar me kuadrin rregullator të BE-së për komunikimet elektronike të vitit 2002 (direktiva 2002/19/EC, 2002/20/EC, 2002/21/EC dhe 2002/22/EC) të amenduara në vitin 2009.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka iniciuar projektligjin “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i cili synon transpozimin e direktivës (EU) 2018/1972 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit “Për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike” (në vijim “EECC”). Projektligji i ri i komunikimeve elektronike pritet të miratohet.

Transpozimi i EECC-së nëpërmjet projektligjit pritet të sjellë një sërë përmirësimesh në drejtim të mbrojtjes së konsumatorëve/përdoruesve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike, të tilla si:

- Përcaktime më të qarta për përmbajtjen e kontratave të pajtimit në lidhje me kohëzgjatjen, rinovimin dhe përfundimin e kontratës, ofrimin e përmbledhjes së kontratës, informacionin për cilësinë e shërbimit dhe tarifën etj.;

- Masa për të përmirësuar transparencën, krahasimin e ofertave/tarifave dhe publikimin e informacionit nga operatorët;

- Masa për të garantuar cilësinë e shërbimit të aksesit në internet, përfshirë një kapitull të veçantë për transpozimin e rregullores 2015/2120 të BE-së për aksesin e hapur në internet (masa për transparencë për shpejtësinë e internetit);

- Të drejta të konsumatorëve/pajtimtarëve për kompensim dhe/ose për të përfunduar kontratën në ofrimin e shërbimit jo në përputhje me treguesit e cilësisë së përfshirë në kontratë;

Ligji nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”.

¹² https://www.ere.gov.al/images/archive/Ligj_43_2015_30_04_2015.pdf

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

Fusha e shërbimeve financiare rregullohet nga kuadri ligjor si më poshtë:

- Ligji nr. 9572, datë 3.7.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar¹³;
- Ligji nr. 52, datë 22.5.2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”;
- Ligji nr. 32/2021, datë 16.3.2021, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”;
- Ligji nr. 66/2020, datë 21.5.2020, “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”;
- Ligji nr. 62/2020, datë 14.5.2020, “Për tregjet e kapitalit”;
- Ligji nr. 10158, datë 15.10.2009, “Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore”;
- Ligji nr. 9879, datë 21.2.2008, “Për titujt”;
- Ligji nr. 10197, datë 10.12.2009, “Për fondet e pensionit vullnetar”;
- Ligji nr. 56/2020, datë 30.4.2020, “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.

Banka e Shqipërisë

Banka e Shqipërisë mbron dhe promovon interesat e konsumatorëve bazuar në një kuadër ligjor dhe rregullativ të përshtatshëm:

- Ligji nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 55/2020, “Për shërbimet e pagesave”,

si dhe në aktet nënligjore të publikuara në faqen në internet të Bankës së Shqipërisë¹⁴.

Autoriteti i Aviacionit Civil

Në fushën e aviacionit civil, kuadri i mëposhtëm ligjor rregullon shërbimet në këtë fushë:

- Ligji nr. 96/2020, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”;
- Udhëzimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 1, datë 26.2.2013, “Për kompensimin dhe asistencën e pasagjerëve në rastin e mospranimit në bord të avionit dhe anulimit ose vonësës gjatë fluturimeve”, që transpozon rregulloren evropiane (CE) 261/2004;
- Udhëzim i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 329 datë 22.12.2014, “Të drejtat e invalidëve dhe personave me aftësi të kufizuara lëvizëse kur udhëtojnë nëpërmjet ajrit”;
- Udhëzim i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 85, datë 9.9.2011, “Për përgjegjësinë e transportuesve ajror në lidhje me pasagjerët që udhëtojnë nga ajri dhe bagazhet e tyre”.

1.3 Shtylla III: Informimi dhe ndërgjegjësimi

3.1. Aktivitet ndërgjegjësuë

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit

Ndërgjegjësimi dhe informimi i operatorëve ekonomikë që ofrojnë produkte joushqimore, përmes zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme informuese e ndërgjegjësuëse ka qenë pjesë e rëndësishme e punës së institucioneve që kanë në fushën e përgjegjësisë hartimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës në fushën e produkteve joushqimore. Këto aktivitete kanë pasur në thelb njohjen e operatorëve ekonomikë dhe konsumatorëve me detyrimet/të drejtat përkatëse dhe parashikimet e legjislacionit që i mundësojnë mbrojtjen e këtyre të drejtave në transaksionet e blerjes së mallrave dhe shërbimeve.

Ndërgjegjësimi i konsumatorëve, i subjekteve tregtare apo operatorëve ekonomikë, nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të ndryshme informuese e ndërgjegjësuëse ka zënë një vend të rëndësishëm në punën e institucioneve shtetërore, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë. Ky aspekt është ngushtësisht i lidhur me edukimin e konsumatorëve, aktivitetet e informimit, përfshirjen aktive të organizatave të konsumatorëve në hartimin dhe zbatimin e politikave në mbrojtje të konsumatorëve, përfshirjen e tyre aktive në proceset integruëse duke rritur më tej rolin e tyre të rëndësishëm.

¹³ Ndryshuar me Ligjin nr. 54/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”

¹⁴ https://www.bankofalbania.org/Mbikëqyrja/Kuadri_Rregullativ_Mbikëqyrjes/Rregullore_te_mbikëqyrjes/

Përgjatë periudhës 2017 - 2021 janë zhvilluar 8 fushata ndërgjegjësuese për konsumatorë e biznese. Këto fushata janë zhvilluar kryesisht në periudhën e fundvitit, si dhe me rastin e 15 Marsit – Ditës Ndërkombëtare të Konsumatorëve, në bashkëpunim me organizatat e konsumatorëve dhe aktorë të tjerë, nëpërmjet disa aktivitete kryesore, si në vijim:

- 3 sondazhe/anketime me konsumatorët lidhur me perceptimin e tyre për produktet dhe shërbimet e ofruara në treg, legjislacionin që vepron për sigurinë e produkteve dhe të mbrojtjes së konsumatorëve etj. Anketimet janë kryer në bashkëpunim me organizatat e konsumatorëve, Agjencinë për Mbrojtjen e Konsumatorit, Bashkia Tiranë, staf akademik të universiteteve. Rezultatet e anketimeve janë shoqëruar me rekomandime të cilat janë bërë prezente në aktivitetet e ndryshme ndërgjegjësuese.

- Organizimi i 12 tryezave informuese për konsumatorët dhe për operatorët, duke kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit dhe përmirësimit të njohurive të konsumatorëve mbi të drejtat e tyre, si dhe të operatorëve mbi detyrimet që ata kanë. Këto tryeza kanë qenë pjesë e procesit të hartimit të akteve të reja ligjore duke shërbyer kështu edhe për përmbushjen e objektivave të lidhur me këtë proces, fuqizimit të kompetenca të strukturave shtetërore etj.

- Realizimi i 10 takimeve me përfaqësuesit e 61 bashkive të vendit, me qëllim përfshirjen e njësive të qeverisjes vendore në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve në nivel vendor. Nëpërmjet këtyre takimeve u synua ndërgjegjësimi i tyre, trajnimet e nëpunësve të bashkisë në lidhje me ndryshimet e ligjit “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, për sa i takon delegimit të disa kompetencave të pushtetit vendor kryesisht për informimin, ndërgjegjësimin, procesin e ankimit etj.

- Përgatitja e materialeve informuese si: fletëpalosje, broshura, spote publicitare, intervista në media televizive, përditësimi i përmbajtjes së faqes së internetit etj. Në total janë përgatitur dhe shpërndarë rreth 10,000 fletëpalosje e broshura informuese. Përmbajtja e tyre konsiston në dhënien e informacionit në lidhje me të drejtat e konsumatorëve si: e drejta për të hequr dorë brenda 14 ditëve kalendarike nga kontrata e kredisë konsumatore, kontratat në largësi apo nga shitja jashtë qendrave të tregtimit, si dhe në lidhje me të drejtat e tyre në kontratat e shitjes së mallrave konsumatore, praktikat e padrejta tregtare etj. Fletëpalosjet janë shpërndarë në aktivitete të konsumatorëve, si dhe në qendrat e biznesit apo vende të tjera të arritshme nga konsumatorët, si dhe dërguara në të gjitha bashkitë, nëpërmjet Postës Shqiptare.

- Në fushën e sigurisë së produkteve joushqimore, ndërgjegjësimi i konsumatorëve dhe operatorëve ka konsistuar në përgatitjen dhe shpërndarjen e fletëpalosjeve informative për biçikletat e fëmijëve, lodrat, detergjentet, ashensorët, si dhe janë organizuar 2 aktivitete në kuadër të 1 Qershorit, festës së fëmijëve, në bashkëpunim me ISHMT-në për zbatimin e legjislacionit mbi lodrat dhe me organizatat e konsumatorëve.

- Nga shtatori 2015 faqja e internetit të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve <http://kmk.financa.gov.al/> është aktive dhe e përditësuar. Faqja është përmirësuar në vitin 2020, duke mundësuar një prezantim më të mirë të informacionit për konsumatorët, lehtësim të paraqitjes së ankesave të tyre, publikimit të vendimeve të KMK-së, materialeve informuese, spoteve publicitare etj. Këto materiale gjenden të publikuara sipas rubrikave që përmban faqja.

- Mbrojtja e konsumatorëve gjatë situatës së emergjencës së krijuar në vend nga virusi.

COVID-19 ka qenë një ndër sfidat kryesore të kësaj periudhe. Situata e pandemisë u shoqërua me një rritje të dukshme të blerjeve *online* nga ana e konsumatorëve. Kjo solli domosdoshmërinë e ndërgjegjësimit për çështjen e të drejtave të konsumatorëve në këtë fushë. Në këtë kontekst, u publikuan në faqen *web* të KMK-së, informacioni i duhur në lidhje me të drejtat e konsumatorëve dhe detyrimet e tregtarëve në kontratat në largësi dhe jashtë qendrave të tregtimit, në përputhje me dispozitat e legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorëve.

- Gjithashtu, ministria përgjegjëse për ekonominë në bashkëpunim me studentë të Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës ndërmorën iniciativën për të bërë monitorimin e *website*-ve zyrtare apo/dhe faqeve të rrjeteve sociale të subjekteve, që ofrojnë produkte dhe shërbime në largësi, në zbatim të legjislacionit shqiptar për sa i takon kësaj mënyre tregtimi. Ky monitorim pati

për qëllim përmirësimit të transparencës së informacionit, që iu ofrohet konsumatorëve, duke kontribuar kështu në rritjen e nivelit të mbrojtjes së të drejtave të tyre, veçanërisht të interesave të tyre ekonomike, si dhe në funksionimin më të mirë të tregut. Raporti përkatës mbi gjetjet dhe rekomandimet u publikua në faqen e KMK-së (<http://kmk.financa.gov.al/publikimet/>)

Zhvillimi i fushatave ndërgjegjëse ka pasur edhe mbështetjen e projekteve, si: GIZ me Qeverinë Gjermane, IPA 2014 i Binjakëzimit me Lituaninë.

Sfidë për të ardhmen vazhdon të jetë edukimi i mëtijshëm i konsumatorëve dhe biznesit përmes aktiviteteve ndërgjegjëse apo informuese, mbi të drejtat e tij dhe parashikimet e legjislacionit që i mundësojnë mbrojtjen e këtyre të drejtave në transaksionet e blerjes së mallrave dhe shërbimeve, sidomos në tregun në largësi/*online*, nëpërmjet mjeteve digjitale në përdorim nga konsumatorët.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të publikut dhe grupeve të interesit mbi efektet negative që vijnë nga ekspozimi ndaj plumbit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit iu bashkua fushatës ndërgjegjëse që u zhvillua në vend, në datat 25–29 tetor 2021, në kuadër të Javës Ndërkombëtare të Parandalimit të Helmimit nga Plumbi. MTM, dha mesazhin e saj mbi ndikimin që ka plumbi në mjedis, nëpërmjet një videomesazhi, që u përgatit nga shoqata mjedisore Qendra “EDEN”.

Në kuadër të informimit të konsumatorëve dhe publikut prej vitit 2021 realizohet publikimi i informacionit të nevojshëm në lidhje me kimikatat nëpërmjet *website*-t zyrtar (<https://akm.gov.al/kimikatat>). Rubrika e dedikuar për kimikatat, përmban informacion të përditësuar mbi legjislacionin në fuqi për kimikatat, pesticidet dhe biocidet, informacione të dhëna për pesticidet, në tokë, ajër, ujë, si dhe udhëzime për përdorimin e sigurt të tyre me qëllim mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit. Zyra e Kimikateve, ndër të tjera, ka për përgjegjësi ofrimin e shërbimit të informacionit (*helpdesk*) për të këshilluar prodhuesit, importuesit, përdoruesit e tjerë dhe çdo palë tjetër të interesuar për përgjegjësitë dhe detyrimet e tyre përkatëse në bazë të këtij ligji Palët e interesuara, mund t'i drejtohen Zyrës së Kimikateve, nëpërmjet adresës së *e-mail*-it info.kimikatat@akm.gov.al.

Me mbështetjen e Agjencisë Evropiane të Kimikateve (ECHA), MTM/Zyra e kimikateve do të mbështetet për zhvillimin e një plani komunikimi në fushën e kimikateve për të rritur nivelin e informimit të konsumatorëve.

Akreditimi

DPA-ja është përpjekur të promovojë në mënyrë të vazhdueshme rolin, avantazhet dhe përfitimet nga akreditimi të të gjithë aktorët. Si rezultat i tërmetit dhe pandemisë, numri i aplikimeve për akreditim nuk ka qenë proporcional me kërkesat e tregut. Numri i produkteve/shërbimeve në treg është shumë i madh dhe kërkesa për mbrojtjen e konsumatorëve është shumë e madhe.

Sfida e DPA-së është promovimi sistematik dhe i programuar i rolit të akreditimit në mbrojtjen e konsumatorëve dhe në tregtinë e lirë. Përveç promovimit të akreditimit të biznesi në të gjithë vendin, organet e vlerësimit të konformitetit, studentët që studiojnë në universitete të ndryshme, DPA-ja do të bashkëpunojë ngushtë me rregullatorët. Përfshirja e kërkesës për organe të vlerësimit të konformitetit të akredituara në legjislacionin vendës në përputhje me atë evropian në shumë fusha do të sjellë rritjen e numrit të aplikimeve për akreditim. Në të njëjtën kohë, DPA-ja do të zgjerojë edhe fushën e aktivitetit të saj në përputhje me nevojat e legjislacionit dhe politikave të rregullatorëve.

Metrologjia

Në fushën e metrologjisë janë bërë përpjekje të vazhdueshme për të rritur vizibilitetin institucional. Në Drejtorinë e Burimeve Mbështetëse ushtron detyrat Sektori Juridik, Integritet dhe Komunikimit, ku një punonjës është përgjegjës për aktivitetet e komunikimit. Struktura ka një faqe interneti www.dpm.gov.al për veprimtarinë institucionale. Gjatë periudhës 2017–2021 janë organizuar disa seminare, konferenca dhe ditë të hapura për industrinë (Dita Botërore e Metrologjisë 20 maj). Në Tiranë dhe në sektorët e shërbimit janë organizuar aktivitete

sensibilizuese në fushën e mbrojtjes së konsumatorit. Janë publikuar materiale promovuese, raportet vjetore të DPM-së, si dhe buletini zyrtar “Metrologjia”. Bashkëpunimi me median ka qenë i vazhdueshëm dhe i përqendruar në pjesëmarrjen në programe të veçanta televizive dhe organizimin e eventeve me prezencë mediatike.

Institucioni gjatë vitit të fundit ka ndërmarrë disa fushata ndërgjegjëse duke iu drejtuar konsumatorëve, studentëve, operatorëve ekonomikë. Në kuadër të këtyre fushatave janë zhvilluar:

- Konferenca “Rëndësia e Infrastrukturës së Cilësisë dhe Pronësisë Industriale në Tregun e Brendshëm dhe Ndërkombëtar” në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për ekonominë dhe institucionet e infrastrukturës së cilësisë;

- Takime në disa prej qyteteve kryesore të vendit (Korçë, Gjirokastrë etj.), me mbështetjen e Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë të këtyre qyteteve, ku dhe janë shpërndarë materiale informuese për biznesin dhe fletëpalosje për studentët e fakulteteve në këto qytete.

Sesion informimi për operatorët ekonomikë mbi rregulloret teknike “Parapaketimet dhe shishet enëmatëse”, aktivitet në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për ekonominë, ISHMT-në, GIZ-in.

Në fushën e metrologjisë në kuadër të digjitalizimit të procedurave dhe përmirësimit të shërbimeve meteorologjike është punuar për evidentimin e gjithë shërbimeve që kryhen. Për këtë qëllim janë përgatitur kartelat shoqëruese të shërbimeve në platformën ADISA dhe regjistrimi i tyre në portalin *e-Albania*. Gjithashtu në kuadër të nenit 51 të ligjit nr. 126/2020 “Për metrologjinë” dhe VKM nr. 217, datë 13.4.2022, “Për krijimin, administrimin dhe përdorimin e bazës së të dhënave të regjistrat elektronik të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë”, institucioni do të ketë regjistrin elektronik të tij, i cili do ofrojë informacione në lidhje me instrumentet matëse për konsumatorët, institucionet publike dhe operatorët ekonomikë.

- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit

Edukimi dhe ndërgjegjësimi i konsumatorëve dhe operatorëve të biznesit është pa dyshim një nga elementet që kontribuojnë në rritjen e sigurisë ushqimore, si dhe rritjen e transparencës së praktikave tregtare.

AKU-ja, me qëllim kryesor garantimin e sigurisë ushqimore dhe informimin në kohë reale me informacione që lidhen me shëndetin e konsumatorit konsiderohet si një ndër institucionet me prezencë të lartë të daljeve në media audiovizive ku mesatarisht në vit numërohen rreth 50 dalje në qendër e qarqe për shkak edhe të ndjeshmërisë së lartë të sigurisë ushqimore. Gjithashtu, përpos daljes në media audiovizive, AKU-ja nëpërmjet fushatës digjitale të sigurisë ushqimore, si dhe bashkëpunimit me Projektin për Sigurinë Ushqimore ka pasur 2-fishim të numrit të denoncimeve/kërkesave për informacion/ndërgjegjësim, si dhe 4.5 milionë *reaches* nga 600 mijë që ka pasur më herët.

AKU-ja, në bashkëpunim me Projektin për Sigurinë Ushqimore, ka realizuar gjatë viteve 2020–2022:

Broshura informuese për konsumatorët:

- Ushqim i sigurt në lëvizje;
- Trajtimi dhe shërbimi i sigurt i akullores;
- Informacion mbi etiketimin e produkteve ushqimore;
- Deklarata e vlerave ushqimore dhe shëndetësore;
- Broshura për fëmijët mbi etiketimin e produkteve ushqimore;
- Ngjyros me Bakun – mëso duke u zbavitur.

Udhëzues:

- Udhëzues për sigurinë ushqimore niveli 1&2;
- Udhëzues për sigurinë ushqimore niveli 3.

Poster:

- Etiketimi i produkteve ushqimore;
- Poster informuese mbi murtajën afrikane të derrit.

Video:

- Mëso të lexosh ushqimin tënd!
- *Avian influenza* – Gripi i shpendëve.

Fletëpalosje:

- fletëpalosje informuese për konsumatorët;
- fletëpalosje informuese për bizneset ushqimore.

Të gjitha materialet informuese dhe ndërgjegjësuere janë të publikuara në *web* zyrtar, i cili është një format bashkëkohor njehsuar me *web-site* më të avancuar evropiane për sigurinë ushqimore. *web* përditësohet në mënyrë të vazhdueshme me të gjitha informacionet e duhura për konsumatorin dhe biznesin duke nisur nga lajmet e fundit; raportet javore mbi inpektimet e AKU-së, njoftimet, inspektimet e kryera në rang vendi nga Task-Forca Ndërinstitucionale gjatë sezoneve turistike veror etj. (<https://aku.gov.al/publikime1/>)

Sfide për AKU-në mbetet bashkëpunimi me konsumatorët duke nisur nga mosha më e vogël deri të më i vjetri në mënyrë që të denoncojnë çdo subjekt që cenon sigurinë ushqimore, si dhe ndërgjegjësimi i çdo OBU për zbatimin e kërkesave ligjore nëpërmjet këshillimit të vazhdueshëm dhe organizimit të trajnimeve me tematika specifike që lidhen kryesisht në fushën e implementimit të sistemit të vetëkontrollit (HACCP), si dhe sistemit të gjurmueshmërisë Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut.

Janë informuar në mënyrë të vazhdueshme operatorët ekonomikë mbi kriteret ligjore që duhet të plotësojnë për të ofruar produkte e pajisje/instalime të sigurt për konsumatorin. Gjatë vitit 2019 janë realizuar 5 takime për informimin e operatorëve ekonomikë, disa emisione televizive, botimi dhe shpërndarja e 1 fletëpalosje (tirazhi 1000 copë) dhe 1 poster (tirazhi 150 copë) me fokus sigurinë e ashensorëve, lodrave, instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara, LVD etj. Në vitin 2020 janë realizuar 5 takime me operatorët ekonomikë, në 2021 janë realizuar 7 aktivitete informuese e sensibilizuese për operatorët ekonomike dhe në vitin 2022 janë realizuar 4 aktivitete informuese (LVD, parapaketimi dhe shishet enëmatëse, mbrojtja e konsumatorit për nenin 8 të LMK dhe kontrata e shitjes konsumatore).

Në kuadrin e projekteve të ndryshme të mbështetura nga GIZ, Projekte IPA janë realizuar botime të fletëpalosjeve/broshurave informative për operatorët ekonomikë në lidhje me: sigurinë e ashensorëve, lodrave, LVD, parapaketimi, instrumentet matëse ligjërisht të kontrolluara, detergjentet, kimikatet etj., të cilët janë publikuar edhe në *website*-in e ISHMT-së www.ishmt.gov.al. Në mënyrë të vazhdueshme është përditësuar informacioni për sigurinë e produkteve dhe kriteret që duhet të plotësojnë konform legjislacionit shqiptar të harmonizuar me atë të BE-së në *web-site* e ISHMT-së dhe në rrjetet sociale.

Enti Rregullator i Energjisë

Inovacioni dhe zhvillimi teknologjik (nga të cilat digjitalizimi përfaqëson një ndër elementet kyç) përbëjnë faktorë të rëndësishëm të evolucionit, i lidhur ngushtë me benefitet që vijnë nga përdorimi i teknologjisë, por i shoqëruar paralelisht edhe me rrezikun e mundshëm të kostove ekstra të krijuara nga ky përdorim teknologjie, çka kërkon vëmendje të vazhdueshme ndaj kostove të shërbimeve.

Në aspektin e kuadrit rregullator, ERE është angazhuar për të konsoliduar koherencën e mekanizmave rregullatorë në aktivitete të ndryshme të fushës së përgjegjësisë së tij. Brenda këtij kuadri, konsumatori merr një rol vendimtar e në rritje. Në këtë kontekst, ndërgjegjësimi i konsumatorit për t'u bërë klient i aftë në vlerësimin e ofertave, kuptimin e drejtë të mekanizmave të tregut, deri në mundësinë për të marrë pjesë në mënyrë aktive në shërbimet e lidhura me furnizimin, siç është rasti i vetëprodhuesve që prodhojnë dhe konsumojnë vetë energji, merr një rëndësi të veçantë. Nëpërmjet seancave dëgjimore ERE është investuar me qëllim përfshirjen e përfaqësuesve të konsumatorit në cilësinë e palës së interesit me qëllim dhënien zë këtyre të fundit në hartimin e politikave rregullatore që adresojnë çështje të konsumatorit siç janë rregulloret e miratuara në zbatim të ligjeve në fuqi.

Viti 2020, falë edhe rrethanave në të cilat u vendos mbarë bota për shkak të pandemisë, bëri që ERE të fokusohet me shumë drejt metodave alternative të komunikimit me konsumatorin

nëpërmjet mjeteve të komunikimit *online*. Kështu për këtë qëllim, janë përgatitur broshura informative të cilat adresojnë çështjet me ndjeshmëri më të lartë për konsumatorin, si kushtet e lidhjes, pezullimit apo ndërprerjes së një kontrate furnizimi, e drejta për të zgjedhur apo ndryshuar furnizuesin, kushtet për sigurimin e një lidhje me rrjetin e shpërndarjes, standardet e cilësisë së shërbimit, e drejta për t'u ankuar etj. Broshurat e sipërcituara gjenden të publikuara në ambientet e ERE-s, por edhe në faqen zyrtare apo rrjetet sociale të ERE, me qëllim arritjen në një numër sa më të madh konsumatorësh të informacionit të nevojshëm.

Gjatë vitit 2021, ERE është angazhuar në realizimin e një rubrike të dedikuar informimit të konsumatorit publikuar në faqen e ERE (<https://ere.gov.al/sq>) nën zërin Shërbime Konsumatori. Rubrika jep një informacion të detajuar për konsumatorin dhe vendos në dispozicion të tij legjislacionin në fuqi dhe mekanizmat e ankesës që konsumatori disponon. Për të marrë një vlerësim më të mirë të punës që kryen apo mund të përmirësojë në shërbimet e saj, ERE ka organizuar dhe një anketë mbi nivelin e kënaqësisë së konsumatorit.

Enti Rregullator i Ujit

Mbrojtja e konsumatorit ka të bëjë me krijimin e një ambienti të sigurt, rrjedhimisht të një garancie shoqërore, se përdorimi i ujit nga rrjeti është i sigurt. Rregullimi i kësaj fushe mbështetet në tri shtylla kryesore që janë: - shëndeti i konsumatorit, - siguria e konsumatorit, - mbrojtja e të drejtave të konsumatorit. Një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit ka edhe zëri i shoqatave të konsumatorëve, si dhe informimi, edukimi dhe ngritja e vet ndërgjegjësimi të konsumatorëve përmes mekanizmave të ndryshëm.

Ndërgjegjësimi i konsumatorëve që të jenë të kujdesshëm mbi mënyrën se si e përdorin ujin e pijshëm, të mos e shpërdorojnë atë, të mos ndërtojnë objekte mbi sistemet e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve, të mos instalojnë lidhje të tjera jashtë sistemit të furnizimit me ujë, të njoftojnë dhe bashkëpunojnë me shoqërinë UK në rastet e rrjedhjeve apo çarjeve të tubacioneve.

Autoriteti i Aviacionit Civil

Ndërgjegjësimi i pasagjerëve për të drejtat e tyre kur udhëtojnë nëpërmjet ajrit, është i rëndësishëm e për të kryer këtë me format dhe mënyrat që sigurojnë rezultatin, AAC-ja realizoi syrvey për të matur nivelin e njohjes që qytetarët kishin mbi këto të drejta. Në varësi të tyre, u planifikuan aktivitete sensibilizuese, brenda objektivit kryesor të Strategjisë së Sektorit për të Drejtat e Pasagjerëve për periudhën deri në vitin 2025 me qëllim mbrojtjen e të drejtave të pasagjerëve. AAC-ja vlerëson dhe ofron ndërgjegjësim për pasagjerët jo vetëm për të drejtat, por edhe detyrimet e tyre.

Kështu, për të rritur ndërgjegjësimin për këto të drejta, AAC-ja publikon informacion mbi to në faqen zyrtare të saj, përgatit dhe shpërndan materiale sensibilizuese, bën interpretim të bazës rregullatore për të drejtën që pasagjeri kërkon në komunikimin me *email* apo drejtpërdrejt me stafin për të drejtat e pasagjerëve, informacionit të dedikuar për pasagjerët me aftësi ndryshe, publikimi i mesazheve dhe informacioneve në media sociale mbi të drejtat, si dhe mbi detyrimet që lindin për shkak të zbatimit të programeve apo politikave të reja, të përkohshme apo të përhershme të shtetit.

KAPITULLI II

VIZIONI, POLITIKAT, QËLLIMET E POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT

Vizioni i strategjisë

Vizioni i strategjisë është: “Konsumatorë të mbrojtur, të fuqizuar dhe me besim në një treg të drejtë, të sigurt, ku ata ushtrojnë të drejtat e tyre, si dhe luajnë një rol aktiv në transformimin digjital dhe në mbrojtjen e mjedisit.”

Qëllimet e politikave

Qëllim i strategjisë është: “Garantimi i funksionimit efektiv të një tregu konkurrues, ku mbrojtja dhe fuqizimi i konsumatorëve, si dhe i operatorëve ekonomikë, sigurohet nëpërmjet përmirësimit dhe zbatimit të kuadrit ligjor, vendosjes së standardeve në çdo fushë, respektimit të parimeve të

zhvillimit të qëndrueshëm, edukimit të konsumatorëve e përfaqësuesve të shoqërisë civile në veçanti, bizneseve, në lidhje me të drejtat e konsumatorëve, si dhe rritjes së bashkëpunimit ndërmjet strukturave kompetente dhe aktorëve të tjerë kryesorë.”

Në përputhje me shtyllën I të strategjisë ndërsektoriale për mbrojtjen e konsumatorëve dhe mbikëqyrjen e tregut, qëllimi i politikës 1 lidhet me: përmirësimin e sigurisë së produkteve për konsumatorë mbështetur në një infrastrukturë efektive të cilësisë sipas praktikave më të mira evropiane.

Çështja e sigurisë së konsumatorëve përbën një nga shtyllat e strategjisë, që materializohet në një spektër të gjerë, referuar këtu si sigurisë ushqimore, ashtu edhe sigurisë së produkteve joushqimore, fushave të tilla si: barnat për përdorim njerëzor; kozmetika; fusha e infrastrukturës së cilësisë; apo aspekteve që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e tregut. Angazhimet në lidhje me çështjet e sigurisë janë në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga nenet 70 dhe 76 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, si dhe të dispozitave përkatëse të *acquis* së BE-së. Detyrimi për të përafuar ligjin shqiptar me atë të Bashkimit Evropian buron nga neni 70 i MSA-së dhe Kriteret e Kopenhagës. Më konkretisht, ky qëllim i politikës lidhet ngushtësisht edhe me kapitujt 1 “Lëvizja e Lirë e mallrave” dhe 28 “Mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit publik” të *acquis* të BE-së. Garantimi i përputhshmërisë me politikat evropiane në fushën e sigurisë i shërben qëllimit të përgjithshëm të strategjisë për mbrojtjen dhe fuqizimin e konsumatorëve, si dhe operatorëve ekonomikë, nëpërmjet përmirësimit dhe zbatimit të kuadrit ligjor, vendosjes së standardeve në çdo fushë.

Objektivat, masat dhe indikatorët sipas fushave

II.1 Shtylla I: Siguria e produkteve ushqimore dhe e produkteve joushqimore

Objektivi i përgjithshëm:

Vendosja në treg vetëm e produkteve të sigurta dhe në konformitet me kërkesat e legjislacionit të aplikueshëm, duke përfshirë edhe produktet e shitura/tregtuara online, për të siguruar një nivel të lartë sigurie të mbrojtjes së konsumatorëve, mbështetur në mbikëqyrjen efektive të tregut, si dhe në një infrastrukturë efektive të cilësisë, sipas praktikave më të mira evropiane.

II.1.1 Objektivat, masat dhe indikatorët për sigurinë e produkteve ushqimore

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Në kuadër të këtij qëllimi përcaktohen objektivat e mëposhtëm:

Objektivi 1:

Përmirësimi i legjislacionit shqiptar duke përafuar legjislacionin shqiptar me *acquis*-in e BE-së dhe kërkesat ndërkombëtare të produkteve ushqimore.

Arritja e këtij objektivi do të realizohet përmes përditësimit të Planit Kombëtar të Shqipërisë për Integrimin në BE dhe analiza e mangësive legjislative për të monitoruar dhe për t’i dhënë prioritet zhvillimit të legjislacionit shqiptar në përputhje me kërkesat e *acquis* të BE-së. Transpozimi i legjislacionit kryesor horizontal të BE-së po bën përparim të dukshëm në lidhje me hartimin e ligjeve të reja për kontrollet zyrtare, sigurinë ushqimore, shëndetin e kafshëve dhe shëndetin e bimëve. Ky hap hedh bazat për të transpozuar në mënyrë të vazhdueshme legjislacionin horizontal dhe vertikal, i cili do të mbështesë besimin në standardet dhe sistemin rregullator të Shqipërisë dhe do të rrisë potencialin për të zgjeruar eksportet në tregjet ekzistuese dhe në tregjet e reja.

Masa 1.1 Përafrimi i legjislacionit shqiptar me atë evropian në përputhje me kapitullin 12 të *acquis* të BE-së. Nga periudha 2024–2030 do të miratohen rreth 120 akteve ligjore dhe nënligjore.

Masa 1.2 Rritja e burimeve njerëzore për përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis*-in e BE-së dhe kërkesat ndërkombëtare. Legjislacioni i kapitullit 12 të BE-së amendohet në mënyrë të vazhdueshme dhe kërkon burime njerëzore në rritje, si dhe të rriten kapacitetet e tyre nëpërmjet trajnimit të vazhdueshëm të stafit.

Indikatorët: Miratimi i rreth 120 akteve ligjore dhe nënligjore që do ndikojnë në përmirësimin e sigurisë ushqimore dhe sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve dhe interesave të konsumatorit është një nga prioritetet kryesore në programin politik të qeverisë shqiptare. Lëvizja e lirë e ushqimeve të sigurta dhe të shëndetshme është një aspekt thelbësor i

tregut të brendshëm dhe kontribuon ndjeshëm në shëndetin, mirëqenien dhe në interesat ekonomike dhe sociale të konsumatorëve.

Staf i shtuar për angazhimin e për përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis*-in e BE-së dhe kërkesat ndërkombëtare.

Objektivi 2:

Përmirësimi i vlerësimit dhe efikasitet të kontrolleve zyrtare ndërmjet monitorimit.

Sistemi kombëtar i kontrollit zyrtar duhet të ketë kapacitetin dhe aftësinë për të monitoruar dhe raportuar mbi performancën e tij në arritjen e objektivit të përcaktuar dhe t'u nënshtrohet përmirësimeve të vazhdueshme aty ku është e nevojshme.

Monitorimi dhe rishikimi i performancës i mundëson rregullatorit të kuptojë pikat e forta dhe të dobëta brenda sistemeve. Përveç kësaj, duhet të rishikohen ndryshimet në mënyrën se si kryhen kontrollet zyrtare duke marrë parasysh përparimet në shkencë dhe teknologji. Është e rëndësishme që sistemi kombëtar i kontrollit ushqimor të demonstrojë aftësinë e tij për t'u përshtatur sipas rrethanave.

Një sistem efektiv kombëtar i kontrollit ushqimor mund të përdorë qasje të ndryshme, elemente thelbësore dhe komponentë të ndryshëm, sipas rrethanave kombëtare dhe siç përshkruhet në Parimet dhe Udhëzimet për Sistemet Kombëtare të Kontrollit të Ushqimit.

Një sistem efektiv i Sigurisë Ushqimore mund të arrihet vetëm nëpërmjet kontrolleve zyrtare të bazuara në shkencë, shpërndarjes së burimeve të mjaftueshme dhe bashkëpunimit ndërmjet të gjitha palëve të interesuara.

Investimi për zhvillimin e burimeve njerëzore të Shqipërisë dhe trajnimi i stafit zyrtar të kontrollit për t'u siguruar që kanë njohuritë për zbatimin e legjislacionit, do të ndihmojë në përmbushjen e objektivave për të ndërtuar dhe zbatuar një sistem kombëtar kontrolli të bazuar në shkencë, përmirësimin e kontrolleve zyrtare në fushën e sigurisë ushqimore me qëllim mbrojtjen e konsumatorit.

Masa 2.1: Krijimi i një sistem monitorimi efektiv për kontrollet zyrtare nëpërmjet një strukture të veçantë që do ta bëjë me efektiv sistemin kombëtar të kontrollit ushqimor i cili mund të përdorë qasje të ndryshme, elemente thelbësore dhe komponentë të ndryshëm, sipas rrethanave kombëtare.

Indikatorët: Sistemi funksional për monitorimit (sipas modelit të auditit të DG-SANTE), e cila do të ketë kapacitetin dhe aftësinë për të monitoruar sistemin e kontrollit në nivele rajonale,

Monitorimi dhe rishikimi i performancës i mundëson të kuptojmë pikat e forta dhe të dobëta brenda sistemeve, si për të kuptuar si kryhen kontrollet zyrtare duke marrë parasysh përparimet në shkencë dhe teknologji. Është e rëndësishme që sistemi kombëtar i kontrollit ushqimor të demonstrojë aftësinë e tij për t'u përshtatur sipas rrethanave.

II.1.2 Objektivat, masat dhe indikatorët për sigurinë e produkteve joushqimore

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit

Objektivi 3:

Përmirësimi i kuadrit ligjor për sigurinë e produkteve/grup produkteve /pajisjeve/instalimeve joushqimore.

Legjislacioni lidhur me kërkesat e sigurisë së produkteve/grup produkteve/pajisjeve/instalimeve joushqimore përbën një pjesë të konsiderueshme të *acquis* dhe në vijim të progresit të arritur për transpozimin e tij duke filluar që nga viti 2007, është i nevojshëm vijimi i procesit të transpozimit të plotë të legjislacionit teknik të produkteve dhe ndjekja e zhvillimeve në nivel evropian për përditësimin e legjislacionit duke u bazuar edhe në prioritetet apo problematikat e vendit.

Mbikëqyrja efektive dhe efiçente e zbatimit të kërkesave të sigurisë synon të garantojë që produktet në treg janë në përputhje me kërkesat teknike të sigurisë në lidhje me to. Ky objektivi i politikës për përmirësimin e mëtejshëm të legjislacionit dhe mbikëqyrjes, mbetet një nga prioritetet e ministrive përkatëse të linjës, sipas fushave përkatëse të përgjegjësisë, me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë së produkteve që ofrohen në treg dhe rritjen e nivelit të besimit të konsumatorëve.

Një aspekt tejet i rëndësishëm në kuadër të këtij objekti është edhe funksionimi efektiv i institucioneve të infrastrukturës së cilësisë sipas praktikave më të mira evropiane, duke përbërë një mbështetje të rëndësishme për një treg të sigurt për konsumatorët.

Masa 3.1: Harmonizimi i legjislacionit shqiptar në përputhje me legjislacionin evropian.

Masa për përmirësimin e legjislacionit do të synojë arritjen e një shkalle më të lartë të përafrimit/harmonizimit me *acquis* e BE-së, duke qenë në përputhje me zhvillimet në nivel evropian dhe në përmbushje të nevojave/boshllëqeve që ekzistojnë në legjislacionin aktual vendës, sa i takon fushës së sigurisë së produkteve.

Treguesit/indiktorët: Kjo masë do të ketë si tregues të drejtpërdrejtë aktet ligjore/nënligjore të miratuara, sipas fushës së përgjegjësisë së çdo ministrie, që do t'i nënshtrohen një procesi konsultimi jo vetëm me ministrinë dhe institucionet përkatëse shtetërore, por edhe me komunitetin e biznesit, organizatat e konsumatorëve. Konkretisht, do të miratohen 16 akte ligjore të fushës së sigurisë së produkteve që bien nën përgjegjësinë e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Masa 3.2: Përditësimi i Planit të Veprimit për Përputhshmërinë me nenet 34–36 të Traktatit të Funksionimit të Bashkimit Evropian (TFBE).

Masa për përditësimin e Planit të Veprimit për Përputhshmërinë me nenet 34–36 të TFBE-së synon vijim e procesit të identifikimit të pengesave ekzistuese të panevojshme për tregtinë e mallrave në Shqipëri dhe heqjes ose ndryshimit të tyre në përputhje me parimin e njohjes reciproke. Plani i Veprimit i përditësuar me sektorët/produktet e pashqyrtuara ende, do të mundësojë harmonizimin sistematik dhe gradual të legjislacionit dhe praktikave administrative shqiptare me kërkesat e legjislacionit të BE-së në përputhje me parimin e lëvizjes së lirë të mallrave.

Treguesit/indiktorët: Kjo masë do të ketë si tregues të drejtpërdrejtë miratimin e një Plani Veprimi për Përputhshmërinë me nenet 34 – 36 të TFBE, për identifikimin e pengesave ekzistuese të panevojshme për tregtinë e mallrave për sektorët/produktet që nuk janë analizuar gjatë fazës së parë të përgatitjes së dokumentit (kryer gjatë periudhës 2020–2022).

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Objekti 4:

Përmirësimi i politikave në menaxhimin e kimikateve në vend në Republikën e Shqipërisë.

Masa 4.1: Hartimi i planit të menaxhimit të sigurt të kimikateve i cili do përcaktojë vizion të qartë, ku do bëhet identifikimi i kuadrit ligjor, kapaciteteve administrative, si dhe masave për zbatimin e tij.

Masa 4.2: Krijimi i regjistrit kombëtar të kimikateve i cili do të përcaktojë një databazë me të dhëna mbi subjektet, të cilat operojnë në treg duke përfshirë import-eksportin dhe funksionimi i tij.

Indikatorët: Përgatitja dhe miratimi i planit kombëtar mbi menaxhimin e sigurt të kimikateve 2024–2027.

Regjistër funksional mbi regjistrimin e kimikateve.

Objekti 5:

Përditësimi i kuadrit ligjor mbi menaxhimin e kimikateve në RSH, si dhe forcimi i kapaciteteve administrative.

Masa 5.1: Hartimi i kuadrit ligjor sekondar në zbatim të ligjit të kimikateve.

Masa 5.2: Zhvillimi i trajnimeve të stafi mbi legjislacionin e kimikateve.

Indikatorët:

Hartimi i 5 akteve nënligjore mbi fushën e kimikateve.

Zhvillimi i 3 trajnimeve në vit për forcimin e kapaciteteve teknike të stafit të ministrisë dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Objekti 6:

Garantimi i plotësisë së standardeve të pajisjeve mjekësore që prodhohen dhe tregtohen në Republikën e Shqipërisë.

Masa 6.1: Licencimi i prodhuesve të pajisjeve mjekësore.

Masa 6.2: Licencimi i tregtuesve të pajisjeve mjekësore.

Indikatorët

Autorizimi i (7) shtatë licencave për operim në treg të prodhuesve dhe tregtimit të pajisjeve mjekësore.

Objektivi 7:

Forcimi i sistemit të mbikëqyrjes së tregut për pajisjet mjekësore.

Masa 7.1: Kryerja e inspektimeve për zbatimin e kërkesave ligjore nga ana e operatorëve ekonomikë për sigurinë e pajisjeve mjekësore.

Masa 7.2: Monitorimi i publicitetit të pajisjeve mjekësore.

Masa 7.3: Monitorimi i shitjeve *online* të pajisjeve mjekësore.

Indikatorët

Nr. i inspektimeve për konstatimin e prodhuesve të palicencuar.

Numri i inspektimeve të subjekteve që kryejnë publicitet të pajisjeve mjekësore.

Numri i subjekteve të penalizuar për publicitet të paligjshëm të pajisjeve mjekësore.

Numri i subjekteve të penalizuar për shitjen *online* të pajisjeve mjekësore në kundërshtim me legjislacionin.

Objektivi 8:

Përmirësimi i kuadrit rregullator për përdorim të sigurt të teknologjisë mjekësore dhe monitorimin e tij.

Masa 8.1: Hartimi i akteve rregullore për përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit me legjislacionin evropian.

Masa 8.2: Garantimi i mirëmbajtjes së vazhdueshme të pajisjeve mjekësore në institucionet shëndetësore publike dhe private.

Masa 8.3: Trajnimi i përdoruesve të pajisjeve mjekësore në strukturat shëndetësore me qëllim rritjen e kapaciteteve të stafit që mirëmban dhe kontrollon pajisjet mjekësore në spitale.

Indikatorët:

Numri i akteve të përafruara.

Rritja e numri i pajisjeve që mirëmbahen rregullisht vit pas viti.

Numri i trajnimeve të përdoruesve dhe mirëmbajtësve të pajisjeve mjekësore.

Numri i dokumenteve të hartuar për informim.

Infrastruktura e cilësisë.

Standardizimi.

Objektivi 9:

Anëtarësimi i DPS-së me të drejta të plota në organizmat evropianë të standardizimit CEN dhe CENELEC dhe pjesëmarrëse në Njësinë Ndërkombëtare të Standardeve të Telekomunikacionit (ITU-T), si dhe fillimi i adoptimit të standardeve të publikuara nga ITU-T.

Anëtarësimi dhe pjesëmarrjen në këta organizma është detyrim që vjen nga neni 75 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, ku Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit është përgjegjëse për organizimin e gjithë aktiviteteve të standardizimit dhe ngritjen e funksionimit në një sistemi kombëtar standardizimi në vend në përputhje me atë evropian (CEN, CENELEC dhe ETSI) dhe ndërkombëtar (ISO, IEC dhe ITU-T).

Anëtarësimi me të drejta të plota i DPS-së në këta organizma kërkon që DPS-ja të veprojë në përputhje me rregulloret/legjislacionin dhe parimet e standardizimit dhe do të sjellë pjesëmarrjen aktive (me të drejtë vote) të saj në punën evropiane e ndërkombëtare të standardizimit, duke mbrojtur interesat e biznesit vendës dhe jo vetëm në fushat me interes për të dhe ku njëri nga përfituesit nga përdorimi i standardeve është edhe konsumatori, i cili do të marrë produkte e shërbime të sigurta dhe me cilësi për jetën, shëndetin dhe mjedisin.

Masa 9.1: Marrja e veprimeve korrigjuese/adresimi i moskonformiteteve nga vizitat vlerësuese në DPS të CEN&CENELEC sipas plan-veprimit të lënë nga ekspertët e CEN&CENELEC - evidentimi i plotësimit të kritereve të anëtarësimit në CEN&CENELEC dhe pjesëmarrja në ITU-T.

Masa 9.2: Rritja e numrit të stafit të DPS-së për menaxhimin efikas të shkëmbimit të të dhënave brenda sistemeve përkatëse të organizmave evropiane e ndërkombëtare të standardizimit dhe menaxhimi i databazës kombëtare të standardeve (SMS).

Masa 9.3: Adoptimi në vazhdimësi i standardeve evropiane (CEN & CENELEC) dhe adoptimi me përkthim të plotë të tekstit të standardeve më të rëndësishme për konsumatorin dhe biznesin vendës (kryesisht standardet e harmonizuara nën direktivat e Qasjes së Re), por jo vetëm.

Treguesit/indiktorët:

- Funksionimi i sistemit të standardizimit në vend në përputhje me kërkesat dhe *acquis* në këtë fushë – plotësim i detyrimeve që vijnë nga neni 75 i MSA-së;
- Realizimi i numrit dhe përqindjes së standardeve të planifikuara për adoptimin e standardeve evropiane e ndërkombëtare si Standarde Shqiptare – 90% e standardeve të CEN&CENELEC të adoptuara si Standarde Shqiptare;
- Staf i mjaftueshëm për kryerjen e detyrave dhe përballimin e volumit të madh të punës së standardizimit në nivel kombëtar e evropian;
- Ecuria drejt pranimit të DPS-së si anëtar me të drejta të plota në CEN&CENELEC dhe pjesëmarrje e DPS-së në ITU-T.

Objektivi 10:

Rritja e kapaciteteve të stafit të DPS-së në lidhje me legjislacionin dhe praktikën evropiane për fushën e standardizimit.

Masa 10.1: Trajnimi në vazhdimësi stafit të DPS-së dhe vlerësimi i tyre

Indikatorët:

Fushat dhe numri i trajnimeve të realizuara sipas tabelës në vijim:

Fushat e trajnimit	Vitet 2024–2025	Vitet 2026–2030
Legjislacioni/rregulloret dhe praktikën më të mira evropiane e ndërkombëtare dhe standardi ISO 9001	15	20
Databaza e standardeve, ndërveprimi me databazat e org.evropiane e ndërkomb.të st.		
Promovimi – Roli dhe rëndësia e standardeve për grupet e interesit dhe veçanërisht për konsumatorin		

Objektivi 11:

Sigurimi i përputhshmërisë së vazhdueshme të databazës së standardeve të DPS-së me ato të organizmave evropiane e ndërkombëtare të standardizimit.

DPS-ja duhet të sigurojë në mënyrë të vazhdueshme se databaza e saj e standardeve është në përputhje dhe në gjendje të bashkëveprojë me databazat e organizmave evropiane të standardizimit, si dhe të ketë kapacitetin e duhur për të përballuar volumin e madh të punës, e cila duhet të jetë në bashkërendim të plotë me organizmat evropiane e ndërkombëtare të standardizimit.

Masa 11.1: Përditësimi i vazhdueshëm i databazës së standardeve në përputhje me atë të organizmave evropiane e ndërkombëtare.

Masa 11.2: Investime në *hardware* dhe mirëmbajtja e saj.

Masa 11.3: Organizimi i trajnimeve të stafit DPS.

Indikatorët:

- Sistem funksional dhe i përditësuar me të dhënat nga databaza kombëtare e standardeve dhe publikimin e standardeve në nivel kombëtar, evropian dhe ndërkombëtar, si dhe menaxhimi i shkëmbimit të të dhënave me sistemet përkatëse të organizmave evropiane e ndërkombëtare të standardizimit është efikas;
- Pjesëmarrja në 7 mbledhjet e komiteteve teknike në nivel evropian e ndërkombëtar.

Akreditimi

Objektivi 12:

Njohja evropiane e raporteve të testimi të lëshuara nga laboratorë mjekësorë, laboratorë kalibruës dhe organe certifikuese të produkteve, të akredituara në Shqipëri.

Masa 12.1: Aplikimi në EA për zgjerim të MLA-së në fushat përkatëse.

Masa 12.2: Realizimi me sukses i vizitës/ave vlerësuese të EA-së.

Indikatorët: Nënshkrimi i 3 marrëveshjeve të njohjes reciproke me EA-në në fushën e laboratorëve mjekësorë, laboratorë kalibruës dhe organe certifikuese të produkteve, të akredituara në Shqipëri.

Objektivi 13:

Rritja e numrit të aplikimeve për akreditim

Masa 13.1: Ndërgjegjësimi i rregullatorëve në lidhje me kërkesat e legjislacioneve të BE-së ku kërkohet akreditimi dhe përfshirja në legjislacionin shqiptar kërkesa për organe të akredituara.

Masa 13.2: Zhvillimi i skemave të akreditimit që kërkohen nga legjislacioni dhe nga politikat e rregullatorëve.

Masa 13.3: Ndërgjegjësimi i bizneseve në të gjithë vendin në lidhje me përfitimet nga akreditimi.

Indikatorët:

- Numri i aplikimeve për akreditim - 18/vit.
- Numri i takimeve/seminareve - 12/vit.
- Numri i publikimeve - 4 publikime/vit.

Metrologjia

Objektivi 14:

Përmirësimi i legjislacionit dhe harmonizimi i tij me legjislacionin evropian.

Masa 14.1: Rishikimi i ligjit ekzistues “Për metrologjinë”, duke marrë në konsideratë problematikën e vërejtur gjatë periudhës në zbatim të këtij ligji dhe duke u mbështetur në raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Masa 14.2: Rishikimi i VKM-së për miratimin e rregullores “Për kërkesat teknike dhe meteorologjike të instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluar”, për harmonizimin me direktivat 2014/32 EU, 2014/31 EC dhe rregulloret të ministrit “Për miratim tipi të instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluar” dhe “Verifikim fillestar dhe pasardhës i instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluar” për harmonizimin me direktivën 2009/34/EC.

Masa 14.3: Rishikimi i VKM-së për njësitë bazë të sistemit ndërkombëtar të njësive për harmonizimin me direktivën 2019/1258.

Masa 14.4: Rishikimi i VKM-së për rregulloren e parapaketimeve për harmonizimin me direktivat 2007/45/EC dhe 76/211/EEC.

Indikatorët:

- Miratimi i ligjit të rishikuar “Për metrologjinë”;
- Miratimi i VKM-së së rishikuar për miratimin e rregullores “Për kërkesat teknike dhe meteorologjike të instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluar”, dhe rregulloret të ministrit “Për miratim tipi të instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluar” dhe “Verifikim fillestar dhe pasardhës i instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluar”;
- Miratimi i VKM-së për njësitë bazë të sistemit ndërkombëtar të njësive;
- Miratimi i VKM-së për rregulloren e parapaketimeve.

Objektivi 15:

Zgjerimi dhe rritja e cilësisë së shërbimeve meteorologjike nëpërmjet arritjes të njohjes ndërkombëtare të tyre akreditimit apo regjistrimit të aftësive matëse dhe kalibruese (CMC) në databazën e të dhënave të Byrosë Ndërkombëtare të Peshave dhe Masave (BIPM KCDB), si dhe rritja e shkalles së mbrojtjes së konsumatorëve nga matjet e pasakta nëpërmjet rritjes të numrit të verifikimeve të instrumenteve matëse në përdorim.

Masa 15.1: Njohja e sistemit të menaxhimit të cilësisë nga EURAMET, akreditimi i laboratorëve sipas fushave përkatëse nga trupa akredituese nënshkruese të MLA-s të EA në fushën e kalibrimeve/deklarimi në database të BIPM-së të fushave të matjes, zgjerimi i bazës etalonuese në fusha të reja matje për laboratorët kalibruës përkatësisht për fushën e forcës, termometrisë,

kimisë (analizuesve të frymës, pH dhe konduktivitetit), fushën e volumeve të mëdha, fushën e gjatësisë.

Masa 15.2: Zgjerimi i fushave të reja, përkatësisht për ngritjen e një laboratorit për “Verifikimin e radarëve të shpejtësisë”, si dhe përmirësimin, zgjerimin dhe dublimin e bazës etalonuese në fushën e presionit për “Kryerjen e kalibrimeve/verifikimeve në nivel sekondar të instrumenteve matëse të presionit hidraulik dhe pneumatik për subjekte të ndryshme”.

Masa 15.3: Kryerja e verifikimeve periodike të instrumenteve matëse në përdorim në masën 2% për çdo vit paraardhës duke iu referuar zbatimit të sistemit të menaxhimit të cilësisë në sektorët e shërbimit në Tiranë, Korçë, Lezhë dhe Fier.

Indikatorët:

- Akreditimi i 5 laboratorëve kalibrues;
- Zgjerimi me dy fusha të reja të laboratorëve kalibrues;
- Realizimi i 39582 verifikimeve të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluar;
- Zgjerimi i fushave dhe nënfushave të reja, në nivel primar, përkatësisht:
 - për kalibrimin e blloqeve fundore në kufij matjeje 0.5 mm... 100 mm”;
 - për kalibrimin e densitetit të gramarëve dhe të lëngjeve”;
 - për kalibrimin e dhënësve të forcës në shtypje dhe në tërheqje në kufijtë 0... 100 kN”;
 - për kalibrimin e pajisjeve që matin rezistencën tokëzimit dhe testimin e izolimit;
 - për kalibrimin e pajisjeve mjekësore dhe termometrat me rrezatim”.

Masa 15.4: Zgjerimi i fushave dhe nënfushave të reja, në nivel sekondar:

- Për kalibrim të instrumenteve që matin perpendikularitetin, rrafshitetin e sipërfaqes, paralelësinë e sipërfaqes, cilindërsinë, si dhe rrumbullakësinë”, si dhe kalibrim të mikroskopëve, mikrometrave okular, *stage micrometer*, vizoreve optike, matësve të lartësisë, mikrometrave të jashtëm/të brendshëm, kalibrave të jashtëm/të brendshëm”.

- Për kalibrimin e gramarëve të mëdhenj.
- Për kalibrime të termometrave me rezistencë PRT deri në kufijtë 660°C.

Masa 15.5: Kryerja e verifikimeve periodike të instrumenteve matëse duke përfshirë në skemën e verifikimit ligjor të detyrueshëm të instrumenteve matëse të temperaturës, tensionit të gjakut, të cilët përdoren në fushën e mjekësisë.

Masa 15.6: Akreditimi i laboratorëve sipas fushave përkatëse nga trupa akredituese nënshkrues të MLA-së të EA në fushën e kalibrimeve për fushën e termometrisë për “Kalibrimin e termometrave me rezistencë platini PRT me metodën e krahasimit në diapazonin -40°C deri në 660°C”.

Indikatorët:

- zgjerimi me 5 fusha të reja të laboratorëve kalibrues në nivel primar;
- akreditimi i një laboratorit kalibrues;
- zgjerimi me tri fusha të reja të laboratorëve kalibrues në nivel sekondar;
- realizimi i 42840 verifikimeve të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluar në vitin 2030.

Objekti 16:

Përmirësimi i shërbimeve meteorologjike nëpërmjet digjitalizimit të shërbimeve meteorologjike, shërbimeve *online* dhe realizimi i fushatave ndërgjegjëse me biznesin.

Masa 16.1: Krijimi, administrimi dhe përdorimi i bazës së të dhënave të regjistrit elektronik të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, i cili do të përfshijë subjektet e autorizuar për verifikim dhe riparim, dhe pajisjet matëse dhe kalibruese që janë në përdorim.

Masa 16.2: Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me strukturat e mbrojtjes së konsumatorit dhe institucionet e infrastrukturës të cilësisë, si: ISHMT, DPA, DPS, për shkëmbim informacioni, me qëllim mbrojtjen e interesave ekonomike të konsumatorëve dhe organizimi i aktiviteteve ndërgjegjëse me operatorët ekonomikë, dhomat e tregtisë, universitetet.

Indikatorët:

- Regjistri elektronik funksional i bazës së të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë;

- Nënshkrimi i një marrëveshje bashkëpunimi çdo vit;
- Organizimi i një aktiviteti ndërgjegjësues çdo vit.

Masa 16.3: Automatizimi i procesit të matjeve kalibruese në fushat e termometrisë, gjatësisë, forcës është një element i rëndësishëm i çdo ekonomie moderne dhe funksionimi korrekt përcjell efikasitet dhe sigurinë e funksionimit të procedurave dhe rritjen e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve.

Masa 16.4: Planifikimi, përgatitja e materialeve dhe organizimi i aktiviteteve ndërgjegjëse për konsumatorët dhe subjektet.

Indikatorët:

- Organizimi i një aktiviteti ndërgjegjësues çdo vit.
- Automatizim i matjeve kalibruese në 3 fusha.

Mbikëqyrja e tregut

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit

Objektivi 17:

Forcimi i sistemit të sigurisë ushqimore dhe sistemet e kontrollit me qëllim rritjen e cilësisë së inspektimeve.

Masa 17.1: Draftimi dhe miratimi i një metodologjie të re për vlerësimin e riskut për planifikimin e kontrolleve zyrtare me bazë risku.

- Hartimi i planit, është bazuar në një metodologji të re të profilizimit të riskut, me asistencë të projektit Irlandez, ku profilizimi i riskut lidhet me aktivitetet e OB-së dhe faktorët e tjerë ndikues nëpërmjet një sistemi pikëzimi, ku sipas vlerësimit të riskut për çdo OB bazuar edhe në historikun e tij përcaktohet frekuenca e inspektimit, e cila rritet për subjektet në të cilat janë konstatuar mangësi.

AKU-ja ka hartuar planin kombëtar të kontrolleve zyrtare me bazë risku nëpërmjet një metodologjie të re me asistencë të projektit irlandez “Food Safety Project”/”Mbështetje për sigurinë ushqimore, standardet veterinarë dhe fitosanitare në Shqipëri”, ku vlerësimi i operatorëve të biznesit ushqimore apo edhe atyre në fushën e inputeve bujqësore sipas metodologjisë së re (profilizimit të riskut) konsiston në kategorizimin e riskut të OB-së me risk të ulët, të mesëm ose të lartë në varësi të riskut që lidhet me aktivitetet e tyre dhe faktorëve të tjerë ndikues duke përdorur një sistem pikëzimi. Në ndryshim nga metodologjia e përdorur në vitet e mëparshme, në këtë metodologji frekuenca e inspektimit varion në varësi të llojit të stabilimentit, dhe për të njëjtën kategori/nënkategori/aktivitet specifik të biznesit (ushqimor apo inputeve bujqësore) ka jo më një profilizim të unifikuar të riskut, por vlerësimi i riskut është individual për çdo OB, duke u bazuar në historikun e tij.

- Për më tepër po hartohet metodologjia me bazë risku për inspektimet në pikat e inspektimit kufitar për produktet e bimëve dhe produktet bimore.

Masa 17.2: Rritja e kapaciteteve tekniko-profesionale të stafit të AKU-së.

Trajnimi i inspektorëve është një element shumë i rëndësishëm për rritjen e kapaciteteve tekniko-profesionale, gjë që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e performancës së punës së tyre gjatë kontrolleve zyrtare dhe cilësinë e inspektimeve. Pas identifikimit të nevojave për trajnimin e stafit, sektori i trajnimeve do të organizojë një agjendë me temën e trajnimit, si dhe modulet përkatëse për realizimin e trajnimit, punonjësit që do të trajnohen, si dhe afatet e realizimit të këtyre trajnimeve.

Indikatorët

- Metodologjia e re për vlerësimin e riskut të kontrolleve zyrtare me bazë risku e miratuar me urdhër ministri, me qëllim standardizimin e inspektimeve dhe rritjen e cilësisë së tyre.

- Zhvillimi i 65 trajnimeve brenda afatit kohor 7-vjeçar në kuadër të rritjes së kapaciteteve tekniko profesionale.

Objektivi 18:

Zbatimi i rregullave të sigurisë ushqimore përmes kontrolleve zyrtare të përmirësuara, përfshirë kushtet e kontrollit dhe kontrollet.

Masa 18.1: Rivitalizimi i sistemit AKU-net.

Për të realizuar misionin e saj në mbështetje të kuadrit të përgjithshëm, si dhe me qëllim përmirësimin e cilësinë e statistikave të inspektimit duke mos e kufizuar atë vetëm në numrin e inspektimeve, si dhe rritjen e transparencës së të dhënave kombëtare. Është punuar për rivitalizimin e sistemit AKU-net me anë të të cilit do të realizohet digjitalizimi i të gjithë veprimtarisë të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit lidhur me hedhjen/ruajtjen e të dhënave, marrjes në kohë reale të raporteve statistikore, kryerjen e inspektimeve *online* në pikat e inspektimit kufitar, si dhe ndërveprimin me *e-Inspektimin*, Regjistrin kombëtar të Gjendjes Civile për të dhënat e shtetasve shqiptarë, QKB-së, ASICUDA-s, RUDA-s, LIMS-it, *e-Albania*, *e-Inspektimi*, duke mundësuar përqendrimin e të gjitha sistemeve që përdoren aktualisht në dritare të vetme për punonjësin e AKU-së, duke lehtësuar planifikimin e inspektimeve dhe duke e kthyer atë në të automatizuar.

Implementimi i sistemit bëhet në funksion të plotë brenda vitit 2024.

Masa 18.2: Përmirësimi i infrastrukturës për marrjen e mostrës, garantimin dhe dërgimin e tyre në laboratorët respektive.

Mungesa e mjeteve për marrjen e mostrës, si dhe pajisjeve për dërgimin e tyre në laborator, kryesisht për mostra që kërkojnë të transportohen nën një regjim termik të caktuar, kufizon kryerjen e kontrolleve zyrtare në përputhje me standardet e parashikuara në legjislacionin në fuqi. Për këtë arsye, AKU-ja do të mundësojë pajisjen e inspektorëve me mjete të përshtatshme për marrjen e mostrave dhe dërgimin e tyre në laboratorët respektiv.

Indikatorët:

- Module dhe ndërveprimi i sistemit i përfunduar 2024 blerje e pajisjeve në 7 vjet për marrjen dhe garantimin e mostrës.

Objektivi 19:

Ngritja dhe përfundimi i kapaciteteve laboratorike të AKU-së.

Masa 19.1. Pajisja e laboratorëve të AKU-së me aparatura të sofistikuar dhe zgjerim të gamës analitike.

Me qëllim kryerjen e analizave është e nevojshme rritja e investimeve në fuqizimin e rrjetit laboratorik, për pajisjen e laboratorëve të AKU-së me aparatura të sofistikuar dhe koherente për të rritur kapacitetin dhe për të zgjeruar gamën e analizave, duke kryer monitorim dhe analizim të produkteve ushqimore me referencë specifike në fushën e monitorimit të mbetjeve të pesticideve, diagnozës mikrobiologjike në ushqim dhe ushqim për kafshët, standardet e cilësisë, sëmundjet e kafshëve, në përputhje me standardet e përmirësuara, sipas BE-së. Aktualisht me qëllim funksionalitetin e rrjetit laboratorik të AKU-së janë marrë masa për kryerjen e investimeve në blerjen e pajisjeve të reja në sektorin e shërbimit laboratorik Tiranë, si dhe në bashkëpunim me projektin SAFIAL u mundësuan investime në infrastrukturë dhe pajisje laboratorike për laboratorin fitosanitar dhe mikrobiologjik e fizikokimik.

Masa 19.2: Draftimi dhe miratimi i Manualit të Menaxhimit të Cilësisë.

Draftimi i Manualit të Menaxhimit të Cilësisë është një dokument shume i rëndësishëm cili do të shërbejë për akreditimin e laboratorëve të AKU-së.

Indikatorët:

- Parashikim i blerjes së pajisjeve laboratorike sipas nevojave të laboratorit me buxhet shteti për parashikime të kryera në PBA, si dhe kërkesa adresuar projektit të Bankës Botërore për investime në përmirësimin e infrastrukturës së shërbimeve laboratorike dhe furnizimit të pajisjeve me qëllim përmbushjen e misionit të AKU-së nga detyrimet që rrjedhin me hapjen e negociatave me BE, i cili konsiston edhe në profilizimin e sektorëve laboratorike për shërbimet e ofruara.

- Trajnimi i vazhdueshëm i stafit me qëllim rritjen e nivelit profesional të punonjësve sa lidhet me zgjerimin e treguesve analitikë për metoda të paanalizuara më parë.

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor**Objektivi 20:**

Rritja e sigurisë së produkteve që ofrohen në fushën e kozmetikës duke mbrojtur konsumatorët shqiptarë në mënyrë efektive nga risqet dhe kërcënimet në fushën e kozmetikës.

Masa 20.1: Rritja e numrit të inspektimeve për të mundësuar evidentimin dhe inspektimin e gjithë subjekteve që operojnë në treg: parfumeri, shampo profesionale, kremra, lapsa, buzëkuq.

Masa 20.2: Kryerja e analizave laboratorike mbi produktet e kozmetikës duke iu garantuar konsumatorëve në treg produkte të sigurt sipas legjislacionit në fuqi.

Indikatorët:

- Rreth 2440 Numri i inspektimeve gjatë viteve 2024–2030.
- 10 analizave laboratorike në laboratorë të akredituar të kryera në periudhën 2024–2030.

Objektivi 21:

Rritja e kapaciteteve administrative institucionale, si dhe përgjegjshmërisë e operatorëve ekonomikë për kriteret ligjore të produkteve/shërbimeve.

Masa 21.1: Rritja e kapaciteteve administrative nëpërmjet trajnimeve dhe fuqizimi strukturor në përputhje me legjislacionin.

Masa 21.2: Rritja e ndërgjegjësimit nëpërmjet informimit dhe lënia e detyrave për operatorët ekonomikë që veprojnë në treg mbi produktet e kozmetikës.

Masa 21.3: Bashkëpunimi me specialistë e subjekteve kozmetike dhe institucioneve kontrolluese të zbatimit të ligjit.

Indikatorët:

- Zhvillimi i 10 trajnimeve viteve 2024–2030.
- Zhvillimi i 200 inspektimeve pa masa administrative duke lënë detyra.
- Takime të realizuar në 13 subjekte gjatë viteve 2024–2030.

Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut

Objektivi 22:

Rritja dhe zgjerimi i fushës së kontrollit dhe mbikëqyrjes në treg të produkteve joushqimore në përputhje me legjislacionin ekzistues.

Masa 22.1: Kryerja e inspektimeve për zbatimin e kërkesave ligjore nga ana e operatorëve ekonomikë për sigurinë e produkteve joushqimore dhe rritje e kontroleve fizike treguese dhe laboratorike. Do të kryhen inspektime për zbatimin e kriterëve ligjore nga ana e operatorëve ekonomikë, duke u fokusuar te grup-produkte që janë inspektuar në vitet në vazhdim, por do të përfshihen edhe grupe produkte të reja që nuk janë **inspektuar** më parë, por që janë pjesë e fushës së veprimtarisë së ISHMT-së në zbatim të rregulloreve të reja të transpozuara në legjislacionin shqiptar, si: pajisjet e gazit, enët e thjeshta në presion, artikujt piroteknikë, artikujt aerosolë, kimikate, avionët pa pilot etj. Në fokus kryesor do të jenë edhe inspektimet për sigurinë e ashensorëve, lodrave, instrumentet matëse ligjërisht të kontrolluara, parapaketimet, artikujt e kujdesit për fëmijë etj.

Inspektimet do të fokusohen jo vetëm në kontrollin dokumentar, por edhe në kontrole fizike treguese duke vënë në përdorim instrumente/kite/pajisje ndihmëse për vlerësimin e konformitetit të produktit. Gjithashtu, do të ndërmerren edhe analiza laboratorike për grupe produktesh për të cilat ka dyshime që përbëjnë risk për jetën dhe shëndetin e konsumatorit.

Masa 22.2: Rritja e shkallës së njohurive të kapaciteteve njerëzore të ISHMT-së.

Fuqizimi i kapaciteteve njerëzore do të synojë në rritjen e aftësive tekniko-profesionale, si dhe të shkallës së njohurive të stafit (inspektorëve) mbi legjislacionin në fushën e mbikëqyrjes së tregut dhe mbi rregulloret e reja të transpozuara në legjislacionin shqiptar. Kjo do të arrihet nëpërmjet trajnimeve, marrjes së eksperiencës më pozitive nga vendet e rajonit dhe të BE-së.

Masa 22.3: Rishikimi i strukturës së ISHMT-së në lidhje me burimet njerëzore, logjistikën dhe i fondeve buxhetore.

ISHMT-ja është një institucion me një fushë shumë të gjerë veprimtarie dhe që funksionon si drejtori qendror me mbulim të gjerë territorial. Gama e produkteve që duhet të kontrollohen dhe që janë pjesë e fushë veprimtarisë së këtij institucioni është shumë e gjerë, e cila kërkon jo vetëm kapacitete njerëzore, trajnim të tyre, por kërkon edhe logjistikë duke filluar që nga kitet e

inspektimit/tableta, kompjuterë e pajisje zyre, mjete transporti, instrumente/pajisje për inspektim etj. Kjo masë konsiston në rishikimin e organigramës dhe strukturës së ISHMT-së duke synuar rritjen e numrit të inspektorëve dhe rritjen e fondeve buxhetore për përmirësimin e logjistikës duke e bërë më funksionale për realizimin e objektivave të institucionit.

Indikatorët:

- Kryerja e 1200 inspektime/vit për kontrollin e produkteve joushqimore si produktet elektrike/elektronike, qelq-kristal, tekstil, veshjet e këmbës, detergjente, produktet që mbulohen nga legjislacioni për sigurinë e përgjithshme (artikuj për fëmijë, produkte të tjera për konsumatorët), ashensorët, parapaketimet, instrumentet matëse dhe veç tyre në fokus do jenë edhe realizimi shtrirja e inspektimeve në përputhje legjislacionin e zbatueshëm për pajisjet të gazit, enët e thjeshta në presion, artikujt piroteknikë, aerosolët, kimikate, avionët pa pilot.

- Regjistrimi i rreth 3500 ashensorë duke konsideruar një mesatare prej 500 ashensorë/vit.

- Zhvillimi i 6 trajnimeve/vit për ngritjen e mëtejshme të kapaciteteve njerëzore me theks të veçantë në rregulloret/direktivat e BE-së që janë përafuar rishtazi apo janë parashikuar për përafrim në legjislacionin shqiptar si rregullorja e re e mbikëqyrjes së tregut, pajisjet e gazit, artikujt piroteknikë, për përvetësimin e njohurive të duhura për implementimin duke ndjekur edhe praktikatat më të mira të BE-së apo rajonit.

- Rritja me 20 punonjës të stafit aktual, duke sjellë përmirësim në veprimtarinë mbikëqyrëse të strukturës përgjegjëse nëpërmjet rritjes së numrit të inspektimeve, mbulimit të një territorit më të gjerë që do të përfshihet në kontroll, rritjes së numrit të produkteve të verifikuara duke pasur kështu një impakt pozitiv në treg dhe te konsumatori.

- Rritja e numrit të analizave laboratorike dhe inspektimet ku do të përdoren pajisjet/instrumentet për kontroll fizik me vlerë indicie (60 analiza apo teste në terren/vit) me qëllim rritjen e produkteve të sigurta që bëhen të disponueshme në treg për konsumatorët.

- Përfshirja e gjithë stafit inspektues të strukturës mbikëqyrëse në trajnimet e organizuara.

- Rritja me 20 % e buxhetit në dispozicion të strukturës mbikëqyrëse.

Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial

Objektivi 23:

Krijimi i rrjetit të infrastrukturës me synim digjitalizimin e të gjitha proceseve administrative dhe inspektuese.

Masa 23.1: Ngritja e infrastrukturës IT (arkiva digjitale, platformë për ruajtjen e të dhënave, EMS, CRM, rrjet i brendshëm kompjuterik, platforma për regjistrimin e pajisjeve, vetëdeklarimin e subjekteve dhe monitorimin e aktivitetit të OMVK-së, pajisje laboratorike, mjete transporti, pajisje për inspektim dhe kontroll/matje/verifikim etj.

Masa 23.2: Zhvillimi i trajnimeve me qëllim rritjen kapaciteteve të stafit të ISHTI-së.

Indikatorët:

- Platformë funksionale e ndërtuar në forme modulare ku të këtë mundësi të menaxhohet në mënyrë digjitale procese të ndryshme administrative, brenda vitit.....

- Zhvillimi 7 module trajnimi mbi njohjen përvetësimi të funksionaliteteve të platformës.

Objektivi 24:

Mirëfunksionimi i laboratorit qendror në aspektin teknik logjistik, duke u garantuar siguri konsumatorëve në treg.

Masa 24.1: Vijimi i procesit të kalibrimit dhe mirëmbajtës peridoke të pajisjeve në laborator duke përmirësuar produktet në treg dhe garantuar konsumatorëve mbrojtje ekonomike.

Masa 24.2: Trajnimi me qëllim rritjen e kapaciteteve administrative.

Masa 24.3: Zhvendosja e ambienteve të punës në një mjedis i cili do të ofrojë siguri dhe mbarëvajtje të procesit të punës.

Indikatorët:

- Kalibrimi i 20 pajisjeve të produkteve të naftës dhe 5 për tekstilet.

- Zhvillimi i 5 trajnimeve në vit mbi proceset e ndryshme laboratorike dhe teknologjike.

- Ambiente të reja pune që garantojnë mbarëvajtjen e punës dhe sigurinë.

Objektivi 25:

Përmirësimi i sigurisë së produkteve në treg duke u garantuar konsumatorëve produkte të sigurta sipas standardeve evropiane.

Masa 25.1: Rritja e numrit të inspektimeve për produktet e pajisjet mbrojtës diferenciale, tokëzimet dhe instalimet e ndryshme elektrike, enët e transportueshme nën presion, instalimet në subjekte industriale dhe rezidenciale, të cilat ofrojnë shërbime tregtare për konsumatorët.

Indikatori: 7000 inspektime në vit mbi produktet që prekin konsumatorët në treg.

II.2 Shtylla II. Çështje të mbrojtjes së konsumatorëve që nuk lidhen me aspektet e sigurisë

Në këtë shtyllë të politikës, ndërmarrja e veprimeve konkrete në përputhje me vizionin dhe qëllimin e strategjisë për fuqizimin e konsumatorëve, do të garantojë konsumatorët, të mund të përfitojnë plotësisht nga mundësitë që tregu ofron për ta dhe interesat e tyre ekonomike do të mbrohen siç duhet. Gjithashtu, këto masa do të sigurojnë që legjislacioni të zbatohet nga tregtarët në mënyrë të njëjtë dhe për rrjedhojë konkurrenca në treg të jetë e drejtë.

Qëllimi i politikës të kësaj shtylle lidhet me çështje të mbrojtjes së konsumatorëve që nuk lidhen me aspektet e sigurisë (interesat ekonomike): praktikat tregtare; zbatimi i të drejtave të konsumatorëve; kushtet e padrejta në kontrata, zgjidhja alternative dhe online e mosmarrëveshjeve; mjedisi; turizmi; digjitalizimi etj.

Objektivi i përgjithshëm

Mbrojtje dhe promovim i interesave ekonomike të konsumatorëve, nëpërmjet përmirësimit të informacionit dhe transparencës së tij, mbi tregjet dhe të drejtat e konsumatorëve, mekanizmat efikase të dëmshpërblimit, mbi promovimin e konsumit të qëndrueshëm, veçanërisht për karakteristikat specifike dhe ndikimin mjedisor të mallrave dhe shërbimeve; mbrojtjen e të drejtave gjatë blerjeve online në kontekstin e transformimit digjital.

II.2.1 Objektivat, masat dhe indikatorët

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit

Objektivi 26:

Përmirësimi i kuadrit ligjor për mbrojtjen e interesave ekonomike të konsumatorëve dhe të drejtave të tjera, si dhe fuqizimi i sistemit institucional dhe eficient në zbatimin e këtij legjislacioni.

Masa 26.1: Hartimi i ndryshimeve të kuadrit ligjor për mbrojtjen e interesave ekonomike të konsumatorëve dhe të drejtave të tjera.

Të drejtat e përcaktuara për konsumatorët nga legjislacioni aktual në fuqi për mbrojtjen e konsumatorëve, si dhe zbatimi i këtij legjislacioni u japin konsumatorëve dhe tregtarëve siguri dhe besim, duke sjellë përfitime reale në lidhje me të drejtat e konsumatorëve.

Në kushtet e ndryshimeve të shpejta të tregut, sidomos zhvillimet e vazhdueshme teknologjike në tregun *online*, shërbimet digjitale apo dhe mjetet digjitale në përdorim nga konsumatorët, me synimin për të adresuar sfidat e zhvillimit të tij, nevojiten ndryshime e përmirësime të këtij legjislacioni. Ndryshimet legjislative, pjesë e direktivave të reja evropiane, do të sigurojnë jo vetëm transparencën e duhur të informimit ndaj konsumatorëve, zbatimin e të drejtave të tyre, dhe përmirësimin e funksionimit të tregut, por edhe përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorit me *acquis*, në përputhje me Analizën e Mangësive Ligjore (LGA) për kapitullin 28. Ky përafrim do të mbulojë veçanërisht aspektet e kontratave të shitjes së mallrave për konsumatorët, zbatim më të mirë dhe modernizim të rregullave për mbrojtjen e konsumatorëve; kontratat për furnizimin me përmbajtje digjitale dhe shërbime digjitale etj.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i përmirësimit të legjislacionit do të përbëjë sigurimi që të gjithë konsumatorët të kenë akses në mekanizmat efikasë të dëmshpërblimit. Për këtë qëllim, krahas Zgjidhjes Alternative të Mosmarrëveshjeve (ZAM) do të sigurohet edhe Zgjidhja *Online* e Mosmarrëveshjeve (ZOM), nëpërmjet internetit e një platforme përkatëse, për të siguruar që konsumatorët mund t'i gjejnë dhe përdorin lehtësisht këto mjete për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tyre.

Për sa më sipër, ndryshimet legjislative do të sigurojnë zbatim më të mirë të legjislacionit, mjete më efektive për dëmshpërblim, duke rritur besimin e konsumatorëve e si rrjedhim, duke pasur

parasysh rëndësinë e shpenzimeve të konsumatorit sigurohen përfitime në ekonominë e vendit në ruajtjen e një modeli të qëndrueshëm ekonomik.

Masa 26.2: Funksionimi i Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve (KMK), në mbrojtje të interesit të përgjithshëm publik, në drejtim të:

- Analizimit dhe vlerësimit të kontratave standarde të lidhura midis subjekteve/operatorëve dhe konsumatorëve në fushat e komunikimeve elektronike, shërbimeve e internetit; shërbimet audiovizive, me impakt në interesat ekonomike të konsumatorëve;

- vlerësimi i praktikave tregtare, për konstatimin e mospërputhjeve ligjore, në fushat e ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike, informimit mbi garancinë e produkteve, ofrimit të produkteve në largësi/përfshirë edhe blerjet *online*, informimit që u sigurohet konsumatorëve në fushatat promovuese të produkteve apo shërbimeve etj., me synim uljen e shkallës së mospërputhjeve të gjetura, pas marrjeve të masave nga KMK

Masa 26.3: Shqyrtimi në masën 100% i ankesave/mosmarrëveshjeve të konsumatorëve, në fushat e energjisë, furnizimit me ujë, komunikimeve elektronike dhe të internetit, shërbimeve postare, financiare, si dhe në blerjen e mallrave në qendrat e tregtimit, jashtë tyre dhe në largësi apo në blerjet *online* nga strukturat për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve (ZAM).

Masa 26.4: Ngritja dhe funksionimi i strukturave të njësive vendore të ngarkuara me çështjet e mbrojtjes së konsumatorëve në çdo bashki të vendit. Në mbështetje të parashikimeve të legjislacionit të mbrojtjes së konsumatorëve, funksionimi i këtyre strukturave do të sigurojë informimin, ndërgjegjësimin, mbështetjen e procesit të këshillimit të konsumatorëve, si dhe rolin e tyre ndihmues për trajtimin e ankesave të konsumatorëve, në shkallë vendi.

Indikatorët:

- Miratimi i 1 akti ligjor (ndryshime të ligjit të mbrojtjes së konsumatorit) brenda vitit 2025;
- Ankesa të shqyrtuara nga DPZAM 30 /për vit;
- Numri i vendimeve të marra nga KMK - 3/për vit;
- Struktura funksionale të njësive vendore të ngarkuara me çështjet e mbrojtjes së konsumatorëve 3/për vit.

Ministria e Mjedisit dhe Turizmit

Objektivi 27:

Përmirësimi i kuadrit ligjor në funksion të mbrojtjes së turistit mbi ofrimin shërbimit të sigurt dhe me standarde duke forcuar implementimin e tyre në treg.

Masa 27.1: Hartimi dhe rishikimi i kuadrit ligjor në përputhje me direktivat evropiane.

Masa 27.2: Rritja e numrit të inspektimeve mbi zbatueshmërinë e kuadrit ligjor për ofrimin e këtyre shërbimeve.

Indikatorët:

- Kryerja e rreth 1500 inspektime në treg/vit duke i garantuar konsumatorëve shërbime të sigurta dhe me standarde.

Enti Rregullator i Energjisë

Objektivi 28:

Hartimi/miratimi i strategjisë së mbrojtjes së konsumatorit në sektorin e energjisë.

Masa 28.1: Kryerja e aktiviteteve dhe proceseve për hartimin e strategjisë së konsumatorit në fushën e energjisë.

Strategjia e konsumatorit synon të vijë si një paketë me Rregulla brenda një kornize gjithëpërfshirëse për mbrojtjen, informacionin dhe fuqizimin e konsumatorëve në sektorin e energjisë elektrike.

Duke u ofruar konsumatorëve informacion dhe duke u ofruar atyre opsione se si mund të marrin pjesë në tregun e energjisë, ata do të mbrohen më mirë dhe do të jenë në një pozicion më të fortë në zinxhirin e furnizimit me energji. Të gjithë konsumatorët shqiptarë gëzojnë të drejta e përgjithshme të konsumatorit të garantuara në legjislacionin tonë, si dhe një sërë të drejtash të lidhur me përdorimin/konsumin e energjisë.

Indikatori:

Strategjia e konsumatorit në fushën e energjisë e miratuar.

Objektivi 29:

Mbrojtja e interesave ekonomikë të konsumatorëve nëpërmjet rregullimit tarifor për pikat e karikimit të makinave elektrike.

Masa 29.1: Analizë e thelluar e njohurive sa u përket politikave të ngjashme rregullatore në vendet e Bashkimit Evropian, si dhe adresimit të incentivave sensibilizuese për konsumatorin sa i përket përdorimit eficient të energjisë brenda kuadrit ligjor aktual, por edhe nëpërmjet adresimit në institucionet e kompetencës të propozimeve konkrete që do të adresojnë iniciativë të tilla nga ERE-s. Është e rëndësishme që rregullimi ligjor i kësaj kategorie të paraprijë realitetin e së ardhmes ku makinat hibride apo elektrike, do të zënë një vend të rëndësishëm me qëllim uljen e emetimeve të dëmshme në mjedis nga automjetet tradicionale të transportit.

Masa 29.2: Kualifikim i stafit të ERE-s mbi këtë teknologji të re me qëllim kualifikimin e stafit dhe njohjen me praktikën më të mira ndërkombëtare në këtë fushë.

Indikatorët:

- Dokumenti Strategjik i miratuar.
- Përgatitja e një (1) dokumenti në formën e një metodologjie i cili të reflektojë parimet e rregullimit tarifor nga rregullatori për këtë kategori konsumatori.
- Trajnimi i 7 personave mbi praktikën më të mira ndërkombëtare.
- Trajnimi i strukturës përgjegjëse të ERE-s mbi metodat e llogaritjes nga rregullatori të sistemit tarifor për furnizuesit që ofrojnë shërbimin e furnizimit për pikat e karikimit elektrike apo për klientët që e përfitojnë këtë shërbim.
- Trajnimi 2 herë në vit, i strukturave përgjegjëse për rregullimin ligjor dhe atë tarifor të pikave të karikimit të makinave elektrike me qëllim dhënien e kontributit direkt në ndërmarrjen e iniciativave ligjore për këtë qëllim apo dhe përmbushjen e fushës së vetë të përgjegjësisë në vijim.

Objektivi 30:

Krijimi i platformave nga furnizuesit duke përmirësuar cilësinë e shërbimit ndaj konsumatorëve, nëpërmjet mbikëqyrjes dhe vlerësimit të shërbimit të ofruar.

Masa 30.1: Zhvillimi dhe përditësimi i një sistemi të menaxhimit dhe trajtimit të ankesave, dhënies së informacionit të saktë e të shpejtë, në kuadër të mjeteve të reja teknologjike, që mundësojnë trajtimin në një kohë sa më të shkurtër e më të thjeshtë. Rregullorja mbi masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit, e miratuar nga ERE, vendos detyrime konkrete ndaj të licencuarve për arritjen e një shërbimi me cilësi ndaj konsumatorit dhe mbikëqyrjen periodike të arritjes së këtyre standardeve nga ana e ERE-s.

Masa 30.2: Lehtësimi i aksesit për shërbimet e kërkuara në kuadër të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve (ZAM) si një mjet për zgjidhjen e shpejtë të problematikave që normalisht kërkojnë më shumë kohë dhe kosto përmes zgjidhjeve gjyqësore. Për këtë qëllim, me rëndësi është edhe vendosja e protokolleve të bashkëpunimit me organizatat e shoqatat që kanë në fokus mbrojtjen e konsumatorëve apo njësitë përgjegjëse në shërbim të konsumatorit pranë pushtetit lokal apo qendror.

Indikatorët:

- Ngritja e 1 platforme të përbashkët të furnizuesve në treg të lirë, e cila do të ofrojë informacion mbi ofertat e tregut të furnizimit me energji elektrike (*price comparison tool*).
- Ngritja e 1 (një) platforme në të cilën përditësimi i regjistrit të ankesave në trajtim apo të trajtuara nga ERE të mund të ndiqet në kohë reale nga vetë konsumatorët.

Enti Rregullator i Ujit

Objektivi 31:

Rritja e kontrollit ndaj shoqërive të ujësjellës-kanalizime për zbatimin e legjislacionit ekzistues dhe cilësisë së ofrimit të shërbimit në këtë sektor.

Masa 31.1: Kryerja e inspektimeve pranë shoqërive UK.

Do të kryhen inspektime për zbatimin e kushteve të licencës, zbatimit të tarifave të miratuara nga ERRU, si dhe monitorimi e treguesve të performancës së shoqërive UK.

Indikatori: Me krijimin e shoqërive rajonale UK – subjekte me kompetenca të përbashkëta (SKP) licencimit të tyre dhe vendosjes së tarifave nga ana e Entit Rregullator të Ujit dhe operimit të tyre për ofrimin e shërbimit UK, do të kryhen 15 inspektime në vit në të gjitha SKP.

Masa 31.2: Kryerja e monitorimeve pranë shoqërive UK në drejtim të marrëdhënieve me konsumatorin.

Do të kryhen monitorime në të gjitha shoqëritë UK për zbatimin e kushteve të përgjithshme të kontratës midis konsumatorit dhe shoqërisë UK, zbatimit të rekomandimeve të lëna nga rregullatori për përmirësimin e ofritit të shërbimit në drejtim të konsumatorit.

Indikatori: Kryerja e 3 monitorime në vit, të shoqëruara me rekomandime dhe subjekt rimonitorimi pas 6 muajsh.

Objektivi 32:

Rritja e transparencës ndaj konsumatorit për shërbimet ujësjellës-kanalizime dhe mekanizmeve të ankimimit.

Masa 32.1: Përmirësimi i faqes zyrtare të ERRU-së dhe kanaleve të tjera të komunikimit.

Do të kryhen rikonceptim i faqes zyrtare të ERRU-së www.erru.al me informacione, njoftime mbi gjendjen në sektorin UK, pasqyrimin të performancës së shoqërive UK vit pas viti, të drejtave dhe detyrimeve të shoqërive UK ndaj ofritit të shërbimit, si dhe të drejtat dhe detyrimet e konsumatorëve në marrjen e shërbimit.

Masa 32.2: Ofrimi i kanaleve *online* të ankimimit të konsumatorëve drejtuar Entit Rregullator të Ujit. Një dritare e veçantë do t'i dedikohet zgjidhjes së mosmarrëveshjeve nëpërmjet Strukturës së Zgjidhjes Alternative të Mosmarrëveshjeve.

Indikatori:

3 kanale komunikimi dhe drejtimi të ankesave të konsumatorëve, *website* ww.erru.al: Ankesa dhe ZAM; nr. telefoni +3552 258 046

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Objektivi 33:

Rritja e përfitimeve të konsumatorëve nga aksesin dhe përdorimi i shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe postare, në kuptimin e zgjedhjes së ofruesit, çmimit dhe cilësisë së shërbimit.

Masa 33.1:

Projektligji i ri “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, është përgatitur nga Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me asistencë teknike të Bashkimit Evropian, në kuadër të projektit *Technical Assistance for The Telecommunications Sector, Specific Contract number: 300026749* — SIEA-2018-5578, dhe në bashkëpunim me Autoritetin të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Projektligji i ri i komunikimeve elektronike, i cili synon transpozimin e direktivës (EU) 2018/1972 të Parlamentit evropian dhe të Këshillit “Për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike” (në vijim “EECC”) pritet të miratohet brenda vitit 2024.

Indikatori: Miratimi nga Kuvendi dhe hyrja në fuqi e ligjit të ri.

